



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade


Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

R
A
P
O
R
T
I

2
0
2
0

● SEKTORI C

● INDUSTRIA PËRPUNUESE



Tetor, 2021

PËRMBAJTJA

Shkurtesat e përdorura.....	5
Lista e tabelave.....	6
Lista e figurave.....	8
Hyrje.....	9
Metodologjia.....	10
PJESA E PARË	
ANALIZA MAKROEKONOMIKE	11
1.1 Bruto produkti vendor.....	11
1.2 Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	13
1.3 Investimet e huaja direkte sipas shteteve.....	14
1.4 Tregu financiar.....	15
1.5 Fuqia punëtore.....	15
PJESA E DYTË	
ANALIZA SEKTORIALE - SEKTORI C	17
1 Numri i të punësuarve, ndërmarrjeve dhe qarkullimi vjetor.....	17
1.1 Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe nën sektorëve.....	22
2 Eksporti dhe importi me vendet e BE, CEFTA, EFTA dhe vendet tjera, për sektorin C (Industria përpunuese).....	24
2.1 Eksporti dhe importi me vendet e BE-së.....	31
2.2 Eksporti dhe importi me vendet e CEFTA-së.....	35
2.3 Eksporti dhe importi me vendet e EFTA-së.....	39
2.4 Eksporti dhe importi me vendet tjera.....	43
ZHVILLIMI I NËNSEKTORËVE	
1 Prodhimi i produkteve ushqimore.....	46
1.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore.....	46
1.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore.....	49
2 Prodhimi i pijeve.....	53
2.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të pijeve.....	53
2.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të pijeve.....	54
3 Prodhimi i tekstitil.....	57

3.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e tekstit.....	58
3.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e tekstit.....	59
4	Prodhimi i veshjeve.....	62
4.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e veshjeve.....	63
4.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e veshjeve.....	64
5	Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës.....	67
5.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e lëkurës.....	67
5.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e lëkurës.....	69
6	Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara-Thurje	72
6.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e drurit.....	73
6.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e drurit.....	76
7	Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës.....	80
7.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e letrës.....	81
7.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e letrës.....	84
8	Prodhimi i Produkteve Kimike.....	88
8.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e produkteve kimike	88
8.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e produkteve kimike.....	91
9	Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe të Plastikës.....	96
9.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e plastikës.....	96
9.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e plastikës.....	98
10.	Prodhimi i produkteve Jo - Metalike.....	101
10.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e produkteve jo -metalike.....	102
10.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e produkteve jo – metalike.....	105
11	Prodhimi i Metaleve.....	109
11.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e metaleve.....	110
11.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e metaleve.....	112
12	Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve	116
12.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e produkteve të fabrikua metalike.....	116
12.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e produkteve të fabrikua metalike.....	119
13	Prodhimi i Mobileve.....	122

13.1	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e mobileve.....	123
13.2	Eksportet dhe importet në nën sektorin e mobileve.....	126
14	Përmbledhja.....	129
15	Rekomandimet.....	134
16	Referencat.....	135

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Politika Industriale
EFTA	-	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese
MINT	-	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MTLEQ	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita

Lista e tabelave

Tabela 1	Bruto Produkti Vendor sipas sektorëve ekonomik.....	12
Tabela 2	IHD sipas sektorëve ekonomike, 2014 – 2019.....	13
Tabela 3	IHD sipas vendeve të origjinës, 2014 – 2019.....	14
Tabela 4	Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve.....	15
Tabela 5	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2015-2019.....	16
Tabela 6	Norma e papunësisë 2015 – 2018.....	16
Tabela 7	Spektori-C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi.....	17
Tabela 8	Spektori-C, eksporti dhe importi me vendet e BE, CEFTA, EFTA dhe vendet tjera....	27
Tabela 9	Spektori-C, eksporti dhe importi me vendet e BE.....	31
Tabela 10	Spektori-C, eksporti dhe importi me vendet e CEFTA.....	35
Tabela 11	Spektori-C, eksporti dhe importi me vendet e EFTA	39
Tabela 12	Spektori-C, eksporti dhe importi me vendet tjera.....	43
Tabela 13	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore.....	47
Tabela 14	Eksporti dhe importi në nën sektorin e tekstilit e prodhimit të produkteve ushqimore.....	50
Tabela 15	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të pijeve.....	53
Tabela 16	Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të pijeve.....	55
Tabela 17	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e tekstilit.....	57
Tabela 18	Eksporti dhe importi në nën sektorin e tekstilit.....	60
Tabela 19	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e veshjeve.....	63
Tabela 20	Eksporti dhe importi në nën sektorin e veshjeve.....	65
Tabela 21	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e lëkurës.....	67
Tabela 22	Eksporti dhe importi në nën sektorin e lëkurës.....	69

Tabela 23	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e drurit.....	73
Tabela 24	Eksporti dhe importi në nën sektorin e drurit.....	76
Tabela 25	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e letrës	81
Tabela 26	Eksporti dhe importi në nën sektorin e letrës	85
Tabela 27	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e industrisë kimike.	89
Tabela 28	Eksporti dhe importi në nën sektorin e industrisë kimike.....	92
Tabela 29	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e industrisë së gomës dhe plastikës.....	97
Tabela 30	Eksporti dhe importi në nën sektorin e industrisë së gomës dhe plastikës.....	99
Tabela 31	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve jo – metalike	102
Tabela 32	Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të produkteve jo – metalike.....	106
Tabela 33	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të metaleve.....	110
Tabela 34	Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të metaleve.....	112
Tabela 35	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikuara metalike.....	117
Tabela 36	Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikuara metalike.....	119
Tabela 37	Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të mobileve.....	123
Tabela 38	Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të mobileve.....	126

Lista e figurave

Figura 1	Sektori-C, punësimi, ndërmarrjet dhe qarkullimi sipas regjioneve.....	21
Figura 2	Sektori-C, nën sektorët sipas madhësisë së ndërmarrjeve.....	22
Figura 3	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore.....	52
Figura 4	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të pijeve.....	56
Figura 5	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e tekstit.....	61
Figura 6	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e veshjeve.....	66
Figura 7	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e lëkurës.....	71
Figura 8	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e drurit.....	78
Figura 9	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e letrës.....	87
Figura 10	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e industrisë kimike.....	95
Figura 11	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e industrisë së gomës dhe plastikës.....	100
Figura 12	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të produkteve jo – metalike.....	108
Figura 13	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të metaleve.....	115
Figura 14	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikua metalike.....	121
Figura 15	Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të mobileve.....	128

Hyrje

Republika e Kosovës, për të përmirësuar standardin e jetesës si dhe që të ekuilibrojë bilancin negativ tregtar, ka nevojë për një ritëm shumë më të shpejtë të rritjes së eksporteve dhe investimeve në industri.

Industria e Kosovës deri në fund të viteve të 80-ta kishte një nivel të konsiderueshëm zhvillimi mirëpo në vitet e 90-ta kishte ngecje të mëdha në zhvillim, prodhim, punësim, eksport etj. Kjo fazë dhe lufta ndikuan në rënien e plotë të sektorëve të industrisë. Kështu që, Kosova kaloi nëpër një fazë emergjente ekonomike dhe sociale e cila ishte mjaft e vështirë. Zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të veçantë sektori i prodhimit si dhe nismat për privatizim janë hapat e parë të proceseve drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në ekonominë e Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë, me rreth 99%.

Zhvillimi i sektorëve të industrisë përpunuese është shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit, sepse industria përpunuese kontribuon drejtpërsëdrejti në rritjen e vlerës së prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve me profile të ndryshme.

Për të pasqyruar detajisht gjendjen e trendëve të zhvillimit të industrisë, hartuesit e Politikave Industriale në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në të dhënat e përpunuara statistikore kanë përgatitur Raportin vjetor të Industrisë Përpunuese 2020 mbi zhvillimin e nën sektorëve industrial në kuadër të Sektorit-C.

Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, për vitet 2018-2020, me theks të veçantë në degët kryesore industriale gjatë vitit 2020, por edhe një analizë krahasuese për dy vitet e fundit, 2019-2020, si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë përpunuese.

Të dhënat e analizuara, që janë paraqitur në këtë raport, mund t'iu shërbejë institucioneve, akademikëve, hartuesve të politikave, bizneseve operuese (të tanishme dhe atyre me potencial në sektorin privat), investitorëve, donatorëve, si dhe hulumtuesve. Raporti për Sektorin-C (industrinë përpunuese) ofron një pasqyrë më të hollësishme rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit si dhe lehtëson punën e të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Përveç indikatorëve kryesor të nivelit sektorial/industrial (numri i ndërmarrjeve, të punësuarve, qarkullimi etj.), të cilët ndikojnë në zhvillimin industrial, në këtë raport janë përfshirë edhe indikatorët e nivelit makroekonomik, ata të tregut financiar, tregut të punës, pastaj investimeve si dhe tregtia e jashtme, me një shpjegim të veçantë për nën-sektorët.

Metodologjia

Raporti është hartuar duke përdorur metodat kërkimore të raporteve të ndryshme hulumtuese si dhe të dhënave sasiore dhe cilësore të pranuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës dhe institucionet tjera relevante.

Të dhënat sasiore dhe cilësore, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MINT-së konkretisht nga përpunuesit e të dhënave statistikore dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë.

Me qëllim të ofrimit të informatave të sakta të paraqitura në format tabelore dhe figurative janë përdorur metodat e kombinimit dhe krahasimit për të dhënat e prezantuara.

Të dhënat statistikore janë përpunuar në pjesën e përgjithshme për Industrinë përpunuese të Sektorit-C, vlerat e përgjithshme që përfshijnë kodet 10-33, si dhe në pjesë të veçanta për nën sektorët, siç janë: Përpunimi i ushqimit, Pijeve, Tekstili, Veshja, Lëkura, Druri, Letra, Industria Kimike, Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike (përveç Makinerisë dhe Pajisjeve), Plastika dhe Goma, Minerale jo metalike, Metalet si dhe Prodhimi i Mobileve. Përshkrimi i këtyre nën sektorëve, në këtë Raport është radhitur sipas kodeve, ashtu siç janë të radhitura në NACE-Rev2.

Të dhënat për nën sektorët, përveç që janë përpunuar sipas kodeve dy shifror, siç janë të dhënat për eksportin dhe importin, janë paraqitur edhe sipas aktiviteteve të kodit tre shifror, ndërsa të dhënat për nën aktivitetet për Ndërmarrjet, Punësimin dhe Qarkullimin në Kosovë janë paraqitur sipas kodit katër shifror.

Nga të dhënat statistikore të përpunuara janë hartuar analiza të detajuara për BPV, IHD, trendët e eksporteve dhe importeve në industrinë përpunuese si në rajon ashtu edhe me vendet tjera si dhe vlerën më të lartë të eksporteve të Kosovës sipas shteteve. Në këtë raport, analizat me të dhëna, sipas kodit katër shifror janë paraqitur edhe për numrin e të punësuarave në industri, numrin e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe vlerën e qarkullimit, sipas komunave në shtatë regjionet e Kosovës.

Pas analizave të paraqitura lidhur me të dhënat e përgjithshme dhe trendët për industrinë përpunuese, Sektori-C, në këtë raport janë ofruar konkluzionet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me gjendjen dhe trendët e prodhimit në industrinë përpunuese në Kosovë .

Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në Raportin Analitik për industrinë përpunuese janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

PJESA E PARË

ANALIZA MAKROEKONOMIKE

Bruto produkti vendor (BPV) me çmime aktuale në vitin 2020 ishte 6,771.6 milion euro. Rënia reale në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, ishte 5.34%, ndërsa BPV, për kokë banori, për vitin 2020 ishte 3.772 euro. Rritja reale e BPV, në industrinë përpunuese në vitin 2020 ishte 1.2%, ndërsa Sektori-C në BPV, merr pjesë me 13.35%¹.

Kosova në vitin 2020, ka eksportuar në vlerë prej 474.9 milion euro, ndërsa në vitin 2019 vlera e eksportit ishte 383,5 milion euro, çka do të thotë sa ka rritje për 23.83%. Në vitin 2020 importi ka shënuar vlerën prej 3.29 miliard euro, deri sa në vitin 2019 importi ishte 3.49 miliard euro, ku shihet se ka rënie për 5.73%². Raporti mes eksportit dhe importit në vitin 2020, duke u bazuar nga të dhënat e pasqyruara të shkëmbimit tregtar, paraqet bilanc negativ tregtar, ku mbulimi i importit me eksport është rreth 12.59%.

Sa i përket industrisë përpunuese, pjesëmarrja në eksport, në vitin 2020 është 398.46 milion euro, ndërsa në vitin 2019 ishte 291.70 milion euro, shprehur në përqindje në vitin 2020 eksporti ka shënuar rritje për 36.6%.

Importi në vitin 2020 në Sektorin-C, ishte 3.06 miliard euro, ndërsa në vitin 2019 importi ka qenë 3.35 miliard euro, që tregon se ka shënuar rënie për 5.9%.

Pjesëmarrja e industrisë përpunuese, në eksportin e përgjithshëm, në vitin 2020 është rreth 83.9%, me rritje të pjesëmarrjes për rreth 8% krahasuar me vitin 2019, ndërsa në importin e përgjithshëm pjesëmarrja e industrisë përpunuese ishte 93%, që tregon se nuk ka shënuar ndryshim nga viti paraprak.

Sfidat tjera që po e pengojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës përfshijnë shkallën relativisht të lartë të ekonomisë joformale, fuqinë punëtore të pakualifikuar, normën e ulët të pjesëmarrjes në punë (në veçanti të rinjtë dhe gratë) dhe niveli relativisht i lartë i supozimit të korrupsionit.

1.1 Bruto Produkti Vendor

Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancën ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar kohore. BPV gjithashtu është një matës i vlerave të produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në një ekonomi. Andaj, është e rëndësishme që BPV, të matet për të pasqyruar gjendjen e një ekonomie dhe dinamikën e saj.

Sektori-C, Industria përpunuese merr pjesë me 13.35% në BPV.

Ekonomia e Kosovës në dekadën e fundit ka shënuar normë pozitive të rritjes ekonomike, përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonominë globale, sidomos në atë Evropiane dhe është rritur vazhdimisht mbi mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

¹ <https://ask.rks-gov.net/media/6295/bpv-2008-2020.pdf>

² Vjetari Statistikor-2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës

Aktivitetet ekonomike kryesore të cilat kanë kontribuar në rritjen e BPV në periudhën 2018-2020 ishin: industria përpunuese, tregtia me shumicë dhe pakicë, bujqësia, gjuetia, pylltaria, peshkimi, afarizmi me pasuri të patundshme, ndërtimtari etj.

Tabela 1. Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike, me çmime aktuale (në %)

Nace Rev.2	Aktivitetet ekonomike	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
A	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	6.5	7.2	7.4
B	Industria nxjerrëse	2.2	2.0	2.0
C	Industria përpunuese	13.1	12.9	13.4
D	Furnizimi me energji elektrike, me gaz	3.5	3.4	3.9
E	Furnizimi me ujë	0.7	0.7	0.6
F	Ndërtimtaria	8.4	8.2	7.7
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	12.5	12.8	12.8
H	Transporti dhe magazinimi	4.5	4.4	3.9
I	Hotelet dhe restorantet	1.9	2.1	1.6
J	Informimi dhe komunikimi	1.9	1.9	2.0
K	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	3.6	3.9	4.1
L	Afarizmi me pasuri të patundshme	7.1	7.0	7.3
M	Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.5	1.4	1.6
N	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.7	0.7	0.7
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	5.8	5.9	6.6
P	Edukimi	3.8	3.7	3.8
Q	Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	2.2	2.2	2.7
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.4	0.2	0.2
S	Shërbime tjera	0.4	0.4	0.4
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e pa diferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanak	-	-	-
	BVSH me çmime bazë	80.6	80.8	82.6
	Tatimet në produkte	19.4	19.2	17.4
	Subvencionet në produkte	-	-	-
	Bruto Produkti Vendor	100	100	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës/ Seria 5: Statistikat e Llogarive Kombëtare

Sipas tabelës nr. 1, Industria përpunuese është aktiviteti ekonomik i cili kontribuon më së shumti në BPV, me 13.4% në totalin e vlerës së BPV. Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave radhitet e dyta me pjesëmarrje prej 12.8%, ndërsa ndërtimtaria radhitet në vendin e tretë me rreth 7.7%, të pjesëmarrjes në vlerën e përgjithshme të BPV.

Nga gjithsej 20 aktivitetet e pasqyruara në tabelën nr.1. rritje kanë shënuar 9 aktivitete, ndër të cilat rritjen më të lartë e ka shënuar aktiviteti i Administrimit publik dhe i mbrojtjes; Sigurimi i detyrueshëm social, pastaj Industria përpunuese, Furnizimi me energji elektrike, me gaz etj. Rënie më të lartë të BPV-së, ka shënuar aktiviteti i Hoteleve dhe restoranteve, Transporti dhe magazinimi, Ndërtimtaria, e kështu me radhë.

1.2 Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik

Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen e mundësive për integrim ekonomik duke krijuar lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata në tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë e mëdha botërore transferojnë kapitalin e tyre në ato vende që ofrojnë kushte më të mira në investime. Përveç taksave më të ulëta, fuqisë punëtore më të lirë dhe të kualifikuar, kompanitë janë të interesuara edhe për sundimin e rendit dhe ligjit në vendin e investimeve, por edhe për sigurimin e investimeve nga vendi përfitues.

Investimet e huaja direkte në Kosovë, për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, kanë shënuar rritjen më të lartë në sektorin “Aktivitetet financiare dhe të sigurimit”, ku nga vlera 13.9 milion euro, ka kaluar në vlerë 84 milion euro.

IHD, në sektorin e prodhimit në vitin 2020, kanë shënuar rënie nga 14.2 milion € në (5.5) milion €.

Të dhënat tregojnë, po ashtu, se te aktiviteti ekonomik i Ndërtimit nga një vlerë negative që kishim në vitin 2019 (17.1) është shënuar një rritje prej 10.8 milion euro në vitin 2020 si dhe te sektori Xehetaria dhe gurorët, nga një vlerë negative (6.9) milion euro është investuar në 28.8 milion euro dhe kjo do të thotë se ky aktivitet ekonomik ka shënuar vlerë pozitive për herë të parë në 5 vitet e fundit.

Shikuar nga vlera investuese, sektori i cili ka shënuar vlerën më të lartë investive është aktiviteti i patundshmërisë 201.1 milion euro, ndërsa nëse e krahasojmë me vitin paraprak, ky sektor ka rënie për 22.7 milion euro.

Tabela 2. IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2020 (në milionë euro)

Sektorët	2016	2017	2018	2019	2020
Bujqësia, pylltari dhe peshkatari	1.3	(1.3)	0.1	1.5	2.8
Xehetaria dhe gurorët	(19.1)	(4.9)	(2.7)	(6.9)	28.8
Prodhimi	4.2	6.1	(17.7)	14.2	(5.5)
Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	(0.4)	(0.8)	12.1	13.5	27.5
Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	0.6	0.0	2.5	(0.6)	0.2
Ndërtimi	28.1	5.1	24.8	(17.1)	10.8
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14.0	9.0	19.6	(6.7)	(7.8)
Transport dhe ruajtje	0.9	(0.8)	(0.2)	(6.2)	(16.0)
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	0.8	1.1	1.8	1.4	1.1
Informacioni dhe Komunikimi	(4.2)	(3.8)	(9.6)	2.3	2.1
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	19.0	55.2	15.5	13.9	84.4
Aktivitete të patundshmërive	139.7	154.7	205.2	223.8	201.1
Aktivitete profesionale shkencore dhe teknike	5.8	5.7	5.2	3.4	3.8
Aktivitete administrative dhe mbështetëse	21.9	23.7	4.7	3.7	0.8
Administratë publike dhe mbrojtje; siguri m social i detyrueshëm	1.9	1.3	0.9	1.7	1.1
Arsim	0.8	0.7	0.7	1.3	1.3
Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	1.3	(1.0)	(0.4)	0.6	0.3
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.0	0.5	0.5	(0.1)
Aktivitete të shërbimeve tjera	3.9	3.7	7.2	2.8	1.8
Të pa klasifikuar	(0.3)	1.5	2.0	7.6	3.0

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Vjetari Statistikor i Kosovës 2021

Përveç te Aktivitetet financiare dhe te sigurimet, atij të Ndërtimit dhe xehetarisë dhe gurorët, rritje të IHD-ve, krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 janë shënuar edhe në sektorin e

furnizimit me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar, bujqësi, pylltari dhe peshkatari, furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash si dhe aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike.

Në kuadër të IHD-ve, sipas sektorëve ekonomik, siç shihet edhe në tabelën nr. 2, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, rënie është shënuar në sektorin e patundshmërive, prodhimit, transport dhe ruajtje, tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave, etj.

1.3 Investimet e Huaja Direkte Sipas Shteteve

Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas shteteve, gjatë viteve 2015-2020, kanë një trend të qëndrueshëm të ngritjes së vlerës së IHD-ve. Vlera e përgjithshme e IHD-ve për vitin 2020 ishte 341.7 milion euro, që do të thotë se ka pasur rritje për 34.2%, krahasuar me vitin 2019.

Tabela 3. IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2020 (në milion euro)

Shtetet		Vitet					
		2015	2016	2017	2018	2019	2020
AT	Austria	33.5	9.9	20.3	11.2	11.9	27.6
DE	Gjermania	45.3	25.7	55.9	60.3	70.2	67.5
SI	Sllovenia	5.6	-4.5	1.2	-8.7	6.1	7.9
GB	Britania e Madhe	26.6	13.6	27.0	57.4	0.8	21.0
CH	Zvicra	72.9	61.8	50.6	71.0	61.9	62.4
TR	Turqia	55.4	42.7	29.5	12.2	-31.9	15.3
NL	Holanda	-36.4	-23.1	-14.1	-39.7	1.9	0.1
AL	Shqipëria	40.1	28.6	2.4	22.3	15.2	39.4
LU	Luksemburgu	0.1	0.6	2.1	1.9	1.3	-2.2
RS	Serbia	0.8	-0.6	-1.4	0.4	0.4	6.0
US	Shtetet e Bashkuara	25.0	23.0	20.3	35.5	22.8	30.4
FR	Franca	3.2	2.8	3.6	5.6	3.4	3.7
BG	Bullgaria	1.6	0.4	0.5	2.1	1.0	0.9
MK	Maqedonia	0.1	3.2	-1.0	1.3	2.0	1.8
BA	Bosnja dhe Hercegovina	0.8	1.2	0.7	0.4	0.1	0.1
HR	Kroacia	0.1	-1.7	0.7	-1.0	0.9	-1.2
MT	Malta	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
CY	Qipro	0.1	0.4	0.8	1.3	2.9	0.9
SK	Sllovakia	0.1	0.8	0.1	0.5	1.4	0.3
CA	Kanadaja	1.1	2.5	3.0	3.2	5.3	4.7
CZ	Çekia	1.3	0.2	0.7	1.5	0.4	0.5
AE	Emiratet e Bashkuara Arabe	1.4	3.6	13.4	-2.5	3.8	1.9
NO	Norvegjia	2.9	3.4	3.5	5.1	4.9	3.2
KW	Kuvajti	0.0	0.2	0.0	-1.1	0.7	0.1
ES	Sopanja	-0.8	0.2	2.5	0.3	0.7	0.0
EG	Egjipti	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IT	Italia	5.7	1.9	7.0	2.7	7.9	3.5
GR	Greqia	-0.2	-0.4	-1.2	-0.3	0.1	0.0
HU	Hungaria	0.3	0.6	0.4	0.1	19.1	23.7
Tjera	Tjera	22.1	22.8	26.9	29.1	39.6	22.3
Gjithsej		308.8	220.0	255.4	272.1	254.6	341.7

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistics/time-series/?lang=en>

Ndër vendet me investime më të larta të IHD-ve, për vitin 2020, është Gjermania, me investime prej 67.5 milion euro, edhe pse krahasuar me vitin 2019 ka rënie për 3.8%. Zvicra për nga investimet radhitet e dyta, me 62.4 milion euro, krahasuar me vitin 2019 si dhe ka pasur rritje për 0.8%, pastaj radhitet Shqipëria me 39.4 milion euro, SHBA-të me 30.4 milion euro, Austria me 27.6 milion euro etj.

1.4 Tregu financiar

Sa i përket normave efektive të interesit të korporatat tjera depozituese (KTD), marrë mesataren e normave të interesit për sektorët e pasqyruar në tabelën nr. 4, në vitin 2020, vërehet një rënie e lehtë për 0.1% e normës së interesit, krahasuar me vitin 2019.

Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë është 6.0%.

Tabela 4. Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve

Sektorët	Norma e Interesit 2019	Norma e Interesit 2020
Kredi Konsumuese	7.0%	6.8%
Kredi Hipotekare	5.7%	5.7%
Bujqësore	9.1%	9.3%
Industriale	6.4%	6.0%
Shërbyese	6.3%	6.0%
Sektorët Tjerë	6.3%	6.3%
Mesatarja e Normës së Interesit	6.8%	6.7%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Raporti vjetor 2020

Tabela 4, pasqyron rritje të normave efektive të interesit në sektorin e bujqësisë, rënie vërehet në katër sektorë, ndërsa nuk kanë pasur ndryshim në “Sektorët tjerë” dhe “Kreditë Hipotekare”.

1.5 Fuqia punëtore

Sipas ligjit të punës në Kosovë, marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.

Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, ndërsa personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore.

Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës.

Tabela 5. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore 2016 - 2020

Fuqia punëtore	2016	2017	2018	2019	2020
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore (në %)	38.7%	42.8%	40.9 %	40.5 %	38.3%
Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore (në %)	18.6%	20.0%	18.4%	21.1 %	20.8%
Pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore (në %)	58.3%	65.3%	63.3%	59.7 %	56.0%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Vjetari Statistikor i Kosovës 2021

Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore gjatë vitit 2020, ka pësuar rënie për 2.2%, krahasuar me vitin 2019.

Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore, në vitin 2020, është 20.8% ndërsa në vitin 2019 ishte 21.1%, që do të thotë se është shënuar rënie e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të grave për 0.30%. Pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore, gjatë vitit 2020 është 56%, krahasuar me vitin 2019, që do të thotë se te kjo kategori është shënuar rënie për 3.7%.

Norma e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore, që nuk është e punësuar. Fuqia punëtore përcaktohet si bazë për këtë indikator dhe jo popullsia në moshë pune e pasqyruar në tabelën nr. 6.

- Norma e përgjithshme e papunësisë 25.9%
 - Norma e papunësisë të gratë 32.3%
 - Norma e papunësisë të meshkujt 23.5%

Tabela 6. Norma e papunësisë 2016 - 2020

Norma e papunësisë	2016	2017	2018	2019	2020
Norma e përgjithshme e papunësisë (në %)	27.5%	30.5%	29.6%	25.7 %	25.9%
Norma e papunësisë tek gratë (në %)	31.8%	36.6%	33.4%	34.4 %	32.3%
Norma e papunësisë tek meshkujt (në %)	26.2%	28.7%	28.5%	22.6 %	23.5%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Vjetari Statistikor i Kosovës 2021

Bazuar në tabelën nr. 6, norma e përgjithshme e papunësisë, gjatë vitit 2020, pësoi rënie për 0.20 %, krahasuar me vitin 2019.

Gjatë viteve 2016- 2020, papunësia më e lartë u shënuar në vitin 2017, me 30.5%, ndërsa më e ulëta ishte në vitin 2019, me 25.7%.

Norma e papunësisë të gratë në vitin 2020 është 32.3% për derisa në vitin 2019 ishte 34.4%, ku vërehet rënie për 2.1%, ndërsa të meshkujt në normën e papunësisë është shënuar rritje për 0.9%, apo nga 22.6% në 23.5%, në vitin 2020.

PJESA E DYTË

ANALIZA SEKTORIALE – SEKTORI C

1. Numri i të punësuarve, ndërmarrjeve dhe qarkullimi vjetor

Analiza sektoriale në këtë raport përfshinë industrinë përpunuese, sipas NACE Rev2, nën sektorët e radhitur sipas kodeve, 10 deri në 33, në kuadër të Sektorit-C. Në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që kanë të bëjnë me numrin e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve, vlerën e qarkullimit vjetor dhe me eksport/importet.

Industria përpunuese-Sektori C, përfshinë transformimin fizik ose kimik të një materiali, substance ose përbërësi në një produkt të ri, mirëpo nuk mund të jetë kriteri i vetëm dhe universal për përcaktimin e industrisë prodhuese, dhe si rregull i përgjithshëm, prodhimi merret me shndërrimin e lëndëve të para në një produkt të ri.

Përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes, në sektorët e industrisë, jo vetëm në vitin e fundit por edhe për periudhën krahasuese me vitin paraprak si dhe trendët në periudhën tri vjeçare.

Të dhënat krahasuese në tabelën nr. 7 tregojnë se, gjatë dy viteve të fundit, është shënuar rritje në punësim dhe në qarkullim, ndërsa në numrin e ndërmarrjeve është shënuar rritje në vitin 2020 përderisa në vitin 2019 ka shënuar rënie krahasuar me vitin 2018.

Punësimi - Pjesëmarrja e industrisë përpunuese në normën e punësimit, sipas aktivitetit ekonomik, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 0.1%, krahasuar me vitin 2019.

Sektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.8%.³

Tabela 7. Sektori C, numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimi

Kodi	Industria Përpunuese Sektori-C	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,244	1,160	1369	6,153	6,725	8,081	223,630,843.00	272,988,285.79	320,080,653
11	Prodhimi i pijeve	89	74	78	1,822	1,823	2,138	107,448,551.00	118,109,350.97	106,226,278
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1	1	2	25	44	26	449,889.00	3,820,491.62	1,469,544
13	Prodhimi i tekstilit	127	111	176	817	629	802	14,687,985.88	15,382,963.26	16,064,405
14	Prodhimi i veshjeve	226	210	325	857	856	1,151	7,308,961.05	8,514,956.19	9,958,677
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	37	29	43	430	379	420	6,812,630.46	7,156,650.38	5,816,943
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	445	408	477	1,390	1,429	1,766	37,920,774.44	44,504,258.47	46,187,845
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	97	93	107	430	463	720	23,641,515.80	28,067,238.66	39,799,270

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës / Anketa e Fuqisë Punëtore, 2020.

18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	159	145	177	586	709	785	17,556,813.99	20,090,947.79	19,575,032
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	7	6	8	62	109	116	12,461,749.68	17,136,402.83	12,659,485
20	Prodhimi i produkteve kimike	104	85	114	642	624	762	24,145,349.45	27,811,433.84	31,935,510
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	8	4	7	94	89	103	3,681,554.00	1,223,165.01	1,771,159
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	504	481	572	2,374	2,793	3,513	114,531,279.02	131,057,171.90	140,418,212
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	478	443	511	3,796	4,454	5,082	195,005,725.73	279,099,052.93	281,102,702
24	Prodhimi i Metaleve	99	93	121	1,051	1,110	1,280	46,172,078.36	90,553,454.17	93,040,815
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	600	581	736	2,471	2,494	3,112	117,431,916.21	105,628,083.82	116,637,375
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	21	15	25	54	48	71	1,915,630.00	1,733,787.38	1,820,758
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	31	27	33	228	215	224	11,337,693.11	13,085,468.61	16,714,116
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	25	28	33	122	131	174	7,840,938.69	8,815,334.17	17,741,140
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	2	2	N/A	36	47	53	1,018,339.09	1,533,577.98	1,644,936
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	5	2	8	43	44	54	1,779,881.00	1,680,403.73	2,044,626
31	Prodhimi i mobileve	406	393	514	2,314	2,608	3,833	63,113,256.08	70,687,899.95	94,977,517
32	Prodhimi i tjetër p.k.t.	88	80	98	219	266	281	4,777,194.58	7,066,347.56	6,795,081
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	59	62	103	82	89	144	16,765,129.40	6,157,605.19	4,638,213
Gjithsej		4,862	4,533	5,637	26,098	28,179	34,691	1,061,435,679.02	1,281,904,332.20	1,389,120,291.43

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/ DI

Nga të dhënat në Tabelën nr. 7, sa i përket Sektorit-C, të dhënat tregojnë se në vitin 2020 kemi rritje të punësimit për 23.11%, si dhe rritje është shënuar për 7.97%, në vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak.

Po ashtu, Sektori-C ka shënuar rritje edhe në qarkullim, në vitin 2020 për 8.36%, krahasuar me vitin paraprak si dhe për 7.97% në vitin 2019 për 20.77% krahasuar me vitin paraprak.

Përveç që është shënuar rritje në punësim dhe në qarkullim, në vitin 2020, rritje është shënuar edhe te numri i ndërmarrjeve, për 24.35%, krahasuar me vitin 2019.

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, sa i përket punësimit, në vitin 2020, ka pjesëmarrjen më të lartë, me 23.29% dhe me rritje prej 20.16%, krahasuar me vitin 2019. Po ashtu ky nën sektorë ka shënuar rritje në qarkullim për 17.25% dhe numër të ndërmarrjeve për 18.02%.

Nën sektori i dytë me pjesëmarrje në kuadër të Sektorit-C, është “Prodhiimi i produkteve minerale jo metalike” me 14.65% dhe me rritje në punësim prej 14.09%. Ky nën sektorë, po ashtu, në vitin 2020, ka shënuar rritje në numër të ndërmarrjeve për 15.35% si dhe rritje në qarkullim për 0.72%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhiimi i mobileve”, radhitet i treti me pjesëmarrje prej 11.05% në punësim në kuadër të Sektorit-C dhe në vitin 2020 ka shënuar rritje në punësim për 46.96%, por rritje ka shënuar edhe në dy treguesit tjerë, qarkullim prej 34.36% dhe numër të ndërmarrjeve për 30.79%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori i katërt me radhë në treguesin e punësimit, në kuadër të Sektorit-C, është “Prodhiimi i produkteve të gomës dhe të plastikës”, i cili gjatë vitit 2020 merr pjesë me 10.13% në punësim si dhe ka shënuar rritje për 25.77%, në numër të ndërmarrjeve për 18.92% si dhe në qarkullimin vjetor për 7.14%.

Nën sektori i pestë me radhë sipas punësimit, në kuadër të Sektorit-C, është “Prodhiimi i produkteve të fabrikuar metalike”, me pjesëmarrje prej 8.97%, i cili gjatë vitit 2020 ka shënuar rritje për 24.79%. Gjithashtu, ky nën sektor ka shënuar rritje edhe në numër të ndërmarrjeve për 26.68% dhe në qarkullim për 10.42%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori i gjashtë është “Prodhiimi i pijeve”, me pjesëmarrje në punësim për 6.16%, në vitin 2020 ka shënuar rritje punësimi për 17.26%, si dhe rritje të numrit të ndërmarrjeve për 5.41%, por me rënie qarkullimi për 10.06%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori i radhës sipas punësimit, në vitin 2020, është “Prodhiimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës”, me pjesëmarrje prej 5.09% dhe me rritje punësimi për 23.63%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 16.91% si dhe rritje qarkullimi për 3.78%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i tetë me pjesëmarrje në punësim në kuadër të Sektorit-C, është “Prodhiimi i metaleve”, me 3.69% dhe në 2020 ka shënuar rritje punësimi për 15.35%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 30.11% si dhe rritje në qarkullim për 2.75%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhiimi i veshjeve”, ka pjesëmarrje në punësim për 3.32%, me rritje punësimi në vitin 2020 për 34.41% si dhe rritje në numër të ndërmarrjeve për 54.76% dhe në qarkullim për 16.96%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori “Prodhiimi i tekstilit”, ka pjesëmarrje në punësim për 2.31%, në vitin 2020 ka shënuar rritje për 27.49%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 58.56% si dhe rritje qarkullimi për 4.43%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori “Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara”, ka pjesëmarrje në punësim për 2.26%, me rritje punësimi në vitin 2020 për 10.75%, gjithashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve për 22.07%, ndërsa rënie në qarkullim për 2.57%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” ka pjesëmarrje në punësim prej 2.20%, në vitin 2020, ka shënuar rritje në punësim për 22.11%, po ashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve për 34.12% dhe rritje në qarkullim për 14.83%, krahasuar me 2019.

Nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, ka pjesëmarrje në punësim prej 2.08%, me rritje në vitin 2020 për 55.61%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 15.05% dhe në qarkullim për 41.8%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura”, në vitin 2020, merr pjesë në punësim të Sektorit-C, me 1.21% dhe me rritje për 10.83%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 48.28%, ndërsa rënie në qarkullim për 18.72%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhimet tjera p.k.t” kanë pjesëmarrje punësimi për 0.81%, në vitin 2020, kanë shënuar rritje për 5.57%, po ashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve për 22.5%, ndërsa rënie qarkullimi për 3.84%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori “Prodhimi i pajisjeve elektrike”, shënon pjesëmarrje për vetëm 0.65% në punësim, gjatë vitit 2020 ka pas rritje për 4.27%, gjithashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve për 22.22%, dhe rritje qarkullimi për 27.73%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.”, ka pjesëmarrje në punësim prej 0.5%, në vitin 2020 dhe ka shënuar rritje për 32.75%, rritje në numër të ndërmarrjeve për 17.86%, dhe qarkullim prej mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve”, ka pjesëmarrje në punësim të Sektorit-C, prej 0.42%, në vitin 2020, ka shënuar rritje prej 61.65%, po ashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve prej 66.13%, ndërsa ka shënuar rënie në qarkullim për 24.68%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, ka pjesëmarrje punësimi për 0.33%. Në vitin 2020, ka shënuar rritje në punësim për 6.26% dhe rritje të numrit të ndërmarrjeve për 33.33%, ndërsa rënie në qarkullim ka shënuar për 26.13%, krahasuar me vitin paraprak.

Nën sektori “Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike”, merr pjesë në punësim të Sektorit-C, me 0.20%. Në vitin 2020 ka shënuar rritje në punësim për 48.95%, në numër të ndërmarrjeve për 66.67% dhe në qarkullim për 5.02%, krahasuar me vitin paraprak.


Nën sektori “Prodhimi i mjeteve tjera të transportit”, ka pjesëmarrje punësimi për vetëm 0.16% në kuadër të Sektorit-C. Në vitin 2020 ka shënuar rritje prej 22.03% në punësim, rritje në qarkullimi për 21.67% ndërsa ka shënuar rritje nga 2 në 8 ndërmarrje, krahasuar me vitin paraprak.

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori me potencial më të ulët në punësim është shënuar te “Prodhimi i produkteve të duhanit” me pjesëmarrje prej vetëm 0.07%, dhe me rënie prej 41.35%, gjatë vitit 2020. Po ashtu, ky nën sektorë rënie të lartë ka shënuar në qarkullim për 61.54%, por rritje për 100% të numri të ndërmarrjeve, krahasuar me vitin 2019.

Nga të dhënat e tabelës nr. 7, mund të themi se duke e analizuar gjendjen e përgjithshme ekonomike në vend si rezultat i ndikimit të pandemisë me Covid-19, shihet se edhe nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike” edhe pse me pjesëmarrje të ultë për vetëm 0.30%, në kuadër të Sektorit-C, në vitin 2020 ka shënuar rritje

për 16.06%, në punësim , rritje të lartë prej 75%, në numër të ndërmarrjeve dhe qarkullim vjetor prej 44.8%, krahasuar me vitin paraprak.

Figura 1. Sektori C – punësimi, ndërmarrjet dhe qarkullimi sipas regjioneve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Nga të dhënat e paraqitura në figura nr.1 vërejmë se me numrin më të lartë të ndërmarrjeve në Sektorin-C, prinë regjioni i Prishtinës me 26.26%, me numrin më të lartë të punësuarve, me 25.55% si dhe në qarkullim me 28.19%.

Sipas këtyre treguesve, në vendin e dytë radhitet regjioni i Prizrenit me numër të ndërmarrjeve 18.91%, me numër të punësuarve 19.57% dhe me qarkullim vjetor 18.64%.

Regjioni i Ferizajt, me të dhënat e paraqitura radhitet në vendin e tretë, me numër të ndërmarrjeve prej 15.93%, me të punësuar 14.78% dhe me qarkullim vjetor 13.49%, krahasuar me regjionet tjera.

Regjioni i Pejës, zë vendin e katërt, me numër të ndërmarrjeve 10.06%, të punësuar 10.68% dhe qarkullim vjetor 10.09%.

Në vendin e pestë radhitet regjioni i Gjiilanit me 10.24%, në numër të ndërmarrjeve, pastaj me 10.56% të punësuar ndërsa në qarkullim vjetor prej 11.47% në vendin e katërt.

Regjioni i Gjakovës radhitet në vendin e gjashtë për nga numri i ndërmarrjeve me 10.73%, me 11.24% të punësuar, që këtë regjion e radhit në vendin e katërt në punësim dhe me qarkullim vjetor prej 11.25%.


Regjioni i Mitrovicës radhitet në vendin e shtatë me numër të ndërmarrjeve prej 7.88%, me 7.61% të punësuar, si dhe me qarkullim me 6.87%. Nga analiza e këtyre të dhënave mund të konstatojmë se në disa regjione kemi rritje të treguesve p.sh në punësim si rezultat i arritjes së

marrëveshjeve tregtare me përmasa edhe në eksporte siç është rasti i regjionit të Gjakovës me ndërmarrjet në nën sektorët e tekstilit, drurit dhe mobileve.

1.1. Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe nën sektorëve

Në kuadër të zhvillimit ekonomik, vlerësuar rëndësinë që e ka Sektori-C dhe bazuar në analizat statistikore, janë përpunuar të dhënat edhe nga aspekti i madhësisë së ndërmarrjeve nëpër nën sektorët e Industrisë përpunuese, për vitin 2020.

Figura 2. Sektori-C, nën sektorët sipas madhësisë së ndërmarrjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat e prezantuara, në figura nr. 2, Sektori-C, sipas madhësisë së ndërmarrjeve tregojnë se në Kosovë, 86.3% janë ndërmarrje mikro, pastaj 11.86% janë ndërmarrje të vogla, 1.67%, ndërmarrje të mesme dhe 0.17% ndërmarrje të mëdha. Në kuadër të Sektorit-C (10-33) vetëm pesë nën sektorë bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha.

Nga kategoria e mikro-ndërmarrjeve, nën sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve është “Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve”, me gjithsejtë 98.57%, nga totali i ndërmarrjeve në këtë kategori, pasuar nga nën sektori “Prodhimi tjetër p.k.t”, me 92% dhe i treti sipas kësaj renditje është nën sektori “Prodhimi i veshjeve” me 90.63%.

Në kategorinë e ndërmarrjeve të vogla, nën sektorët “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio” dhe “Prodhimi i produkteve të duhanit”, marrin pjesë me nga 50%, në numrin e ndërmarrjeve, në kuadër të Sektorit-C, pasuar nga nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës” me 25%, nga numri i përgjithshëm.

Kategorisë së ndërmarrjeve të mesme, i prinë nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike” me 16.67%, pasuar nga ndërmarrjet në nën sektorin “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, me 12.5% dhe i treti, në kategorinë e ndërmarrjeve të mesme radhitet nën sektori “Prodhimi i pijeve” me 8.45%.

Nga vlerësimi i të dhënave të analizuara, kategoria e ndërmarrjeve të mëdha, në ekonominë e vendit, ka numër të vogël të ndërmarrjeve. Nën sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve, nga ky kategorizim, është “Prodhimi i pijeve” me 4.23%, pasuar nga nën sektori “Prodhimi i Metaleve” me 1.01%, i treti radhitet nën sektori “Prodhimi i Mobilieve” me 0.22%, i katërti është nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 0.21% dhe në fund radhitet nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 0.16%. Vlen të theksohet se shumica e nën sektorëve që e përbëjnë nomenklaturën e Sektorit-C, nuk bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha.

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Përpunimi i Metaleve”, ka 89.9% ndërmarrje mikro, 9.09% ndërmarrje të vogla, ndërsa nga kategoria e ndërmarrjeve të mesme kemi 0%, si rezultat që këto biznese nga ky nën sektor kanë arritur të zhvillohen, (të rrisin kapacitetin prodhues dhe numrin e të punësuarve), që do të thotë se kanë kaluar në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha me 1.01%, në kuadër të Sektorit-C.

Nën sektori “Prodhimi i mobilieve”, aktivitetin ekonomik e zhvillon në 86.62% ndërmarrje mikro, 11.4% në ndërmarrje të vogla, 1.75% në ndërmarrje të mesme dhe 0.22% në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha.

Në nën sektorin “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” kemi 75.21% mikro ndërmarrje, 20.94% të vogla, 3.63% të mesme dhe 0.21% janë ndërmarrje të mëdha. Nga ky kategorizim kemi edhe nën sektorin me pjesëmarrje në të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve, siç është “Përpunimi i produkteve ushqimore” i cili aktivitetin ekonomik e zhvillon në 88.93% mikro ndërmarrje, 9.43% në të vogla, 1.48% prej tyre të mesme dhe 0.16% në ndërmarrje të mëdha. I fundit me pjesëmarrje në të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve sipas madhësisë, radhitet nën sektori “Prodhimi i Pijeve” me 69.01%, në mikro ndërmarrje, 18.31% të vogla, 8.45%, të mesme dhe 4.23%, ndërmarrje të mëdha ku në këtë kategorizim ka përqindjen më të lartë në numër të ndërmarrjeve në kuadër të Sektorit-C, për vitin 2020.

2. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera, për Sektorin – C (Industria përpunuese)

Treguesi i numrit të ndërmarrjeve eksportuese, sipas nën sektorëve të industrisë përpunuese, tregon pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në eksport. Sipas OECD-së “Më pak se 10% e ndërmarrjeve janë eksportuese në të gjitha vendet,”⁴.

Nga gjithsej 5,637 ndërmarrje në kuadër të Sektorit-C, 1007 apo 17.9% janë ndërmarrje eksportuese.

Të dhënat në tabelën nr.8, paraqesin një pasqyrim të vlerave të importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe me vendet e tjera, për nën sektorët e Sektorit-C, për vitet 2018-2020.

Sektorin-C, në eksportin e përgjithshëm merr pjesë me 84%

• Eksportet, Sektorin - C

Vlera e përgjithshme e eksporteve, për vitin 2020, në vendet e BE-së , CEFTA-së , EFTA-së dhe vendet tjera, ishte 474.88 milion euro, ndërsa sektori i industrisë përpunuese ka marrë pjesë me vlerë prej 398.46 milion euro, apo rreth 84%, në kuadër të eksportit të përgjithshëm.

Të dhënat në tabelën nr. 8, tregojnë se rritja e Eksporteve të Sektorit-C, për vitin 2020, është më e lartë për 36.6%, krahasuar me vitin 2019, pasi që rritja e eksporteve në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 ishte 12,95%.

Eksportet gjatë vitit 2020, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Prodhimi i metaleve”, me pjesëmarrje prej 28.21%, ndërsa krahasuar me vitin 2019, ky nën sektor, ka pasur rritje për 48.17%. Vendet me të cilat është realizuar më së tepërmi eksport nga ky nën sektor janë: në Shqipëri me 41.04%, në Itali me 16.45%, në Maqedoninë e Veriut me 8.11%, në Serbi me 7.84%, etj.

Rritja eksponenciale e eksporteve nga Kosova, në nën sektorin “Prodhimi i metaleve”, në vitin 2020, është shënuar në Slloveni, në Suedi, Shqipëri, Britani e Madhe dhe në Holandë.

Vlen të theksohet se, përderisa Kosova nuk kishte eksportuar në vitin 2019 në Kinë, në vitin 2020 ka eksportuar produktet e këtij nën sektori në vlerë prej 2.97 milion euro.

Në vendin e dytë radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve të plastikës dhe gomës” me pjesëmarrje prej 14.63%, në kuadër të Sektorit-C, ndërsa ky nën sektor ka shënuar rritje për 13.19%, krahasuar me vitin 2019. Prodhimet e këtij nën sektori kryesisht janë eksportuar në Zvicër me 18.15%, në Gjermani me 18.04%, në Holandë me 14.98%, në Serbi me 8.37% dhe në Shqipëri me 7.86%.

Rritja e theksuar e eksporteve të Kosovës, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve të plastikës dhe gomës”, në vitin 2020 është shënuar në Francë në vlerë prej 1.46 milion euro nga 646 mijë

⁴ Exports by enterprise size class - OECD i Library / https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf?

euro, sa ishte në vitin 2019. Në vendin e dytë me rritje të eksporteve, radhitet Belgjika me 96%, pastaj Zvicra me 41%, Gjermania me 23%, Shqipëria me 21%.

Një ndër shtetet, që Kosova ka pasur eksporte me vlerë të lartë në vitin 2019 ishte Holanda me 10.3 milion euro, ndërsa në vitin 2020 eksportet shënuan rënie në vlerë prej 8.73 milion euro apo 15%. Rënie e eksporteve të produkteve në këtë nën sektor është shënuar edhe në Maqedoninë e Veriut, për 6.5%.

Në vendin e tretë, me pjesëmarrje në eksport, radhitet nën sektori “Prodhimi i mobileve” me 8.42% dhe me rritje prej mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e mobileve kryesisht janë eksportuar në SHBA me 35.74%, në Zvicër me 25.54%, në Gjermani me 12.18% , etj.

Vendi në të cilin është eksportuar më së tepërmi, në nën sektorin “Prodhimi i mobileve” në vitin 2020, janë: SHBA me vlerë prej rreth 12 milion euro, për derisa në vitin 2019 vlera e eksporteve ishte rreth 155 mijë euro. Kjo rritje e eksporteve të Kosovës me SHBA është si rezultat i marrëveshjes për shitjen e dyshekëve. Në vendin e dytë radhitet Holanda me rritje në vlerë prej 441 mijë euro nga rreth 50 mijë euro sa ishte në vitin 2019, që tregon se është shumëfishuar vlera e eksporteve të Kosovës në këtë vend. Në vitin 2020 Shqipëria radhitet në vendin e tretë me një rritje prej 95%, krahasuar me vitin 2019, ndërsa eksportet e Kosovës kanë shënuar rritje me mbi 40% janë Austria, Zvicra dhe Maqedonia. Vlen të theksohet se përderisa, në vitin 2019, Kosova nuk kishte eksportuar në Kanada, në vitin 2020 ka eksportuar në vlerë prej 1.68 milion euro.

Në kuadër të nën sektorëve, i katërti me radhë, në eksporte është nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 8.38%, i cili në vitin 2020 ka shënuar rritje për 17.51%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet ushqimore janë eksportuar në Shqipëri për 16.51%, në Gjermani për 14.74%, në Serbi me 13.8%, Maqedoninë e Veriut me 10.45% etj.

Rritja e eksporteve të Kosovës, në nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore”, në vitin 2020 krahasuar me 2019, është në Gjermani me 95%, në Serbi me 53%, në Suedi me 38% etj. Ndërsa rënie e theksuar e eksporteve është shënuar në Austri për 42%, në Bosnje dhe Hercegovinë për 29% dhe në Maqedoninë e Veriut për 4%. Nën sektori “Prodhimi i pijeve”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 7.45% dhe me rritje në eksport për 3.49%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e pijeve janë eksportuar në Shqipëri me 46.80%, në Maqedoninë e Veriut me 15.72%, në Bullgari me 5.98%, në Kroaci me 5.73% etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike”, ka pjesëmarrje në eksport me 7.96% dhe me rritje të theksuar prej 35.3%, krahasuar me vitin 2019. Eksporti i këtyre produkteve kryesisht është realizuar në Zvicër me 17.83%, në Gjermani me 15.9%, në Shqipëri me 12.36%, në Holandë me 9.34% etj.

Rritja e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike”, krahasuar me vitin 2019 është në Francë me mbi 100%, në Holandë me 71%, në Gjermani dhe në Shqipëria me nga 56% dhe në Belgjikë me 55%. Ndërsa rënie në eksport kishte në Kazakistan për 34% dhe një rënie e lehtë në Maqedoninë e Veriut me 3%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë në eksport me 4.93%, me rritje të lartë mbi 100%, nga viti paraprak. Këto produkte janë eksportuar në

Shqipëri me 15.85%, në Britani të Madhe me 12.41%, në Itali me 11.89%, në Gjermani me 10.3% etj.

Rritje eksponenciale të eksporteve të Kosovës, në vitin 2020, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve kimike”, është shënuar në Britaninë e Madhe, në vlerë prej 2.44 milion euro nga 12 mijë euro sa ishte në vitin 2019, si dhe në Suedi nga rreth 32 mijë euro në 690 mijë euro në vitin 2020. Përderisa Kosova nuk kishte eksportuar në vitin 2019 në republikën Çeke në vitin 2020 ka eksportuar në vlerë prej 517 mijë euro.

Nën sektori “Prodhimi i pijeve”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 7.45% dhe me rritje në eksport prej 3.49%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e pijeve janë eksportuar në Shqipëri me 46.80%, në Maqedoninë e Veriut me 15.72%, në Bullgari me 5.98%, në Kroaci me 5.73% etj.

Rritje të eksporteve të Kosovës, në nën sektorin “Prodhimi i Pijeve”, në vitin 2020 krahasuar me 2019, kemi në Gjermani me 53%, në Kroaci me 30%, në Bullgari me 28%, në Zvicër me 26% etj.

Ndërsa rënie e eksporteve është shënuar në Serbi për 39%, në Mal të Zi për 38%, në Bosnje dhe Hercegovinë për 25% etj.

Nën sektori “Prodhimi i tekstilit”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 4.5% dhe me rritje në eksporte mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhimit të tekstilit janë eksportuar në SHBA me 42%, në Gjermani me 12%, në Shqipëri me 11% etj.

Rritja eksponenciale e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me 2019, është shënuar në nën sektorin “Prodhimi i tekstilit”, në SHBA në vlerë, nga 625 mijë euro në 7.62 milion euro, në Liban nga 42 mijë euro në 543 mijë euro, në Zvicër nga 82 mijë euro në 351 mijë euro dhe në Shqipëri nga 651 mijë euro në 1.9 milion euro, ndërsa rënie të eksporteve është shënuar në Gjermani për 4%.

Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 1.29% dhe me rritje në eksporte për 57%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e veshjeve janë eksportuar në SHBA me 33%, në Itali me 11%, në Gjermani me 9%, Zvicër 7% etj.

Rritja eksponenciale e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me 2019, është shënuar në nën sektorin “Prodhimi i veshjeve”, në SHBA në vlerë, nga 384 mijë euro në 1.69 milion euro dhe në Australi nga 20 mijë euro në 122 mijë euro. Po ashtu, rritje e eksporteve mbi 100% është shënuar në Zvicër, Gjermani dhe Katar. Rënie të eksporteve është shënuar në Holandë për 57%, në Maqedoninë e Veriut për 27 %, në Itali për 8% etj.

Nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 0.59% dhe me rënie në eksporte për 24%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga lëkura janë eksportuar në Francë me 30%, në Shqipëri me 29%, në Poloni me 23%, etj.

Rritja e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me 2019, në nën sektorin “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura”, është shënuar në Shqipëri nga 214 mijë euro në 667 mijë euro. Vlen të theksohet se, Kosova nuk kishte eksportuar produkte të këtij nën sektori, në vitin 2019 në Poloni, në vitin 2020 ka eksportuar në vlerë prej 536 mijë euro. Rënie e lartë e eksporteve është shënuar në Itali për 84%, në France për 43 %, etj.

Nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 2.61% dhe me rritje në eksporte për 35.6%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga druri dhe tapa janë eksportuar në Zvicër me 36.5%, në Gjermani me 28.12%, etj. Rritja e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me 2019, në këtë nën sektor, është shënuar në Gjermani me 96%, në Zvicër me 51% etj. Vlen të theksohet se Kosova ka eksportuar në Greqi, edhe pse në vlerë jo të madhe, nga 23 mijë euro sa ishte në vitin 2019 në 164 mijë në vitin 2020. Rënie e eksporteve janë shënuar në Shqipëri për 30%, në Slloveni për 8%, në Maqedoninë e Veriut për 5%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i letrës dhe i produkteve prej letrës”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 0.73% dhe me rritje në eksporte për 41.9%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga letra janë eksportuar në Shqipëri me 37.6%, në Maqedoninë e Veriut për 23.4%, etj. Rritja e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me 2019, në këtë nën sektor, është shënuar në Shqipëri, Gjermani, Francë, Serbi dhe në Mal të Zi me mbi 100% të vlerës. Në vitin 2020 një treg i ri i eksporteve për produktet e letrës është Austria me vlerë prej 123 mijë euro. Rënie të eksporteve janë shënuar në Bosnje dhe Hercegovinë për 46%, në Maqedoninë e Veriut për 30%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 2.4% dhe me rritje në eksporte për 26.63%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Zvicër me 22%, në Shqipëri me 17%, në Maqedoninë e Veriut për 14%, në Gjermani dhe në Mal të Zi me nga 13%, etj.

Rritja e eksporteve të Kosovës, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, të produkteve jo metalike është shënuar në Mal të Zi, në Kroaci dhe në Rumani me mbi 100% të vlerës, ndërsa me rreth 40%, është eksportuar si në Zvicër dhe në Serbi. Në vitin 2020 një treg i ri i eksporteve për produktet minerale jo metalike është Republika e Koresë me vlerë prej 96 mijë euro. Rënie e eksporteve është shënuar në Itali për 48%, në Shqipëri për 2.7%, etj.

• Importet, Sektori-C

Totali i importeve nga vendet e BE-së , CEFTA-së , EFTA-së dhe nga vendet tjera, për vitin 2020, është 3.29 miliard euro, ndërsa Sektori-C ka marrë pjesë me vlerë prej 3.06 miliard euro, apo rreth 93%.

Sektori-C, në importin e përgjithshëm merr pjesë me 93%.

Importet gjatë vitit 2020, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 15.24% edhe pse krahasuar me vitin 2019, ky nën sektor ka pasur rritje të lehtë për 1.61%. Këto produkte janë importuar nga Gjermania për 9.20%, nga Italia për 9.16%, nga Maqedonia e Veriut për 9%, nga Turqia për 7.67%, nga Serbia për 6.92%, etj.

Në vendin e dytë radhitet nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike rimorkio dhe gjysmë rimorkio”, me pjesëmarrje prej 8.76% në importe të Sektorit-C, por me rënie prej 10.53%, nga

viti paraprak. Këto mjete janë importuar nga Gjermania për 69.88%, nga Franca për 5.32%, nga Britania e Madhe për 3.79%, nga Italia për 2.46%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike”, radhitet në vendin e tretë në import, me pjesëmarrje prej 8.40% dhe ka shënuar rritje për 8.03%, krahasuar me vitin 2019. Produktet kimike kryesisht janë importuar nga Gjermania për 12.89%, nga Turqia për 12.76%, nga Italia për 5.95%, nga Maqedonia e Veriut për 5.78%, nga Sllovenia për 3.02%, etj.

Në vendin e katërt radhitet nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara nga nafta”, me pjesëmarrje në Sektorin-C me 8.07% dhe me rënie për 37.58%, nga viti paraprak. Këto produkte janë importuar nga Greqia për 31.23%, nga Rusia për 9.16%, nga Maqedonia e Veriut për 8.34%, nga Italia për 8.28%, nga Izraeli për 8.19%, etj.

Industria e prodhimit të metaleve, edhe pse në importe radhitet në vendin e pestë, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë me 7.88% dhe ka shënuar rënie për 8.81%, krahasuar me vitin 2019. Produktet e metaleve janë importuar nga Shqipëria për 35.45%, nga Maqedonia e Veriut për 10.9%, nga Turqia për 9.36%, Bosnja dhe Hercegovina për 6.98%, etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve”, në vitin 2020, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë me 6.75%, por ka shënuar rënie për 5.14% krahasuar me vitin 2019. Këto produkte janë importuar nga Kina për 21.25%, nga Gjermania për 18.73%, nga Turqia për 16.78%, nga Italia për 12.48%, etj.

Vlerësuar sipas pjesëmarrjes në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike”, radhitet i shtati me 5.59%, me rritje modeste prej 2.15% në importe krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Shqipëria për 19.93%, nga Maqedonia e Veriut për 16.23%, nga Kina për 10.12%, nga Turqia për 8.23%, etj.

Vështruar në Tabelën nr. 8, numri më i madh i nën sektorëve që i takojnë Sektorit-C, kanë shënuar rënie në importe gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin paraprak, gjë që është tregues i mirë, duke e ditur faktin që ekonomia e vendit tonë ka disbalancë tregtar të thellë. Prandaj ky vit na bën të shpresojmë për rritje të eksporteve dhe zëvendësim të importeve.

Tabela 8. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe Vendet tjera 2018 – 2020

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2018	2019	2020	Ndryshimi (2020>2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	34,588,451.58	28,424,151.36	33,402,372.88	4,978,221.52	17.51	430,684,698.03	459,196,871.23	466,609,046.82	7,412,175.59	1.61
11	Prodhimi i pijeve	27,565,225.96	28,665,800.23	29,666,793.39	1,000,993.16	3.49	78,580,037.59	82,588,664.30	77,586,544.73	(5,002,119.57)	(6.06)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-		64,847,952.16	68,512,606.49	63,009,976.51	(5,502,629.98)	(8.03)
13	Prodhimi i Tekstilit	6,136,824.19	7,875,908.03	17,948,552.17	10,072,644.14	127.89	58,660,751.55	56,796,552.95	66,662,771.63	9,866,218.68	17.37
14	Prodhimi i veshjeve	2,179,544.62	3,293,023.19	5,156,424.34	1,863,401.15	56.59	105,171,177.93	118,008,278.57	98,738,284.03	(19,269,994.54)	(16.33)
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	2,735,479.11	3,080,819.54	2,335,812.77	(745,006.77)	(24.18)	44,554,440.03	49,380,964.63	38,212,879.80	(11,168,084.83)	(22.62)
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshtuara-thurëse	5,408,715.00	7,677,012.54	10,409,819.21	2,732,806.67	35.60	69,299,228.65	75,584,593.05	68,913,586.17	(6,671,006.88)	(8.83)
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letërës	2,420,018.61	2,039,439.64	2,893,870.02	854,430.38	41.90	58,497,122.07	61,938,776.04	58,771,929.99	(3,166,846.05)	(5.11)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-		430,172.03	192,046.50	140,039.96	(52,006.54)	(27.08)
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	1,344,980.72	2,655,565.82	1,428,173.61	(1,227,392.21)	(46.22)	393,716,432.65	395,650,224.84	246,979,760.45	(148,670,464.39)	(37.58)

20	Prodhimi i produkteve kimike	5,867,275.26	8,160,771.92	19,634,905.19	11,474,133.27	140.60	226,642,896.45	237,989,157.53	257,101,389.35	19,112,231.82	8.03
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,874,824.80	931,976.93	735,067.86	(196,909.07)	(21.13)	69,038,489.78	69,624,461.97	93,239,025.99	23,614,564.02	33.92
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	46,454,152.31	51,494,994.46	58,284,613.04	6,789,618.58	13.19	151,108,932.16	155,217,193.08	151,630,341.62	(3,586,851.46)	(2.31)
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,843,754.76	7,592,128.25	9,613,701.30	2,021,573.05	26.63	166,279,334.09	167,647,853.52	171,245,487.79	3,597,634.27	2.15
24	Prodhimi i Metaleve	63,135,997.19	75,872,939.29	112,420,890.58	36,547,951.29	48.17	263,854,273.63	264,476,551.92	241,185,291.40	(23,291,260.52)	(8.81)
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuarra metalike	21,478,381.68	23,451,261.04	31,730,428.78	8,279,167.74	35.30	110,032,985.05	112,031,510.36	124,107,528.74	12,076,018.38	10.78
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	3,019,765.97	5,318,945.82	8,256,502.33	2,937,556.51	55.23	110,119,840.51	108,667,847.51	108,189,194.60	(478,652.91)	(0.44)
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	2,254,567.39	4,180,545.40	3,768,112.38	(412,433.02)	(9.87)	149,458,728.23	148,011,315.93	151,215,298.70	3,203,982.77	2.16
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	6,554,436.54	8,057,317.86	9,424,222.44	1,366,904.58	16.96	214,632,826.68	217,871,513.60	206,678,136.71	(11,193,376.89)	(5.14)
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	2,180,302.39	2,924,958.97	4,086,495.42	1,161,536.45	39.71	253,292,372.42	299,743,201.02	268,176,636.63	(31,566,564.39)	(10.53)
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	43,898.84	87,518.23	106,339.81	18,821.58	21.51	10,480,382.61	8,368,461.37	15,983,817.52	7,615,356.15	91.00
31	Prodhimi i mobileve	10,541,831.77	15,316,687.30	33,561,425.11	18,244,737.81	119.12	49,638,936.13	49,691,848.08	38,988,969.43	(10,702,878.65)	(21.54)
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	4,623,853.10	4,599,984.53	3,596,557.03	(1,003,427.50)	(21.81)	42,744,366.08	46,106,308.49	47,986,428.74	1,880,120.25	4.08
	Gjithsej	258,252,281.79	291,701,750.35	398,461,079.66	106,759,329.31	36.60	3,121,766,376.51	3,253,296,802.98	3,061,352,367.31	(191,944,435.67)	(5.90)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

2.1. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së

Eksportet me vendet e BE-së, për vitin 2020, janë në vlerë prej 144.17 milion euro, që do të thotë se kanë shënuar rritje për 38%, ndërsa vlera e importit është 1.41 miliard euro dhe paraqet rënie në importe për rreth 12.46%, krahasuar me vitin 2019.

Bazuar në tabelën nr. 9, në totalin e shkëmbimeve tregtare për vitin 2020, Kosovë – BE, eksporti merr pjesë me 9.26%, ndërsa importi me 90.74% mund të themi se kemi një trend në rritje të eksporteve, krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 9. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së për vitin 2018– 2020

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2018	2019	2020	Ndryshimi	Ndryshimi në %	2018	2019	2020	Ndryshimi	Ndryshimi në %
					(2020 >2019)	(2020>2019)				(2020 >2019)	(2020>2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	15,082,335.64	10,200,710.55	13,178,958.60	2,978,248.05	29.2	199,105,288.62	270,298,066.20	261,901,243.38	(8,396,822.82)	(3.11)
11	Prodhimi i pijeve	4,995,245.58	5,473,128.63	6,456,618.94	983,490.31	17.97	26,021,867.32	55,107,797.10	40,596,444.54	(14,511,352.56)	(26.33)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-		41,792,056.23	49,255,240.41	46,168,805.65	(3,086,434.76)	(6.27)
13	Prodhimi i Tekstilit	2,467,159.55	3,788,717.63	3,840,869.08	52,151.45	1.38	7,977,414.19	7,929,205.65	7,127,854.00	(801,351.65)	(10.11)
14	Prodhimi i veshjeve	1,061,574.28	2,042,388.01	1,890,517.46	(151,870.55)	(7.44)	8,205,765.46	7,432,895.22	5,676,436.48	(1,756,458.74)	(23.63)
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	2,128,796.75	2,570,831.25	1,442,825.65	(1,128,005.60)	(43.88)	3,763,189.55	4,252,600.02	3,238,301.52	(1,014,298.50)	(23.85)
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	1,357,154.93	3,112,584.10	4,743,204.51	1,630,620.41	52.39	24,746,781.03	38,620,394.41	30,195,842.71	(8,424,551.70)	(21.81)
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	117,955.83	192,086.18	590,510.97	398,424.79	207.42	24,803,665.74	34,051,389.79	27,748,346.19	(6,303,043.60)	(18.51)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-		64,706.15	47,165.52	21,713.70	(25,451.82)	(53.96)

19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	77.76	535.05	45,994.86	45,459.81	8,496.37	216,457,787.04	205,572,380.02	135,657,078.52	(69,915,301.50)	(34.01)
20	Prodhimi i produkteve kimike	1,977,752.24	3,137,342.94	10,259,254.03	7,121,911.09	227	118,725,038.15	139,793,906.33	140,242,511.42	448,605.09	0.32
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	81,912.60	17,520.00	-	(17,520.00)	(100.00)	45,105,305.24	47,944,225.47	57,724,657.19	9,780,431.72	20.4
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	21,070,930.83	25,466,885.43	28,403,227.43	2,936,342.00	11.53	73,260,684.83	81,664,634.12	73,875,700.18	(7,788,933.94)	(9.54)
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	1,366,795.28	1,834,013.95	2,290,815.98	456,802.03	24.91	54,789,670.69	60,825,685.50	51,408,920.13	(9,416,765.37)	(15.48)
24	Prodhimi i Metaleve	1,804,643.12	20,690,712.12	36,720,531.68	16,029,819.56	77.47	37,867,343.46	59,298,364.72	46,357,191.42	(12,941,173.30)	(21.82)
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	7,195,530.59	9,464,910.03	15,629,796.69	6,164,886.66	65.13	45,162,475.02	52,897,096.94	51,310,860.99	(1,586,235.95)	(3.00)
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	388,034.96	2,287,040.96	3,291,252.08	1,004,211.12	43.91	26,318,532.12	28,988,870.78	25,053,553.88	(3,935,316.90)	(13.58)
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	609,221.73	869,658.06	888,130.18	18,472.12	2.12	44,070,023.07	53,098,346.80	48,787,559.90	(4,310,786.90)	(8.12)
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	2,259,488.52	2,944,540.30	3,833,599.99	889,059.69	30.19	129,737,414.35	112,081,734.77	99,365,153.16	(12,716,581.61)	(11.35)
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	818,311.06	1,329,593.58	1,219,522.33	(110,071.25)	(8.28)	232,960,058.91	275,939,984.88	234,483,389.92	(41,456,594.96)	(15.02)
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	9,558.50	9,133.96	5,660.66	(3,473.30)	(38.03)	3,036,545.33	2,003,524.33	2,078,898.90	75,374.57	3.76
31	Prodhimi i mobileve	3,649,272.54	5,518,831.18	6,863,507.74	1,344,676.56	24.37	11,605,332.23	11,603,778.03	7,456,528.64	(4,147,249.39)	(35.74)
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	3,529,190.71	3,519,163.57	2,579,009.15	(940,154.42)	(26.72)	11,616,242.23	14,667,964.57	15,902,511.31	1,234,546.74	8.42
	Gjithsej	71,970,943.00	104,470,327.48	144,173,808.01	39,703,480.53	38.00	1,387,193,186.96	1,613,375,251.58	1,412,379,503.73	(200,995,747.85)	(12.46)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksportet me vendet e BE**

Në vendin e parë, me pjesëmarrje në eksport me vendet e BE-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i metaleve” me 25.47%, për derisa ka shënuar rritje të lartë në eksport për 77.47%, krahasuar me vitin 2019. Vendet në të cilat janë eksportuar produktet e metaleve janë në Itali me 50.37%, në Finlandë me 13.58%, në Suedi me 13.44%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, merr pjesë me 19.70%, në totalin e eksporteve me vendet e BE-së, ndërsa krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 11.53%. Ky eksport, kryesisht është realizuar në Gjermani me 37.01%, në Holandë me 30.75%, në Belgjikë me 13.48%, etj.

Në vitin 2020, nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” merr pjesë me 9.14%, ku ka shënuar rritje për 29.20% krahasuar me vitin paraprak. Eksportet e produkteve ushqimore, destinimin e tregut e kanë shënuar në Gjermani me 37.35%, në Itali me 20.92%, në Austri me 7.49%, etj.

Rritje të eksportit, në vendet e BE-së, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ka shënuar nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike” për 65.13%. Në totalin e eksporteve të Sektorit-C, me vendet e BE-së, ky nën sektor merr pjesë me 10.84%. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Gjermani me 32.28%, në Holandë me 18.96%, në Francë 17.84%. në Itali me 10.75%, etj.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019, rritje ka shënuar nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” me mbi 100% dhe me pjesëmarrje për 7.12% në kuadër të eksporteve me vendet e BE-së. Produktet kimike janë eksportuar në Itali me 22.75%, në Gjermani me 19.71%, në Holandë me 16.7%, etj.

Rënie në eksport, gjatë vitit 2020 ka shënuar nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike” me 100%, dhe nën sektori “Prodhimi i Lëkurës dhe produkteve nga lëkura” me 43.88%.

- **Importet me vendet e BE-së**

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 9 vërehet se vetëm 4 nga 23 nën sektorë kanë shënuar rritje në import me vendet e BE-së gjatë vitit 2020, përderisa rënie kanë shënuar 19 nën sektorët tjerë të Sektorit C.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike”, me 20.4% ka shënuar rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 në importin me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C edhe pse me pjesëmarrje të ulët, vetëm 4.09% në vitin 2020. Nga këto të dhëna konstatohet se raporti trajton kohën kur vendi ynë dhe i gjithë globi është ballafaquar me pandeminë Covid-19. Produktet farmaceutike janë importuar nga Gjermania për 24.07%,

nga Sllovenia për 15.45%, nga Italia për 15.29%, nga Danimarka për 7.74%, nga Austria për 7%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, merr pjesë në importe me 18.54% në kuadër të Sektorit C, por në vitin 2020 ka shënuar rënie në importe për 3.11% krahasuar me vitin 2019. Produktet ushqimore janë importuar nga Gjermania me 16.4%, nga Italia për 16.32%, nga Polonia për 12.05%, nga Sllovenia për 10.86%, nga Kroacia për 10.66%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio”, në kuadër të Sektorit-C, me pjesëmarrje në importe me vendet e BE-së, është 16.6%, me rënie për 15.02% në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak. Importi është realizuar nga Gjermania për 79.92%, nga Franca për 6.09%, nga Çekia për 3.88%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” merr pjesë me 9,93% në totalin e importeve me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C. Në vitin 2020, ka shënuar rritje të lehtë në importe për 0.3%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet kimike importohen nga Gjermania 23.64%, nga Italia për 10.9%, nga Polonia për 10.59%, nga Austria për 7.32%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i koksit dhe produkteve të rafinuara nga nafta”, merr pjesë me 9.6%, ndërsa ka shënuar rënie të theksuara të importit në vitin 2020 për 34.01% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Greqia për 56.85%, nga Italia për 15.07%, nga Bullgaria për 8.84%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t” merr pjesë në importe të vendeve të BE-së me 7.04%, me rënie importi në 2020 prej 11.35% krahasuar me vitin paraprak. Importin më të lartë e ka realizuar nga Gjermania me 38.95% dhe nga Italia me 25.96%, nga Austria me 5.27%, etj.

Pjesëmarrja në importe e nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” është 5.23%, por me rënie për 9.54% krahasuar me vitin 2019. Produktet e këtij nën sektori janë importuar nga Gjermania 44.2%, nga Bullgaria me 10.43%, nga Italia 9.83%, nga Polonia 7.9%, etj.

Nën sektorët me potencialin më të vogël importues në kuadër të importeve me vendet e BE-së, janë “Prodhimi i Tekstilit”, me 0.5% dhe me rënie importi në vitin 2020, me 10.11%, pasuar nga nën sektori “Prodhimi i Veshjeve”, me pjesëmarrje prej 0.4%, rënie prej 23.63% dhe po ashtu nën sektori i “Prodhimi i Lëkurës dhe produkteve nga lëkura”, me 0.2% dhe rënie prej 23.85%

2.2. Eksporti dhe importi me vendet e CEFTA-së

Në Tabelën nr.10 janë pasqyruar vlerat e importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së për nën sektorët (10 deri 33) në kuadër të Sektorit-C.

Në përgjithësi, Eksportet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, në vitin 2020, kanë shënuar rritje të theksuar për 50.94%, për kundërrënies së importeve për 17.76% edhe pse vazhdojmë të kemi deficit tregtar në vlerë prej 372.47 milion euro.

Tabela 10. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për sektorët e industrisë, 2018 – 2020

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Bilanci		Importi			Bilanci	
		2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020>2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	17,041,347.33	14,357,962.18	15,822,484.52	1,464,522.34	10.20	131,263,249.23	63,581,293.51	93,560,843.04	29,979,549.53	47.15
11	Prodhimi i pijeve	20,992,801.46	21,341,142.71	20,740,122.01	(601,020.70)	(2.82)	48,273,487.33	22,472,368.09	32,540,492.94	10,068,124.85	44.80
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-	-	2,636,871.60	1,645,261.50	2,277,951.00	632,689.50	38.46
13	Prodhimi i Tekstilit	1,757,528.84	3,040,604.31	5,228,563.64	2,187,959.33	71.96	2,342,480.35	1,108,200.27	2,822,984.26	1,714,783.99	154.74
14	Prodhimi i veshjeve	731,217.75	517,408.79	488,449.48	(28,959.31)	(5.60)	1,563,651.31	511,477.99	1,132,013.28	620,535.29	121.32
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	529,904.61	500,696.70	877,298.80	376,602.10	75.22	1,391,126.05	719,700.93	1,222,866.53	503,165.60	69.91
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	1,531,782.82	1,879,859.73	1,744,933.42	(134,926.31)	(7.18)	22,175,711.80	15,500,859.88	19,325,981.97	3,825,122.09	24.68
17	Prodhimi i letres dhe produkteve prej letres	2,228,012.70	1,790,001.45	2,188,547.87	398,546.42	22.27	22,118,035.70	13,921,943.96	17,775,005.88	3,853,061.92	27.68
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	1,344,902.96	2,655,010.77	1,382,178.75	(1,272,832.02)	(47.94)	116,179,032.43	70,576,780.70	33,593,347.96	(36,983,432.74)	(52.40)
20	Prodhimi i produkteve kimike	3,675,880.08	4,795,288.74	6,602,405.92	1,807,117.18	37.69	40,822,848.83	17,719,070.31	33,877,240.24	16,158,169.93	91.19
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	339,794.93	579,108.09	86,049.36	(493,058.73)	(85.14)	9,689,288.57	5,823,574.61	10,450,113.77	4,626,539.16	79.45
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	15331416.87	14,537,627.77	15,555,357.82	1,017,730.05	7.00	33892012.02	21463573.9	26491523.57	5,027,949.67	23.43
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	4,233,047.40	3,597,513.73	4,921,744.61	1,324,230.88	36.81	67,415,416.30	56,526,379.01	72,491,495.96	15,965,116.95	28.24
24	Prodhimi i Metaleve	23,818,193.33	21,059,759.26	66,234,411.33	45,174,652.07	214.51	179,309,575.20	134,771,893.14	136,655,869.68	1,883,976.54	1.40
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	5,868,510.18	7,218,038.23	9,224,505.71	2,006,467.48	27.80	22,086,923.40	8,159,565.03	18,128,793.07	9,969,228.04	122.18
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	1,740,539.91	1,932,229.50	3,201,790.63	1,269,561.13	65.70	708,452.68	49,994.83	230,590.18	180,595.35	361.23
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	712,460.45	2,108,626.08	1,498,768.21	(609,857.87)	(28.92)	28,054,917.18	12,778,039.02	19,164,292.92	6,386,253.90	49.98
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	2,991,315.35	3,495,179.99	3,957,021.33	461,841.34	13.21	7,855,406.59	3,163,047.99	8,038,065.30	4,875,017.31	154.12
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	596,889.78	810,090.04	1,538,426.36	728,336.32	89.91	1,134,086.36	344,331.00	634,105.24	289,774.24	84.16
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	13,624.46	43,530.78	47,315.01	3,784.23	8.69	172,810.91	8,487.17	165,502.77	157,015.60	1,850.03
31	Prodhimi i mobileve	1,196,476.45	3,282,665.87	4,387,380.58	1,104,714.71	33.65	12,171,537.96	6,715,247.71	7,349,145.23	633,897.52	9.44
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	992,123.16	775,137.63	786,967.29	11,829.66	1.53	999,009.65	133,691.20	1,065,362.68	931,671.48	696.88
	Gjithsej	107,667,770.82	110,317,482.35	166,514,722.65	56,197,240.30	50.94	752,255,931.45	457,694,781.75	538,993,587.47	81,298,805.72	17.76

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet e CEFTA-së**

Eksportet me vendet e CEFTA-së, në Sektorin-C, gjatë vitit 2020, dominohen nga nën sektori “Prodhimi i metaleve”, me pjesëmarrje për 39.78%. Në vitin 2020, ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për mbi 100% krahasuar me vitin 2019. Vendet në të cilat janë eksportuar më së tepërmi produktet e metaleve janë: në Shqipëri me 69.66%, në Maqedoninë e Veriut me 13.76%, në Serbi me 13.31% si dhe Bosnje dhe Hercegovinë me 2.91%.

Nën sektori “Prodhimi i pijeve” merr pjesë në eksporte me këto vende me 12.46%. Ky nën sektor ka shënuar rënie në eksport për 2.82% krahasuar me vitin 2019. Produktet e pijeve janë eksportuar kryesisht në Shqipëri me 66.94%, në Maqedoninë e Veriut me 22.49%, në Serbi me 5.73%, etj.

Pjesëmarrje në eksportet e Sektorit-C me vendet e CEFTA-së ka shënuar edhe nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” për 9.5%. Në vitin 2020 ky nën sektor ka shënuar rritje mbi 10.2% krahasuar me vitin paraprak.

Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Shqipëri 34.86%, në Serbi 29.13% në Maqedoninë e Veriut 22.06% dhe në Bosnje dhe Hercegovinë 10.33%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve nga goma dhe plastika”, në kuadër të Sektorit-C, në eksport merr pjesë me 9.34%. Ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 7% krahasuar me vitin paraprak.

Vendet me të cilat janë eksportuar më së tepërmi produktet e gomës dhe plastikës janë në Serbi me 31.35%, në Shqipëri me 29.45%, në Maqedoninë e Veriut me 24.51%, dhe në Mal të Zi me 8.42%, etj.

Rritje në eksporte për 75.22% ka shënuar nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë”, por kishte pjesëmarrje të ulët në Sektorin-C me vetëm 0.53%. Vendet ku janë eksportuar produktet e lëkurës janë në Shqipëri me 76.06%, në Mal të Zi me 5.54, etj.

Nën sektori “Prodhimi i Tekstilit” edhe pse me pjesëmarrje të ulët në eksportet me vendet e CEFTA-së, me vetëm 3.14% në vitin 2020, kanë shënuar rritje prej 71.96% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë eksportuar në Shqipëri me 36.53%, në Maqedoninë e Veriut me 29.89%, në Serbi me 16.53%, në Bosnjë dhe Hercegovinë me 14.11%, etj.

Rënien më të lartë të eksporteve me vendet e CEFTA-së e ka shënuar “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike” me 85.14% edhe pse ka një pjesëmarrje tejet të ultë me vetëm 0.03%.

- **Importi me vendet e CEFTA-së**

Importet e Kosovës me vendet e CEFTA-së, në vitin 2020, karakterizohen me një rritje të theksuar të produkteve nga Sektori-C, (Industria Përpunuese), në numrin më të madh të nën sektorëve.

Në kuadër të nën sektorëve të Sektorit C, pjesëmarrjen më të lartë në importe me vendet e CEFTA-së e ka nën sektori “Prodhimi i metaleve” me 25.35%. Në vitin 2020, ky nën sektor ka shënuar rritje në import për vetëm 1.4% krahasuar me vitin 2019. Produktet e metaleve kryesisht janë importuar nga Shqipëria për 62.56%, nga Maqedonia e Veriut për 19.24%, nga Bosnja dhe Hercegovina për 12.31%, nga Serbia për 5.58%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” merr pjesë në import me vendet e CEFTA-së me 17.36%. Por në vitin 2020 ka shënuar rritje të importit për 47.15% krahasuar me vitin paraprak. Produktet ushqimore janë importuar nga Maqedonia e Veriut për 44.90%, nga Serbia për 34.52%, nga Bosnja dhe Hercegovina për 9.94%, nga Shqipëria për 7.53%, etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me pjesëmarrje në importe për 13.45%. Në vitin 2020 ky nën sektor ka shënuar rritje në import për 28.24% krahasuar me vitin 2019. Produktet për këtë nën sektor janë importuar nga Shqipëria për 47.07%, nga Maqedonia e veriut 38.34%, nga Serbia për 14.40%, etj.

Nga nën sektorët me prioritet, rritje të theksuar në importe gjatë vitin 2020, ka shënuar nën sektori “Prodhimi i tekstilit” me mbi 100% krahasuar me vitin paraprak edhe pse me pjesëmarrje të ulët me vetëm 0.52%. Këto produkte janë importuar nga Serbia për 48.62%, nga Maqedonia e Veriut për 46.72%, nga Shqipëria për 4.57%, etj.

Rënien më të lartë në importet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, gjatë vitit 2020, ka shënuar nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës” prej 52.40% krahasuar me vitin 2019. Produktet e koksit janë importuar nga Maqedonia e Veriut për 61.28%, nga Shqipëria për 29.08%, nga Serbia për 9.19%, etj.

2.3 Eksporti dhe Importi me vendet EFTA-së

Eksportet e Kosovës me shtetet anëtarë të EFTA-së, për vitin 2020, kanë shënuar vlerën prej 38.73 milion euro, me rritje prej 32.79%, përderisa importet kanë shënuar vlerën prej 24.83 milion euro, me rënie për 21.44% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 11. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e EFTA-së për sektorët e industrisë, 2018 - 2020

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti		2020	Bilanci		Importi			Bilanci	
		2018	2019		Ndryshimi (2020>2019)	Ndryshimi në % (2020> 2019)	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	853,603.47	769,721.14	940,383.22	170,662.08	22.17	1,169,212.70	1,174,757.97	1,269,685.90	94,927.93	8.08
11	Prodhimi i pijeve	784,657.52	936,411.26	1,165,846.05	229,434.79	24.50	458,167.26	520,749.71	334,431.68	(186,318.03)	(35.78)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-		12,390,823.39	9,304,367.00	4,924,526.54	(4,379,840.46)	(47.07)
13	Prodhimi i Tekstilit	136,364.40	81,883.57	474,158.46	392,274.89	479.06	107,916.42	119,480.66	110,129.59	(9,351.07)	(7.83)
14	Prodhimi i veshjeve	151,059.56	121,479.90	351,781.10	230,301.20	189.58	1,134,346.01	1,000,551.16	1,114,344.29	113,793.13	11.37
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	4,366.75	7,137.07	4,551.06	(2,586.01)	(36.23)	47,358.98	31,469.11	58,184.98	26,715.87	84.90
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	2,466,566.47	2,601,368.57	3,869,950.84	1,268,582.27	48.77	1,383,812.95	1,722,671.09	1,417,783.31	(304,887.78)	(17.70)
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	48,673.00	38,656.39	89,680.54	51,024.15	131.99	313,776.06	408,142.57	420,023.52	11,880.95	2.91
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-		118,457.87	-	-	-	
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	-	20.00	-	(20.00)	(100.00)	320,306.27	520,882.13	353,981.98	(166,900.15)	(32.04)

20	Prodhimi i produkteve kimike	159,263.71	164,444.14	293,053.61	128,609.47	78.21	1,315,978.86	798,371.46	912,702.40	114,330.94	14.32
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	-	-	540,300.00	540,300.00	-	1,825,867.10	2,171,639.95	1,981,112.15	(190,527.80)	(8.77)
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	5455866.8	7,498,335.98	10,592,959.00	3,094,623.02	41.27	1456336.19	1329700.29	950653.8	(379,046.49)	(28.51)
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	1,661,604.33	1,584,746.34	2,136,675.17	551,928.83	34.83	969,426.10	1,255,337.25	881,333.64	(374,003.61)	(29.79)
24	Prodhimi i Metaleve	1,491,975.55	1,434,712.54	1,320,338.20	(114,374.34)	(7.97)	628,629.81	766,561.06	822,106.27	55,545.21	7.25
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	8,058,706.60	4,971,062.92	5,705,004.31	733,941.39	14.76	1,323,173.32	1,777,431.56	906,513.45	(870,918.11)	(49.00)
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	460,068.57	603,544.66	439,115.44	(164,429.22)	(27.24)	1,787,038.94	1,718,210.78	2,421,932.54	703,721.76	40.96
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	894,220.70	1,128,991.17	1,318,182.27	189,191.10	16.76	1,356,342.99	1,061,129.13	1,017,043.46	(44,085.67)	(4.15)
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	158,635.52	378,588.70	218,351.44	(160,237.26)	(42.32)	3,981,646.59	3,250,076.84	2,614,280.30	(635,796.54)	(19.56)
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	400,038.09	276,287.72	471,186.08	194,898.36	70.54	316,355.64	238,394.11	250,053.79	11,659.68	4.89
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	20,659.88	31,353.49	53,274.14	21,920.65	69.91	295,858.30	248,216.59	406,871.36	158,654.77	63.92
31	Prodhimi i mobileve	5,645,064.53	6,337,998.92	8,596,968.62	2,258,969.70	35.64	994,990.85	1,033,619.27	836,766.14	(196,853.13)	(19.05)
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	81,410.03	207,443.92	158,198.95	(49,244.97)	(23.74)	1,067,538.09	1,160,181.67	828,910.48	(331,271.19)	(28.55)
	Gjithsej	28,932,805.48	29,174,188.40	38,739,958.50	9,565,770.10	32.79	34,763,360.69	31,611,941.36	24,833,371.57	(6,778,569.79)	(21.44)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet e EFTA-së**

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës”, në vitin 2020, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë në eksportet me vendet e EFTA-së me 27.34%. Ndërsa, në kuadër të nën sektorit ka shënuar rritje për 41.27% krahasuar me vitin 2019. Eksporti i këtyre produkteve është realizuar në Zvicër me 99.87% dhe Norvegji me 0.13%.

Në vendin e dytë me eksporte, në vendet e EFTA-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i mobilie” me pjesëmarrje prej 22.19%, në kuadër të Sektorit C, ndërsa ka shënuar rritje për 35.64% krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020, produktet e këtij nën sektori, janë eksportuar në Zvicër me 99.71%, në Islandë me 0.24%, në Norvegji me 0.5%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike”, me vendet e EFTA-së, ka pjesëmarrje për 14.73%. Por në vitin 2020, ka shënuar rritje të eksportit për 14.76% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij nën sektori kanë shënuar eksportin më të lartë në Zvicër, me 99.18%, në Norvegji me vetëm 0.77% dhe Islandë me 0.05%.

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie, prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara thurëse”, radhitet i katërti me pjesëmarrje në eksporte me këto vende për 9.99%. Në vitin 2020 eksporti ka shënuar rritje për 48.77% krahasuar me vitin paraprak. Produktet nga druri janë eksportuar në Zvicër me 98.21%, në Islandë me 1.02% dhe në Norvegji me 0.77%.

Në vitin 2020, eksporti ka shënuar rritje të lartë te nën sektori “Prodhimi i Tekstilit” për mbi 100%, krahasuar me vitin 2019, edhe pse ka pjesëmarrje të ulët në eksportet e përgjithshme me vendet e EFTA-së, prej vetëm 1.22%. Produktet e tekstilit janë eksportuar në Zvicër me 74.06% dhe Norvegji me 25.94%.

Vlerësuar nga të dhënat e analizuara, nga nën sektorët me prioritet, rënia më e lartë në eksport është shënuar te nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve nga lëkura” me 36.23% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, por me pjesëmarrje prej vetëm 0.01%. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar kryesisht në Zvicër me 100%.

Gjatë vitit 2020, sa i përket eksporteve me vendet e EFTA-së, numri më i madh i nën sektorëve ka treguar trend pozitiv.

- **Importi me vendet e EFTA-së**

Importet me vendet EFTA-së, dominohen me pjesëmarrje në importet nga nën sektori “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 19.83%. Në vitin 2020, ky nën sektorë ka shënuar rënie për 47.07%, krahasuar me vitin 2019. Produktet e duhanit janë importuar nga Zvicra me 100%.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t”, merr pjesë me 10.28% në vendet e EFTA-së. Ndërsa në vitin 2020 ka shënuar rënie për 19.56% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra 98.53%, nga Norvegjia për 1.44%, dhe Islanda 0.03%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike”, merr pjesë në importe me 7.98%, ndërsa në kuadër të nën sektorit, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 8.77% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra me 97.16% dhe Norvegjia për 8.77%.

Nga nën sektorët me prioritet, rënien më të lartë në import me vendet e EFTA-së në vitin 2020 e ka shënuar nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike” me 49% krahasuar me vitin paraprak, edhe pse në importet e këtyre vendeve merr pjesë me 3.65%.

Vlerësuar në përgjithësi importet, me vendet e EFTA-së në vitin 2020, kanë shënuar rënie në rreth 13 nën sektorë krahasuar me vitin paraprak.

2.4. Eksporti dhe Importi me vendet tjera

Eksportet me vendet tjera për vitin 2020, kanë shënuar vlerën prej 49.03 milion euro dhe krahasuar me vitin 2019 ka shënuar rritje të lehtë për 2.71%, por që paraqet më pak se 5% të vlerës së shkëmbimit tregtar me vendet tjera.

Importet me vendet tjera, për vitin 2020, kanë shënuar vlerën prej 1.08 miliard euro dhe krahasuar me vitin 2019 ka shënuar rënie për 5.69%. Shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet tjera është 95.68% e vlerës së importeve dhe 4.32% eksporte.

Tabela 12. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2018 - 2020

Kod i	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 > 2019)	Ndryshimi në % (2020 > 2019)	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 > 2019)	Ndryshimi në % (2020 > 2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1,611,165.14	3,095,757.49	3,460,546.54	364,789.05	11.78	99,146,947.48	124,142,753.55	109,877,274.50	(14,265,479.05)	(11.49)
11	Prodhimi i pijeve	792,521.40	915,117.63	1,304,206.39	389,088.76	42.52	3,826,515.68	4,487,749.40	4,115,175.57	(372,573.83)	(8.30)
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-		8,028,200.94	8,307,737.58	9,638,693.32	1,330,955.74	16.02
13	Prodhimi i Tekstilit	1,775,771.40	964,702.52	8,404,960.99	7,440,258.47	771.25	48,232,940.59	47,639,666.37	56,601,803.78	8,962,137.41	18.81
14	Prodhimi i veshjeve	235,693.03	611,746.49	2,425,676.30	1,813,929.81	296.52	94,267,415.15	109,063,354.20	90,815,489.98	(18,247,864.22)	(16.73)
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	72,411.00	2,154.52	11,137.26	8,982.74	416.93	39,352,765.45	44,377,194.57	33,693,526.77	(10,683,667.80)	(24.07)
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshtuara-thurëse	53,210.78	83,200.14	51,730.44	(31,469.70)	(37.82)	20,992,922.87	19,740,667.67	17,973,978.18	(1,766,689.49)	(8.95)
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	25,377.08	18,695.62	25,130.64	6,435.02	34.42	11,261,644.57	13,557,299.72	12,828,554.40	(728,745.32)	(5.38)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-		247,008.01	144,880.98	118,326.26	(26,554.72)	(18.33)

19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	-	-	-	-		60,759,306.91	118,980,181.99	77,375,351.99	(41,604,830.00)	(34.97)
20	Prodhimi i produkteve kimike	54,379.23	63,696.10	2,480,191.63	2,416,495.53	3,793.79	65,779,030.61	79,677,809.43	82,068,935.29	2,391,125.86	3.00
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,453,117.27	335,348.84	108,718.50	(226,630.34)	(67.58)	12,418,028.87	13,685,021.94	23,083,142.88	9,398,120.94	68.67
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	4,595,937.81	3,992,145.28	3,733,068.79	(259,076.49)	(6.49)	42,499,899.12	50,759,284.77	50,312,464.07	(446,820.70)	(0.88)
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	582,307.75	575,854.23	264,465.54	(311,388.69)	(54.07)	43,104,821.00	49,040,451.76	46,463,738.06	(2,576,713.70)	(5.25)
24	Prodhimi i Metaleve	36,021,185.19	32,687,755.37	8,145,609.37	(24,542,146.00)	(75.08)	46,048,725.16	69,639,733.00	57,350,124.03	(12,289,608.97)	(17.65)
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	355,634.31	1,797,249.86	1,171,122.07	(626,127.79)	(34.84)	41,460,413.31	49,197,416.83	53,761,361.23	4,563,944.40	9.28
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	431,122.53	496,130.70	1,324,344.18	828,213.48	166.93	81,305,816.77	77,910,771.12	80,483,118.00	2,572,346.88	3.30
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	38,664.51	73,270.09	63,031.72	(10,238.37)	(13.97)	75,977,444.99	81,073,800.98	82,246,402.42	1,172,601.44	1.45
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	1,144,997.15	1,239,008.87	1,415,249.68	176,240.81	14.22	73,058,359.15	99,376,654.00	96,660,637.95	(2,716,016.05)	(2.73)
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	365,063.46	508,987.63	857,360.65	348,373.02	68.44	18,881,884.50	23,220,491.03	32,809,087.68	9,588,596.65	41.29
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	56.00	3,500.00	90.00	(3,410.00)	(97.43)	6,975,168.07	6,108,233.28	13,332,544.49	7,224,311.21	118.27
31	Prodhimi i mobileve	51,018.25	177,191.33	13,713,568.17	13,536,376.84	7,639.41	24,867,075.09	30,339,203.07	23,346,529.42	(6,992,673.65)	(23.05)
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	21,129.20	98,239.41	72,381.64	(25,857.77)	(26.32)	29,061,576.11	30,144,471.05	30,189,644.27	45,173.22	0.15
	Gjithsej	49,680,762.49	47,739,752.12	49,032,590.50	1,292,838.38	2.71	947,553,910.40	1,150,614,828.29	1,085,145,904.54	(65,468,923.75)	(5.69)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet tjera**

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelën nr.12, vërehet se eksportet me Vendet tjera i paraprinë nën sektori “Prodhimi i mobilieve” dhe “Prodhimi i Tekstilit”, si rezultat i marrëveshjeve tregtare në mes të kompanive vendore me SHBA-të.

Nën sektori “Prodhimi i mobilieve” radhitet i pari me pjesëmarrje në eksporte me vendet e tjera me 27.97%, me rritje mbi 100% të eksporteve në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak. Produktet e mobilieve eksportohen në SHBA me 87.46%, në Kanada me 12.29%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i Tekstilit” radhitet i dyti me pjesëmarrje në eksporte me këto vende me 17.14%. Në vitin 2020 ka shënuar rritje për mbi 100% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e tekstilit janë eksportuar në SHBA për 90.72%, në Liban me 6.45%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i metaleve” me vendet tjera, në kuadër të Sektorit-C, për vitin 2020, merr pjesë në eksporte me 16.61%, ndërsa në vitin 2020 kanë shënuar rënie të theksuar për 75.08% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga ky nën sektor kryesisht janë eksportuar në Britani të Madhe për 57.15%, në Kinë me 36.46%, në Indi me 6.25%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, në vitin 2020, radhitet i katërti me 7.61% pjesëmarrje në eksporte, ndërsa në kuadër të nën sektorit ka shënuar rënie prej 6.49% krahasuar me vitin 2019. Produktet e këtij nën sektori kryesisht janë eksportuar në Turqi me 87.26%, në SHBA me 7.91%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” ka marr pjesë me 7.06% të eksportit me këto vende. Në kundër të këtij nën sektori, në vitin 2020, eksporti ka shënuar rritje për 11.78% krahasuar me vitin 2019. Produktet ushqimore janë eksportuar në Turqi me 28.90%, në SHBA me 18.33%, në Mbretërinë e Bashkuar me 11%, etj.

Nga këto të dhëna të prezantuara vërejmë se, gjatë vitit 2020, pjesëmarrjen më të ulët në eksporte me Vendet tjera e ka shënuar nën sektori “Prodhimi i Lëkurës dhe produkteve nga lëkura” për 0.02%, edhe pse krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje në eksporte me mbi 100%. Këto produkte janë eksportuar në tërësi në Kanada, me 100% eksport.

- **Importi me Vendet tjera**

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, në import merr pjesë me 10.13%, ndërsa në vitin 2020, ky nën sektor ka shënuar rënie për 11.49% krahasuar me vitin 2019. Produktet ushqimore janë importuar nga Turqia për 32.59%, nga Brazili për 28.14%, nga SHBA për 6.84%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, radhitet i dyti në importe me pjesëmarrje prej 8.37%, në kuadër të Sektorit-C, në vitin 2020. Ky nën sektor ka shënuar rënie të importeve për 16.73% krahasuar me vitin 2019. Produktet e veshjeve janë importuar nga Turqia për 52.28%, nga Kina për 21.37%, nga Bangladeshi për 11.67%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.”, radhitet i treti me pjesëmarrje në importe me 8.91%, në vitin 2020 dhe ka shënuar rënie për 2.73% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e makinerisë janë importuar nga Kina për 45.43%, nga Turqia për 35.88%, etj.

Nën sektori me pjesëmarrjen më të ulët në importe është “ Prodhimi i pijeve”, me 0.38% dhe me rënie prej 8.30% në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak. Produktet e pijeve janë importuar nga Turqia për 45.5%, nga Koreja për 15.37%, nga Mbretëria e Bashkuar për 12.92%, etj.

1. PËRPUNIMI I PRODUKTEVE USHQIMORE

Me Industrinë e përpunimit të ushqimit, kuptohet ndryshimi i produkteve bujqësore dhe i atyre blegtorale në produkte për konsum të ndërmjetëm apo përfundimtar.

Kosova ka potencial të madh për zhvillimin e këtij sektori duke u bazua me një relief të pasur, me toka të bollshme pjellore për kultivimin e produkteve bujqësore. Për këtë arsye, investitorët kanë mundësi të madhe për të investuar në industrinë e përpunimit të ushqimit.

Sektori i ushqimit, edhe pse ka import të lartë të produkteve ushqimore sidomos atyre blegtorale, ka shënuar progres të konsiderueshëm në zhvillim dhe është duke e zgjeruar shtrirjen e vet në tregun vendor si dhe është duke depërtuar në tregun e BE-së. Ky nën sektor ballafaqohet me sfida krahas kërkesave nga vendet e BE-së rreth dokumentacioneve, certifikimeve si dhe kërkesave për ushqime specifike. Prodhuesit në Kosovë, gjithashtu përjetojnë vështirësi në eksport me vendet e CEFTA-s rreth politikave tregtare që aplikohen nga ato vende.

Eksportet në nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore” gjatë vitit 2020, në Sektorin-C, marrin pjesë me 8.83% por që krahasuar me vitin paraprak, ka shënuar rritje për 17.51%, ndërsa dominohen nga importet me 15.24%.

Sipas USAID, përpunimi i ushqimit është sektori i pa shfrytëzuar mirë dhe ka potencial të konsiderueshëm rritjeje⁵.

1.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e përpunimit të produkteve ushqimore

Në vitin 2020 nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, ka 8081 të punësuar në 1369 ndërmarrje dhe qarkullim në vlerë prej 320.08 milion euro.

Në vitin 2020, ky nën sektor ka shënuar rritje në punësim për 20%, në numër të ndërmarrjeve për 18% dhe në qarkullim për 17%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (10) në totalin e Sektorit C merr pjesë:

- 20% të ndërmarrjeve,
- 23% të punësuarve dhe
- 19% në qarkullim.

⁵ Market system and constraints analysis 2020

Tabela 13. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nënë sektorin e Prodhimi i produkteve ushqimore

Kodi	Nën sektori (10): Përpunimi i produkteve ushqimore	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1011	Përpunimi dhe konservimi i mishit	92	87	94	635	698	773	36,485,449.17	44,034,025.68	39,533,108.08
1012	Përpunimi dhe konservimi i mishit të shpezëve	1	1	1	12	10	8	300,368.13	249,682.46	189,417.97
1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve	11	9	13	24	22	37	1,040,271.12	981,920.07	1,766,197.40
1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve	3	2	2	5	6	8	85,704.27	250,197.32	203,762.48
1031	Përpunimi dhe konservimi i patates	2	1	2	210	200	199	8,989,961.43	10,502,825.02	11,311,075.83
1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve	10	11	14	78	78	96	6,371,870.84	6,132,471.76	7,089,545.04
1039	Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve	34	24	37	504	563	632	23,496,392.74	25,074,460.78	25,140,529.96
1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave	2	2	5	7	1	8	338,753.29	132,931.39	922,157.41
1051	Prodhimi i produkteve të qumështit	54	43	51	477	685	1211	43,867,173.32	66,645,799.03	100,541,103.89
1052	Prodhimi i akullores	25	20	23	99	107	146	1,096,770.24	1,431,025.68	3,378,921.62
1061	Përpunimi i produkteve të drithërave	45	42	50	427	449	482	39,655,498.02	40,723,928.29	39,135,938.85
1062	Përpunimi i niseshtes dhe i produkteve të niseshtes	1	1	1	4	6	7	550,927.68	601,120.80	537,544.56
1071	Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta	818	782	888	2805	2915	3444	35,091,709.69	44,941,773.73	44,423,645.31
1072	Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar	36	35	42	208	230	263	5,020,981.04	5,706,820.66	6,833,295.52
1073	Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli	16	14	17	79	139	46	2,291,434.97	3,950,312.17	803,818.25
1081	Prodhimi i sheqerit	4	3	6	1	9	21	17,943.40	198,385.50	350,870.24
1082	Prodhimi i kakaos, çokolatës dhe ëmbëlsirave	17	13	20	246	273	288	6,267,204.25	7,538,939.89	19,736,506.89
1083	Përpunimi i çajit dhe kafes	27	21	31	39	34	46	722,564.79	740,769.32	1,529,302.48
1084	Përpunimi i erëzave dhe salcave	5	5	7	40	43	56	1,360,103.41	1,605,183.77	1,851,105.39
1085	Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme	9	15	23	43	38	57	280,702.68	296,650.63	387,667.28
1086	Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike	-	-	1	-	-	2	-	-	785,717.09
1089	Përpunimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t	28	26	35	190	196	215	8,245,776.14	9,222,312.35	8,445,829.42
1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës	4	3	6	20	24	36	2,053,282.58	2,026,749.49	5,183,592.26
Gjithsej		1244	1160	1369	6153	6725	8081	223,630,843.20	272,988, 285.79	320,080,653.22

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 13, në këtë nën sektor, në vitin 2020, nën aktiviteti “Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta” prin për nga numri i punëtoreve me 43%, numri i ndërmarrjeve me 65% dhe me qarkullim 63%. Ndërsa në kuadër të këtij nën sektorit radhitet në vendin e dytë në qarkullim, me rritje për 14%. Në këtë nën aktivitet, nëse i krahasojmë të dhënat me vitin e kaluar vërejmë se, në vitin 2020, të tre indikatorët kanë shënuar rënie.

Nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të qumështit” ka 15% të punësuar në 51 ndërmarrje, ndërsa në qarkullim prin me pjesëmarrje për 31%. Vlen të theksohet se në këtë nën aktivitet, në vitin 2020 të tre indikatorët kanë shënuar rritje, por rritja më e theksuar vërehet në punësim për 77% dhe në qarkullim për 53%, në krahasim me vitin 2019.

Nën aktiviteti “Përpunimi dhe konservimi i mishit”, radhitet e treta me punësim me 9% në 94 ndërmarrje, ndërsa në qarkullim merr pjese me 12%.

Nën aktiviteti “Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve” edhe pse ka numër të ndërmarrjeve më të vogël, 37 sosh, në kuadër të nën sektorit, në punësim radhitet e katërta me pjesëmarrje për 8%, ndërsa në qarkullim zë vendin e pestë me 8%.

Vlen të theksohet se nën aktiviteti “Përpunimi i produkteve të drithërave” edhe pse ka numër më të vogël në punësim, në qarkullim qëndron mirë me pjesëmarrje prej 13%, në kuadër të nën sektorit.

Sa i përket shtrirjes regjionale, nën aktiviteti “Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta”, prinë regjioni i Prishtinës me 27% të numrit të ndërmarrjeve pasuar nga regjioni i Prizrenit me 25% dhe Gjakova me 12% etj. Regjioni i Prishtinës prin edhe në punësim me 33%, Prizreni me 16%, Peja me 12% etj. Nën aktivitetin “Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta” në qarkullim e prin regjioni i Prishtinës me 28%, pastaj regjioni i Pejës dhe ai i Gjilanit me nga 19%, etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të qumështit” për nga numri i ndërmarrjeve prinë në regjionin e Prizrenit me 31%, Prishtinës 27%, pastaj Ferizaj, Peja dhe Gjakova me nga 12%, etj. Po ashtu regjioni i Prizrenit prinë edhe në punësim me 46%, Prishtina me 20%, Peja 17% etj. Te ky nën aktivitet edhe në qarkullim prin regjioni i Prizrenit me 40%, pasuar nga regjioni i Prishtinës 32.4% etj.

Nën aktiviteti “Përpunimi dhe konservimi i mishit”, 24.5% e ndërmarrjeve është në regjionin e Prishtinës, Prizreni dhe Gjakova me nga 20% etj. Gjithashtu edhe në punësim prin regjioni i Prishtinës me 33.5%, regjioni i Prizrenit 23%, Gjakova 21%, etj. Te ky nën aktivitet, regjioni i Prishtinës prin edhe në qarkullim me 44% pasuar nga regjioni i Prizrenit me 19%, Gjakova 15%, etj.

2.1 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të ushqimit

Eksporti në nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore”, në vitin 2019, ka pasur rënie për 7% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2020 ka shënuar rritje për 4%, krahasuar me vitin 2019.

Importi në këtë nën sektor, në vitin 2019, ka shënuar rritje për 7%, krahasuar me vitin paraprak. Ky nën sektor edhe në vitin 2020 ka shënuar rritje për 1.61%.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 9.34% në totalin e eksporteve dhe 27.63% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 7% eksport dhe 93% import. Bilanci tregtar, të ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve ushqimore” ka 1.31% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 1369 ndërmarrje, 5.41% janë eksportuese.

Tabela 14. Eksporti dhe importi në nënë-sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore

Kodi	Nën sektori Përpunimi i produkteve ushqimore	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	34,588,451.58	32,153,033.08	33,402,372.88	1,249,339.80	4	430,684,698.03	459,196,871.23	466,609,046.82	7,412,175.59	1.61
10.1	Përpunimi dhe Konservimi (Ruajtja) i Mishit dhe Produkteve me Bazë Mishi	10,857,386.95	7,015,035.39	6,155,790.22	(859,245.17)	(12.25)	88,039,126.53	100,664,165.57	88,696,683.37	(11,967,482.20)	(11.89)
10.2	Përpunimi dhe Konservimi i Peshkut, Krustaceve dhe Molusqeve	20,707.20	18,008.44	6,533.61	(11,474.83)	(63.72)	7,071,211.19	7,788,336.36	8,443,091.48	654,755.12	8.41
10.3	Përpunimi dhe Konservimi i Frutave dhe Perimeve	10,727,839.07	9,097,401.41	13,905,362.71	4,807,961.30	53	29,712,131.52	31,803,636.41	31,094,537.63	(709,098.78)	(2.23)
10.4	Përpunimi i Vajrave dhe Yndyrnave Bimore dhe Shtazore	333,436.04	1,537,263.21	1,437,901.14	(99,362.07)	(6.46)	32,641,745.77	34,702,933.10	36,932,348.16	2,229,415.06	6.42
10.5	Prodhimi i Produkteve të Qumështit	710,848.53	757,746.19	854,518.78	96,772.59	13	55,527,177.90	58,437,998.13	57,903,482.99	(534,515.14)	(0.91)
10.6	Përpunimi i Produkteve të Drithërave, Nisështes dhe Produkteve të Nisështes	3,962,013.88	1,864,440.86	2,116,550.33	252,109.47	13.52	17,308,832.43	17,788,465.83	22,539,856.13	4,751,390.30	26.71
10.7	Prodhimi i Produkteve të Bukës, Ëmbëlsirave, Makaronave	1,222,228.52	4,974,874.69	1,107,662.38	(3,867,212.31)	(7.73)	49,374,185.69	49,251,004.78	50,990,892.92	1,739,888.14	3.53
10.8	Prodhimi i Produkteve të Tjera Ushqimore	6,753,991.39	6,888,262.89	7,491,231.17	602,968.28	8.75	138,713,923.97	149,418,912.93	156,592,215.94	7,173,303.01	4.80
10.9	Përpunimi i Ushqimeve të Përgatitura për Kafshë	-	-	326,822.54	326,822.54	-	12,296,363.03	9,341,418.12	13,415,938.20	4,074,520.08	43.62

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/ DI

• **Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e eksporteve të nën sektorit “Përpunimi i produkteve ushqimore” është 33.402 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 40%, me vendet e CEFTA-së 47%, me vendet e EFTA-së 3% dhe vendet tjera 10%.

Bazuar në tabelën nr.14, në vitin 2020 ky nën sektor, ka shënuar rritje për 3.89%, krahasuar me vitin 2019. Nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore”, ka arritur të eksportojë në vendet e BE-së, në vlerë prej 13.178 milion euro. Produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Gjermani me 36% dhe në Itali me 20%.

Sa i përket eksportit me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Përpunimi i produkteve ushqimore”, më së tepërmi janë eksportuar në Shqipëri me 35%, në Serbi me 29% dhe Maqedoni me 22%. Me vendet e EFTA-së ky nën sektor ka eksportuar vetëm në Zvicër, me vlerë prej 940 mijë euro, apo për 100%, gjë që e bënë shtetin më të synuar për treg.

Ndërsa eksporti me vendet tjera ka shënuar vlerën 3 milion euro dhe produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Turqi me 32%, SHBA me 20%, Irak 9% etj.

Në kuadër të nën sektorit, aktiviteti “Përpunimi dhe Konservimi i Frutave dhe Perimeve” prin në eksport me 42%, pasuar nga aktiviteti “Prodhimi i Produkteve të Tjera Ushqimore” me 22.43% etj.

• **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Importi i përgjithshëm, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve ushqimore” është 466 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 57.4%, nga vendet e CEFTA-së 20%, nga vendet e EFTA-së 0.27% dhe nga vendet tjera 22%.


Importet, në nën sektorin “Përpunimi i produkteve ushqimore”, dominohen nga vendet e BE-së, me vlerë prej 267 milion euro. Importi i këtyre produkteve më së tepërmi është realizuar nga Gjermania me 16%, nga Polonia me 12%, Sllovenia 11%, Kroacia 10% etj.

Sa i përket importeve me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Përpunimi i produkteve ushqimore”, më së tepërmi janë importuar nga Maqedonia me 45% dhe Serbia me 35%. Importi me vendet e EFTA-së, 90% e produkteve janë importuar nga Zvicra.

Importi me Vendet tjera ka shënuar vlerën prej 103 milion euro dhe produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë importuar nga Turqia me 34.4%, nga Brazili me 30% etj.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i produkteve ushqimore”, ndër aktivitetet më me ndikim në rritjen e importeve, në vitin 2020, është “Prodhimi i Produkteve të Tjera Ushqimore” me 34%, pastaj aktiviteti “Përpunimi dhe Konservimi (Ruajtja) i Mishit dhe Produkteve me Bazë Mishi” me 19%, “Prodhimi i Produkteve të Qumështit” me 12%, krahasuar me vitin 2019.

Figura 3. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin prodhimi i produkteve ushqimore



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat për shkëmbimin tregtar për aktivitetet “Përpunimi dhe konservimi i frutave”, për vitin 2020, tregojnë se eksporti ka shënuar rritje për 8.7%, derisa importi ka shënuar rënie për normën e njëjtë si dhe aktiviteti “Përpunimi i ushqimit të përgatitura për kafshë” ka shënuar rritje në eksport për 2.4% në raport me importin, krahasuar me vitin paraprak.

2. PRODHIMI I PIJEVE

Prodhimi i pijeve në Kosovë si sektor ka historinë e tij në prodhimin e pijeve bio nga ato jo-alkoolike dhe alkoolike. Duke marr parasysh involvimin e zingjirit prodhues, duke filluar nga kultivuesit e pemëve dhe perimeve e deri te prodhuesi i fundit i pijeve, ky sektor ka potencial të madh për zhvillimin ekonomik të vendit. E gjitha kjo duke u bazuar në burimet e ujit të pijshëm në Kosovë, ku buron uji i thjesht dhe i gazuar si dhe tokat pjellore për mbjelljen dhe fermentimin e pijeve të tjera.

Prodhuesit e pijeve në Kosovë, në bashkëpunim me kultivuesit e pemëve dhe perimeve kanë rritur cilësinë e prodhimit të tyre me 100% bio. Si rezultat i kësaj prodhuesit në vend kanë arritur që prodhimet e tyre t'i eksportojnë në shumë vende të botës duke filluar nga vendet e rajonit, vendet anëtare të BE-së, në SHBA e deri në Shtetet Arabe.

Kosova ka një traditë shumë vjeçare në vreshtari dhe njihet me zonat për kultivimin e rrushit dhe fermentimin në pije alkoolike. Vendet ku kultivohet dhe fermentohet më së shumti rrushi janë Rahoveci dhe Suhareka me sipërfaqe rreth 3,000 ha. Vreshtaria konsiderohet si sektor mjaft i rëndësishëm për investime dhe me shumë potencial për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

2.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të pijeve

Në vitin 2020, nën sektori “Prodhimi i produkteve të pijeve”, ka 2138 të punësuar në 81 ndërmarrje dhe me qarkullim në vlerë prej 106.22 milion euro.

Punësimi te ky nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rritje për 17% si dhe në numër të ndërmarrjeve për 9%, ndërsa në qarkullim ka shënuar rënie për 10%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (11) në totalin e sektorit C merr pjesë:

- 1.15% të ndërmarrjeve,
- 6.16% të punësuarve dhe
- 6.21% në qarkullim

Tabela 15. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nënë sektorin e Prodhimi i Pijeve.

Kodi	Nën sektori (11): Prodhimi i produkteve të Pijeve	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1101	Distilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve	16	17	19	29	39	69	1,525,277.23	1,068,316.26	2,097,740.41
1102	Prodhimi i verës nga rrushi	14	13	15	492	491	645	6,362,990.88	6,543,313.83	5,328,657.06
1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara	3	1	2	37	2	2	2,958,671.90	10,255.07	15,951.81
1105	Prodhimi i birrës	9	7	8	330	315	327	33,594,644.02	35,678,929.10	25,377,382.78
1107	Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe	47	36	37	934	977	1095	63,006,966.93	74,808,536.71	73,406,545.55
Gjithsej		89	74	81	1822	1823	2138	107,448,550.96	118,109,350.97	106,226,277.61

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 15, në vitin 2020, nën aktiviteti “Prodhimi i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe” dominon në të tre indikatorët: në punësim me 51%, në numër të ndërmarrjeve me 46% dhe në qarkullim për 69%. Ky nën aktivitet edhe pse kishte rritje në punësim dhe me numër të ndërmarrjeve, në qarkullim kishte rënie për 3%, në krahasim me vitin 2019.

Nën aktiviteti “Prodhimi i verës nga rrushi”, ka 30% të punësuar në 15 ndërmarrje dhe me qarkullim renditet e treta me 5%. Ky nën aktivitet, në vitin 2020 ka rënie në qarkullim për 18.5%, ndërsa ka shënuar rritje në punësim për 31% dhe në numër të ndërmarrjeve për 15%, në krahasim me vitin paraprak.

Nën aktiviteti “Prodhimi i birrës”, edhe pse ka numër më të vogël në punësim dhe në numër të ndërmarrjeve në qarkullim, radhitet në vendin e dytë me pjesëmarrje prej 24%. Në këtë nën aktivitet qarkullimi ka shënuar rënie për 29%, në krahasim me vitin 2019.

Vlen të theksohet se, nën aktivitetit “Distilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve” në vitin 2020 ka shënuar rritje në qarkullim për 96%, krahasuar me vitin 2019.

Në nivel regjional, nën aktiviteti “Prodhimi i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe” prin në regjionin e Gjilanit me 40% të punësuar në 11 ndërmarrje dhe në qarkullim me 37%, pasuar nga regjioni i Prizreni me 26% të punësuar në 7 ndërmarrje dhe me qarkullim 43% etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i verës nga rrushi” numrin më të madh të punësuarve e ka në regjionin e Gjakovës me 61% , me numër të ndërmarrjeve 87% dhe me qarkullim 94%.

2.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të pijeve

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i produkteve të pijeve”, në vitin 2020, ka shënuar rritje për 3.5% krahasuar me vitin paraprak, po ashtu edhe në vitin 2019 ka shënuar rritje për 4%, krahasuar me vitin 2018.

Importi në këtë nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 6% krahasuar me vitin paraprak. Ky nën sektor në vitin 2019 kishte rritje për 5%, krahasuar me vitin 2018.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 8.30% në totalin e eksporteve dhe 4.59% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 28%, eksport dhe 72%, import. Bilanci tregtar, të ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 2%, krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve të pijeve” ka 0.53% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 81 ndërmarrje, 97.04% janë eksportuese.

Tabela 16. Eksporti dhe importi në nënë-sektorin e prodhimit të pijeve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i Pijeve	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019- 2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019- 2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
11	Prodhimi i Pijeve	27,565,225.96	28,665,800.23	29,666,793.39	1,000,993.16	3.49	78,580,037.59	82,588,664.30	77,586,544.73	(5,002,119.57)	(6.06)
11.0	Prodhimi i Pijeve	27,565,225.96	28,665,800.23	29,666,793.39	1,000,993.16	3.49	78,580,037.59	82,588,664.30	77,586,544.73	(5,002,119.57)	(6.06)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të nën sektori “Prodhimi i pijeve” është 29.66 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 23%, me vendet e CEFTA-së, 70% me vendet e EFTA-së 4% dhe vendet tjera 3%.

Bazuar në tabelën nr. 16, në vitin 2020 ky nën sektor, ka shënuar rritje për 3.49% krahasuar me vitin 2019. Nën sektori “Prodhimi i pijeve”, ka arritur të eksportoj në vendet e BE-së në vlerë prej 6.77 milion euro. Produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Bullgari me 25.61% dhe në Kroaci me 25%.

Sa i përket eksportit me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhimi i pijeve”, më së tepërmi janë eksportuar në Shqipëri me 67% dhe Maqedoni me 22%. Eksporti me vendet e EFTA-së të ky nën sektorë ka eksportuar vetëm në Zvicër, me vlerë prej 1.16 milion euro, apo për 100%, gjë që e bënë shtetin me të synuar për treg. Ndërsa eksporti me vendet tjera ka shënuar vlerën 991 mijë euro dhe produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Turqi me 32% dhe SHBA 26%.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera


Importi i përgjithshëm, në nën sektorin “Prodhimi i pijeve” është 77.58 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 53%, nga vendet e CEFTA-së 42%, nga vendet e EFTA-së 0.43% dhe nga vendet tjera 4.62%.

Importet, në nën sektorin “Prodhimi i pijeve”, dominohen nga vendet e BE-së, me vlerë prej 41.12 milion euro. Importi i këtyre produkteve më së tepërmi është realizuar nga Bullgaria me 28%, nga Austria me 22%, Sllovenia 14%, Kroacia 9% etj.

Sa i përket importeve me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhimit i pijeve”, më së tepërmi janë importuar nga Serbia me 43% dhe Maqedonia me 35%. Importi i produkteve Prodhimi i pijeve me vendet e EFTA-së, është realizuar nga Zvicra me 95%.

Importi me vendet tjera ka shënuar vlerën prej 3.58 milion euro. Produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë importuar nga Turqia me 52% dhe nga Koreja me 18%.

Figura 4. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin prodhimi të pijeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat për shkëmbimin tregtar për aktivitetet “Prodhimi i Pijeve”, për vitin 2020, tregojnë se eksporti ka shënuar rritje për 1.89%, derisa importi ka shënuar rënie për normën e njëjtë.

3. PRODHIMI I TEKSTILIT

Industria e tekstilit është ngritur me kombinimin e duhur të traditës, kreativitetit dhe përvojës, ku shumë ndërmarrje private të reja kanë dalë nga familjet me traditë në përpunimin e lëkurave, gëzofëve, mbathjeve,thurjes, endjes dhe qepjes, dizajnerë të sofistikuar të rinj, tregtarë dhe investime të huaja.

Në Kosovë në vitin 2020 janë 173 ndërmarrje private të angazhuara në prodhimin e tekstilit, ku 90% prej tyre janë prodhues të produkteve përfundimtare. Në këtë nën sektor ka hapësirë të konsiderueshme për investitorë, për prodhimin e veshjeve përfundimtare nga peri dhe pëlhura.

Ndërmarrjet prodhuese të kësaj Industrie në Kosovë, janë të përqendruara kryesisht në rajonet: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Gjakovë.

Prodhimet e tekstilit në Kosovë, janë eksportuar në vendet e Evropës Lindore dhe Perëndimore si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të tekstilit

Në vitin 2020 në nën sektorin e tekstilit janë evidentuar 173 ndërmarrje, me 802 të punësuar dhe me vlerë qarkullimi prej 16.06 milion euro.

Sipas tabelës nr.17, ky nën sektorë ka shënuar rritje në punësim për 28%, me numër të ndërmarrjeve për 56%, dhe në qarkullim për 4.43%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (13) në totalin e sektorit C merr pjesë:

- 3.1 % të ndërmarrjeve,
- 2.3% të punësuarve dhe
- 1.2% në qarkullim.

Tabela 17. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e tekstilit

Kodi	Nën sektori (13): Prodhimi i tekstilit	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1310	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	10	9	14	13	14	17	41,747.06	56,682.82	48,369.60
1320	Endja e tekstilit	11	9	11	77	70	76	2,237,604.04	2,927,144.22	2,273,755.62
1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit	32	29	44	358	172	254	5,755,599.36	6,046,688.34	6,893,915.44
1391	Prodhi i pëlhurave të thurura dhe të endura	6	4	4	13	6	5	37,386.77	46,730.27	25,672.38
1392	Prodhi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve	10	8	10	53	57	55	1,821,818.51	1,752,403.58	1,436,549.07
1393	Prodhi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve	3	3	3	70	27	59	810,232.14	476,332.29	1,068,044.26
1394	Prodhi i litarëve, spangove dhe rrjetave	-	-	1	-	-	1	-	-	745.00
1395	Prodhi i pëlhurave të pa endura dhe artikujve të pa endur, përveç veshjeve	1	1	1	4	3	4	-	2,400.00	900.00
1396	Prodhi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale	4	4	6	24	25	27	699,221.89	832,652.48	1,004,119.08
1399	Prodhi i tekstileve të tjera p.k.t	50	44	79	205	255	304	3,284,376.11	3,241,929.26	3,312,334.39
Gjithsej		127	111	173	817	629	802	14,687,985.88	15,382,963.26	16,064,404.84

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Nën aktivitetit “Prodhi i tekstileve të tjera p.k.t”, në vitin 2020, ka numrin më të madh të ndërmarrjeve në kuadër të nën sektorit, me 79 ndërmarrje, 36% të punësuar dhe me qarkullim 19%.

Nën aktiviteti “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit” në qarkullim radhitet e para me 44%, si dhe rritje ka shënuar prej 32% në punësim dhe 52% në numër të ndërmarrjeve.

Ndërsa nën aktiviteti “Endja e Tekstilit” në krahasim me dy nën aktivitetet e lartë përmendura ka numër shumë më të vogël në punësim dhe në numër të ndërmarrjeve, por në qarkullim

qëndron mirë me pjesëmarrje 16% edhe pse në vitin 2020 ka shënuara rënie për 22% krahasuar me vitin paraprak.

Sa i përket nivelit regjional, nën aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t”, numrin më të madh të ndërmarrjeve e ka të shpërndarë në regjionin e Ferizajt me 28%, regjioni i Prishtinës me 26.5% të ndërmarrjeve, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 14% të ndërmarrjeve etj. Ndërsa në punësim prin regjioni i Prishtinës me 58.5%, Ferizaj 14% etj.

Te nën aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t”, qarkullimin më të madh e ka në regjionin e Prishtinës me 52.5% dhe Ferizaj 25%.

Nën aktiviteti “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit”, i cili radhitet i dyti në këtë nën sektor, numrin më të madh të ndërmarrjeve e ka në regjionin e Prishtinës me 50%, pastaj regjioni i Gjakovës me 16% etj. Sa i përket punësimit, ky nën aktivitet, ka 37% të punësuar në regjionin e Prishtinës, 22.3% të punësuar në regjionin e Gjilanit dhe regjioni i Gjakovës me 19% të punësuar.

Nën aktiviteti “Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit”, në qarkullim prin regjioni i Gjilanit me 44.5%, i Prizrenit me 24% dhe i Prishtinës me 22.5%.

Sipas tabelës nr.17, nën aktiviteti “Endja e Tekstilit”, në aspektin regjional, qarkullimi më i madh është në regjionin e Mitrovicës me 98%.

3.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të tekstilit

Eksporti në nën sektorin e “Prodhimit të tekstilit”, në vitin 2020, ka shënuar rritje mbi 100%, krahasuar me vitin 2019, rritje kishte edhe në vitin 2019 për 28.34%, krahasuar me vitin 2018.

Importi te ky nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rritje për 17%, përderisa në vitin 2019 kishte rënie për 3.18% krahasuar me vitin 2018.

Raporti mes eksportit dhe importit te ky nën sektor është 21.21% eksport dhe 78.79% import. Bilanci tregtarë, te ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 9.3%, krahasuar me vitin 2019.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 5% në totalin e eksporteve dhe 4% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i tekstilit” ka 0.27% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 173 ndërmarrje, 8.67% janë eksportuese.

Tabela 18. Eksporti dhe importi në nën sektorin prodhimi i tekstilit

Kodi	Nën sektori Prodhimi i tekstilit	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
13	Prodhimi i Tekstilit	6,136,824.19	7,875,908.03	17,948,552.72	10 072 644,14	127,89	58,660,751.55	56,796,552.95	66,662,771.63	9,866,218.68	17.37
13.1	Përgatitja dhethurja e fijeve të tekstilit	509,170.62	137,430.84	674.710	537,278.88	390.94	1,123,102.91	1,222,642.44	1,395,265.48	172,623.04	14.12
13.2	Endja e tekstilit	511,127.80	1,416,543.36	1,845,939.00	429,396.08	30.31	15,814,106.35	16,208,427.98	15,258,306.34	(950,121.64)	(5.86)
13.9	Prodhimi i tekstileve të tjera (me aktivitetet: 9.1,9.2,9.3,9.4,9.5,9.6,9.9)	5,116,525.77	6,321,933.83	15,427,903.00	9,105,969.18	144.04	41,723,542.29	39,365,482.53	50,009,199.81	10,643,717.28	27.04

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI


• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të kësaj nën sektori është 17.94 milion euro, ndërsa eksporti me vendet e BE-së është 21.4%, me vendet e CEFTA-së 29%, EFTA-së 2.64% dhe vendet tjera 47%. Nën sektori “Prodhimi i tekstilit” ka eksportuar në vendet e BE-së, në vlerë prej 3.580 milion euro, ndërsa vendi në të cilin ka eksportuar më së tepërmi është Gjermania me 55.5%. Eksporti në vendet e CEFTA-së, është 3.04 milion euro, ndërsa më së tepërmi është eksportuar në Shqipëri me 36.5% dhe në Maqedoni me 30%. Aktiviteti “Prodhimi i tekstileve të tjera” në vitin 2020, ka shënuar eksport më të lartë mbi 100%, krahasuar me vitin 2019.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Importi në nën sektorin “Prodhimi i tekstilit” në vitin 2020 ka vlerën 66 milion euro. Ky nën sektor në vitin 2020 ka shënuar rritje për 17.37%, krahasuar me vitin 2019. Importi me vendet e BE-së është 11%, me vendet e CEFTA-së 4.23%, EFTA-së 0.16% dhe me vendet tjera 84.5%. Ky nën sektor importin më të lartë e ka shënuar nga vendet tjera në vlerë prej 56 milion euro, ndërsa vendet nga të cilat është importuar më së tepërmi janë Turqia 54% dhe Kina me 41%. Produktet e aktiviteteve që më së tepërmi importohen janë “Prodhimi i tekstileve të tjera” me 75%.

Figura 5. Sektori C – Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e prodhimit të tekstilit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Shkëmbimi tregtar, sipas Figurës nr. 5, tregon se aktiviteti “Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit” në vitin 2020 ka shënuar trend pozitiv në eksport, rreth 22.5% në raport me importin.

4. PRODHIMI I VESHJEVE

Industria e veshjeve në Kosovë ishte industria e dytë më e madhe në Kosovë, pas minierave. Veshja është një nga industritë më të vjetra, më të mëdha dhe më e globalizuar. Në të kaluarën, produktet nga prodhuesit kosovarë kanë synuar edhe tregjet tjera në gjithë Evropën Perëndimore dhe Lindore si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Industria e veshjeve për nga potenciali, ashtu edhe nga tërësia e produkteve, është një degë e rëndësishme në familjen e gjerë të degëve të industrisë. Degët e industrisë së tekstilit dhe veshjeve janë relativisht të shtrira në tërë Kosovën.

Ndërmarrjet apo prodhuesit e Kosovës për veshmbathje dhe lëkurë mund të zbërthehen në tri kategori:

a) Prej, Bëj dhe Shkurtoj (PBSh): njihet edhe si “prej e qep”, lohn dhe fason. Kjo është mundësi e madhe në përgjithësi për prodhuesit e veshmbathjeve në rajonin e Evropës Jug Lindore.

b) Shitësit vendas me pakicë të veshmbathjeve: shumë kompani të vogla shesin prodhimet standarde të veshmbathjeve dhe uniformave për tregjet tejet të fragmentuara vendore dhe të vendeve fqinje.

c) Moda: Ka disa dizajnerë të kualifikuar të veshmbathjeve të grave në Kosovë që shesin përmes atelieve të tyre, në dyqanet nëpër qytetet kryesore.⁶

Përveç të qenit intensiv në punë, fuqia punëtore e veshmbathjeve është e dominuar nga femra, dhe shumë prej firmave në këtë nën sektor janë nën pronësi ose drejtim të grave.

Përderisa Prishtina është qendër e institucioneve akademike dhe tregtare me prodhues dhe eksportues kryesor, rajoni i Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit janë të specializuar në prodhimin e xhinseve, bluzave dhe uniformave, pastaj Gjilani është i specializuar në veshjet e dasmës që kërkojnë më tepër punë dore, Podujeva në prodhimin e veshjeve sportive dhe uniformave si dhe Suhareka është qendër e prodhimit të këpucëve.

Sa i përket shitjeve, numri më i madh i produkteve shiten në tregun e brendshëm por një pjesë e tyre eksportohen kryesisht në vendet e rajonit si: Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni, Bosnje etj.

⁶ <http://kosovowood.org/LinkClick.aspx?fileticket=y0NkNbvG-LI%3D&tabid=184&portalid=1&mid=761&language=sq-AL>

4.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e veshjeve

Nën sektori i “Prodhimit të veshjeve” sipas Tabelës nr.19, në vitin 2020, ka 1151 të punësuar, 325 ndërmarrje dhe qarkullim në vlerë 9.95 milion euro.

Në vitin 2020, te ky nën sektor, ka rritje në tre indikatorët: në punësim për 34.4%, në numër të ndërmarrjeve për 55% dhe në qarkullim për 17%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (14) në totalin e sektorit C merr pjesë:

- 5.8 % të ndërmarrjeve,
- 3.31% të punësuarve dhe
- 0.71% në qarkullim.

Tabela 19. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e veshjeve

Kodi	Nën sektori (14): Prodhimi i veshjeve	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1411	Prodhimi i veshjeve të lëkurës	3	4	6	55	2	5	163,510.37	45,649.68	43,379.40
1412	Prodhimi i veshjeve të punës	32	28	40	158	204	336	1,245,523.05	2,254,721.10	2,740,757.66
1413	Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme	126	117	189	494	503	611	4,265,857.81	4,388,924.98	4,852,617.33
1414	Prodhimi i veshjeve të brendshme	1	1	4	3	3	11	63,959.37	58,660.51	239,725.57
1419	Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)	31	27	44	109	112	143	1,191,889.37	1,298,806.18	1,635,999.21
1420	Prodhimi i artikujve nga gëzofi		2	1		2	2		21,787.00	10,969.42
1431	Prodhimi i çorapeve të thurura	5	4	6	12	11	13	210,419.63	251,713.33	221,612.30
1439	Prodhimi i rrobave të tjera të thurura ose të punuara me grep	28	28	35	26	19	30	167,801.45	194,693.41	213,615.94
Gjithsej		226	210	325	857	856	1151	7,308,961.05	8,514,956.19	9,958,676.83

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Nën aktiviteti, “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, në krahasim me nën aktivitetet tjera është lider për nga numri i ndërmarrjeve, në punësim si dhe në qarkullim. Ky nën aktivitet në totalin e ndërmarrjeve të nën sektorit merr pjesë me 58%, në punësim me 53% dhe në qarkullim 49%. Në vendin e dytë radhitet nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të punës” ku në totalin e ndërmarrjeve të nën sektorit merr pjesë me 12%, në punësim 29% dhe në qarkullim 27.5%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj)” renditet e treta me 12.4% të punësuar në 44 ndërmarrje dhe me qarkullim 16.4%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të brendshme” është befasuese në këtë vit, për vet faktin se në tre indikatorët ka shënuar rritje të konsiderueshme, në punësim, me numër të ndërmarrjeve dhe në qarkullim me rritje mbi 100%. Ky aktivitet në totalin e nën sektorit, në punësim merr pjesë me 1%, në numër të ndërmarrjeve me 1.2%, ndërsa në qarkullim merr pjesë me 2.41%.

Sa i përket nivelit regjional, nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, numrin më të madh të ndërmarrjeve e ka të shpërndarë në regjionin e Prishtinës me 27%, pasuar nga regjioni i Gjakovës me 20% dhe regjioni i Prizrenit me 16%. Ky nën aktivitet është lider edhe për nga punësimi, ku numrin më të madh të punësuarve e ka në regjionin e Prishtinës me 50% të punësuar dhe në regjionin e Gjakovës me 27.5% të punësuar.

Sa i përket vlerës së qarkullimit nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme”, qarkullimin më të lartë e ka në regjionin e Prishtinës me 61% dhe regjioni i Gjakovës me 22%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të punës” numrin më të madh të ndërmarrjeve e ka në regjionin e Gjakovës me 22%, regjioni i Pejës, Ferizaj dhe Mitrovica me nga 15%. Gjithashtu edhe në punësim prinë regjioni i Gjakovës me 51%, pasuar nga regjioni i Pejës me 29%.

Ndërsa në qarkullim te nën aktiviteti “Prodhimi i veshjeve të punës”, prinë regjioni i Gjakovës me 49% dhe regjioni i Pejës me 28%.

Nën aktiviteti i tretë me radhë është “Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)”. Numri më i madh i ndërmarrjeve është shtrirë në regjionin e Prishtinës me 34%, pasuar nga Ferizaj me 18% dhe Gjilani me 14%, ndërsa në punësim dhe qarkullim, prinë regjioni i Pejës me 66% të punësuar dhe në qarkullim me 80%.

4.2. Eksportet dhe importet në nën sektorin e veshjeve

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i veshjeve” ka shënuar rritje të konsiderueshme në tre vitet e fundit. Në vitin 2020 ky nën sektor kishte rritje për 57 %, krahasuar me vitin paraprak, po ashtu rritje për 51% kishte në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

Importi te ky nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 16% krahasuar me vitin paraprak, përderisa në vitin 2019 kishte rritje për 12.21%, krahasuar me vitin 2018.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 1.44% në totalin e eksporteve dhe 5.85% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Raporti mes eksportit dhe importit te ky nën sektor është 5% eksport dhe 95% import. Bilanci tregtar, te ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 2.29%, krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i veshjeve” ka 0.39% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 325 ndërmarrje, 6.77% janë eksportuese.

Tabela 20. Eksporti dhe importi në nën sektorin e veshjeve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i Veshjeve	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019- 2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019- 2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
14	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	2,179,544.62	3,293,023.19	5,156,424.31	1,863,401.15	56.59	105,171,177.93	118,008,278.57	98,738,284.03	(19,269,994.54)	(16.33)
14.1	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	1942304.25	2713627.99	4,629,931.00	1,916,303.32	70.62	88,060,654.36	100,177,489.64	82,365,196.68	(17,812,292.96)	(17.78)
14.2	Prodhimi i artikujve nga gëzofi	0	0	0	-	-	25,687.91	23,558.64	15,377.12	(8,181.52)	(34.73)
14.3	Prodhimi i rrobave të thurura me grep	237240.37	579395.20	526,493.03	(52,902.17)	(9.13)	17,084,835.66	17,807,230.29	16,357,710.23	(1,449,520.06)	(8.14)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të ky nën sektor është 5.15 milion euro, përderisa eksporti me vendet e BE-së është 38%, me vendet e CEFTA-së 9.4%, EFTA-së 7 % dhe vendet tjera 46%. Produktet e nën sektorit “Prodhimi i veshjeve”, në vendet e BE-së, më së tepërmi janë eksportuar në Itali me 30% dhe në Gjermani me 25%. Sa i përket vendeve të CEFTA-s, produktet e nën sektorit “Prodhimi i veshjeve” më së tepërmi janë eksportuar në Maqedoninë e Veriut me 43.3% dhe në Mal të Zi me 24%.

Te vendet e EFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhimi i veshjeve” janë eksportuar në Zvicër me 99%. Eksporti me vendet të tjera, produktet e nën sektorit “Prodhimi i veshjeve” më së tepërmi janë eksportuar në SHBA me 72%. Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i veshjeve”, në vitin 2020, aktiviteti “Prodhimi i veshjeve përveç, veshjeve të gëzofit” në krahasim me aktivitetet tjera të këtij nën sektori ka shënuar rritje, në eksport, me 70.62%, krahasuar me vitin 2019.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Importi në nën sektorin “Prodhimi i veshjeve” në vitin 2020 ka vlerën 98 milion euro. Ky nën sektor në vitin 2020 ka shënuar rënie për 16.33%, krahasuar me vitin 2019. Importi me vendet e BE-së është 6%, me vendet e CEFTA-së 2%, EFTA-së 0.11% dhe me vendet tjera 92%.

Importi më i lartë është nga vendet e tjera, me vlerë prej 90 milion euro. Ky nën sektor importin më të lartë e ka nga Turqia me 52%, nga Kina me 21%, që do të thotë se këto dy shtete përfshijnë 73% të importit në krahasim me shtetet tjera.


Në vendet e BE-së, importi më i lartë është nga Gjermania me 16.4%, nga Italia me 15.8% dhe nga Belgjika me 15%.

Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, gjatë vitit 2020, nga vendet e CEFTA-së, ka shënuar import në vlerë prej 1.13milion euro. Importi më i lart është realizuar nga Serbia me 55% dhe Maqedonia e Veriut me 38%.

Aktiviteti “Prodhimi i veshjeve përveç, veshjeve të gëzofit” krahasuar me aktivitete tjera dominon në import, me 85%. Vendet me importin më të madh janë Turqia me 49.25% dhe Kina me 20.59%.

Nga vendet e EFTA-së, vlera e importit është 1.11milion euro, importi me i lartë është shënuar nga Zvicra me 99%.

Figura 6. Sektori C – Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e prodhimit të Veshjeve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Shkëmbimi tregtar sipas figurës nr. 6, për vitin 2020, tregon se aktiviteti “Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit”, ka shënuar trend pozitiv në eksport, rreth 2.68% në raport me importin.

5. PRODHIMI I LËKURËS DHE PRODUKTEVE PREJ LËKURËS

Industria e lëkurës në Kosovë e ka zanafillën në traditën e regjësve të lëkurës dhe saraçëve për përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e këpucëve dhe daton që nga viti 1945.

Prodhimet e lëkurë-këpucëve kanë pësuar rënie sistematike të prodhimit industrial që nga viti 1989/1990, si pasojë e regjimit i cili zgjati deri në përmasa të luftës në vitet 1998/1999.

Ekonomia e Kosovës gjatë kësaj periudhe nuk ka operuar si një tërësi ekonomike, dhe duke marrë parasysh pozitën ekonomike në të kaluarën, masat ndëshkuese të cilat janë marrë ndaj vendit kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e prodhimit industrial edhe të nën sektorit të lëkurë-këpucëve.

Gjatë kësaj periudhe shfrytëzimi i teknologjisë është bërë në mënyrë të egër dhe duke mos i mirëmbajtur me qëllim të shkatërrimit të tyre. Nga analizat statistikore të këtij nën sektori, shkëmbimi tregtar, në tri vitet e fundit, ka trend rënie në eksport, e sidomos në të dhënat e vitit 2020, derisa edhe importi ka shënuar rënie krahasuar me vitet paraprake.

5.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkurës

Nën sektori i “Lëkurës dhe produkteve prej lëkure”, ka ndikim optimal në punësim, me lëvizje të lehtë gjatë tri viteve të fundit. Nga ky fakt është analizuar numri i ndërmarrjeve, të punësuarve si dhe qarkullimi vjetor për vitet 2018-2020.

Në këtë nën sektor, në vitin 2020, numri i ndërmarrjeve është 43, numri i të punësuarve është 420, dhe qarkullim vjetor në vlerë prej 5.77 milion euro. Ky nën sektorë ka shënuar rritje në punësim për 41 të punësuar apo 10.82% dhe në numër të ndërmarrjeve për 48.28%, ndërsa qarkullimi ka shënuar rënie për 23.03%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (15) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 0.76% të ndërmarrjeve,
- 1.21% të punësuarve dhe
- 0.42% në qarkullim.

Tabela 21. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të lëkurës

Kodi	Nën sektori (15): Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1511	Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	2	1	2	4	0	3	10,500.40	9,647.20	33,664.85
1512	Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësëndeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve	11	9	14	31	38	40	706,814.59	872,234.49	800,745.93
1520	Prodhimi i këpucëve	24	19	27	395	341	377	6,095,315.47	6,274,768.69	4,982,531.9
Gjithsej		37	29	43	430	379	420	6,812,630.46	7,156,650.38	5,816,942.68

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat e analizuara për nën sektorin “Prodhimi i Lëkurës dhe produkteve nga lëkura”, sipas shtrirjes regjionale në numër të ndërmarrjeve, tregojnë se prin regjioni i Prizrenit me 32.56%, regjioni i Prishtinës me 30.23%, regjioni i Pejës me 16.28%, regjionet e Ferizajt dhe Gjakovës me nga 6.98%, ndërsa regjioni i Mitrovicës me 4.65% dhe regjioni i Gjilanit me 2.33%.

Në numër të punësuarve në këtë nën sektor prin regjioni i Prizrenit me 49.29%, pasuar nga regjioni i Prishtinës me 18.33%, regjioni i Ferizajt me 13.33%, regjioni i Pejës me 11.9%, regjioni i Mitrovicës me 6.19%, regjioni i Gjakovës me 0.71% dhe regjioni i Gjilanit me vetëm 0.24%, në punësim. Sipas qarkullimit vjetor renditja regjionale paraqet regjionin e Prizrenit me 48.23%, regjionin e Ferizajt me 24.07%, regjioni i Prishtinës me 16.61%, regjioni i Pejës me 9.14%, regjioni i Mitrovicës me 1.26%, regjioni i Gjakovës me 0.67% dhe regjioni i Gjilanit me vetëm 0.02%.

Nga të dhënat e analizuara, nëse trajtojmë numrin e ndërmarrjeve sipas nën aktivitetit, atëherë “Prodhimi i këpucëve”, prin në regjionin e Prizrenit me 48.15%, pasuar nga regjioni i Prishtinës me 25.93%, pastaj regjioni i Pejës me 14.81%, regjioni i Ferizajt me 7.41%, regjioni i Mitrovicës me 3.7%, etj.

Nën aktiviteti i dytë për nga numri i ndërmarrjeve është “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve” ku prijnë regjioni i Prishtinës me 42.86%, pasuar nga regjioni i Pejës me 21.43%, pastaj regjioni i Gjakovës me 14.29%, pastaj regjionet Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit, me 7.14%.

Duke u bazuar në këto të dhëna krahasuese, në kuadër të këtij nën sektori, nën aktiviteti me numër më të lartë të punësuarve është “Prodhimi i këpucëve”, ku prin regjioni i Prizrenit me 54.64% të punësuar. Regjioni i dytë me punësim në këtë nën aktivitet është Ferizaj me 13.53%, pasuar nga regjioni i Pejës me 13.26%, regjioni i Prishtinës me 11.67%, regjioni i Mitrovicës me 6.9%, etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve”, radhitet në vendin e dytë me punësim, në regjionin e Prishtinës me rreth 82.5%, më pas regjioni i Ferizajt me 12.5%, regjionet e Prizrenit dhe Gjilanit me nga 2.5% etj.

Radhitja e regjioneve sipas qarkullimit vjetor në nën aktivitetin “Prodhimi i këpucëve”, në kuadër të nën sektorit, për vitin 2020, i cili ka 4.98 milion euro, prin regjioni i Prizrenit me 56.27%, pasuar nga regjioni i Ferizajt me 27.51%, regjioni i Pejës me 10.5%, etj.

Në vendin e dytë për nga qarkullimi vjetor radhitet nën aktiviteti “Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve”, në regjionin e Prishtinës me 93.34%, regjionin e Ferizajt me 3.64%, pasuar nga regjioni i Gjakovës me 1.56%, etj.

Nën aktiviteti “Tanimi dhe regjia e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit”, për nga qarkullimi vjetor dominon në regjionin e Gjakovës me 78.95%, dhe regjionin e Mitrovicës me 21.05%.

5.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkure

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës”, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 24.18%, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2019, ka shënuar rritje për 12.62%, krahasuar me vitin 2018.

Importi te ky nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 22.62%, krahasuar me vitin paraprak, përderisa në vitin 2019 kishte rritje për 10.83% krahasuar me vitin 2018.

Shkëmbimi tregtar (raporti i eksportit me importin) te ky nën sektor është 94.24% import dhe 5.76% eksport.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës” ka 0.11% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 43 ndërmarrje, 13.95% janë eksportuese.⁷

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 0.59% në totalin e eksporteve dhe 1.24% në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Tabela 22. Eksporti dhe importi në nën sektorin e prodhimit të lëkurës(15).

Kodi	Nën sektori (15): Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2018	2019	2020	Vlera	%	2018	2019	2020	Vlera	%
					2019-2020	2019-2020				2019-2020	2019-2020
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	2,735,479.11	3,080,819.54	2,335,813	(745,006.77)	(24.18)	44,554,440.03	49,380,964.63	38,212,879.80	(11,168,084.83)	(22.62)
15.1	Tanimi dhe regjia e lëkurës; prodhimi i va ligjeve ,çantave ,takëmeve te kuajve dhe takëmeve te tjerë ,veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	956,459.59	846,035.43	119,632	(726,403.63)	(85.86)	8,857,972.36	9,418,650.59	6,408,762.01	(3,009,888.58)	(31.96)
15.2	Prodhimi i këpucëve	1,779,019.52	2,234,784.11	2,216,181	(18,603.14)	(0.83)	35,696,467.67	39,962,314.04	31,804,117.79	(8,158,196.25)	(20.41)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e eksporteve të nën sektorit “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës” është 2.33 milion euro. Produktet eksportohen kryesisht në vendet e BE-së me 61.77%, në vendet e CEFTA-së me 37.56%, ndërsa me një përqindje shumë të ulët në vendet e EFTA-së me 0.19% dhe në vendet tjera me vetëm 0.48%. Vendet në të cilat më së tepërmi janë eksportuar produktet e këtij nën sektor janë në Francë me 29.64%, në Shqipëri me 28.57%, në Poloni me 22.96%, etj.

Sipas Tabelës nr.22, Aktiviteti “Prodhimi i këpucëve”, që ka vlerë prej 2.21 milion euro, në vitin 2020, ka shënuar rënie në eksport për 0.83% krahasuar me vitin 2019.

Produktet e këpucëve, në vendet e BE-së, janë eksportuar në Francë me 45.05%, në Poloni me 39.34%, në Itali me 13.87%, etj.

Eksporti i produkteve të këpucëve, në vendet e CEFTA-së, kryesisht është realizuar në Shqipëri me 78.17%, në Maqedoninë e Veriut me 14.82% dhe në Mal të Zi me 5.8%, etj.

Në kuadër të vendeve të EFTA-së, produktet e këtij aktiviteti janë eksportuar në Zvicër me 100%.

Në grupimin e Vendeve tjera, eksportet e këtyre produkteve janë realizuar në Kanada me 100%.

Vlera e eksporteve të aktiviteti “Tanimi dhe regjia e lëkurës; prodhimi i valigjeve, çantave, takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë, veshja dhe ngjyrosja e gëzofit”, në vitin 2020, është 119 mijë euro, dhe ka shënuar rënie për 85.86%, krahasuar me vitin 2019.

Këto produkte, në kuadër të vendeve të BE-së, janë eksportuar më së tepërmi në Francë, me 98.27%, në Gjermani me 1.30%, ndërsa në kuadër të vendeve të CEFTA-së, është eksportuar në Maqedoninë e Veriut me 46.16%, në Shqipëri me 31.41%, në Serbi me 22.37%, etj. Produktet e këtij aktiviteti, në vitin 2020, në kuadër të vendeve të EFTA-së janë eksportuar në Zvicër me 100%.

- **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e importeve të nën sektorit “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës” është 38.21 milion euro, importi me vendet e BE-së është 8.49%, me vendet e CEFTA-së, 3.2%, EFTA-së 0.15% dhe vendet tjera 88.16%.

Vendet nga të cilat janë importuar më së tepërmi produktet e nën sektorit “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” janë: nga Kina me 38.12%, nga Turqia me 21.55% dhe nga Vietnami me 14.88%.


Bazuar nga të dhënat në tabelën e më sipërme, vërejmë se nëse e trajtojmë importin sipas aktiviteteve në kuadër të këtij nën sektorit, “Prodhimi i këpucëve”, në vitin 2020, ka shënuar rënie në import me 20.41%, krahasuar me vitin 2019. Vendet nga të cilat janë importuar më së

tepërmi produktet e këpucëve, në kuadër të vendeve të BE-së, janë nga Italia me 31.53%, nga Kroacia me 26.33%, nga Portugalia me 10.42%, etj.

Importi i produkteve të aktivitetit “Prodhimi i këpucëve” nga vendet e CEFTA-së, është realizuar kryesisht nga Serbia me 56.7%, nga Shqipëria me 37.53%, nga Maqedonia e Veriut 5.27%, etj. Produktet e këtij aktiviteti nga vendet EFTA-së, janë importuar nga Zvicra me 97.44% dhe nga Norvegjia me 2.56%. Importet e këtyre produkteve me Vendet tjera janë importuar kryesisht nga Kina me 39.55%, nga Turqia me 24.22%, nga Vietnami me 19.31%, etj.

Aktiviteti i dytë është “Tanimi dhe regjja e lëkurës; prodhimi i valigjeve, çantave, takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë, veshja dhe ngjyrosja e gëzofit”, i cili në vitin 2020 ka shënuar import më të ulët për 31.96%, krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte në vendet e BE-së, janë importuar nga Italia me 59.52%, nga Polonia me 15.29%, etj. Nga vendet e CEFTA-së, kryesisht janë importuar nga Serbia me 41.8%, nga Maqedonia e veriut me 37.52%, nga Shqipëria me 17.72%, etj. Me vendet e EFTA-së nga Zvicra me 99.02%, etj. Me Vendet e tjera nga Kina me 61.85%, nga Turqia me 25.53%, etj.

Figura 7. Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e prodhimit të lëkurës dhe produkteve prej lëkure



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Figurës nr. 7, trendi i shkëmbimit tregtar, në vitin 2020, i aktivitetit “Prodhimi i këpucëve” ka shënuar rritje në eksport për 1.21%, si dhe aktiviteti “Tanimi dhe regjja e lëkurës; prodhimi i valigjeve, çantave, takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë, veshja dhe ngjyrosja e gëzofit”, ka shënuar rënie në eksport për 6.41%, krahasuar me vitin paraprak.

6. PRODHIMI I DRURIT DHE I PRODUKTEVE TË DRURIT DHE TË TAPËS, PËRVEÇ MOBILIEVE; PRODHIMI I ARTIKUJVE NGA KASHA DHE MATERIALEVE TË GËRSHETUARA-THURËSE

Ky nën sektor përfshin prodhimin e produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobileve; prodhimin e artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshtuara-thurje. Më konkretisht kjo ndarje përfshinë prodhimin e produkteve të drurit, kompensatë, rimeso, enë druri, dysheme drurit, mbërthese druri dhe objekte druri të pa fabrikuar. Proceset e prodhimit përfshijnë: sharrimin, planifikimin, formësimin, petëzimin dhe montimin e produkteve të drurit, duke filluar nga lëndët drusore të prera, ose formësimet nga mjetet tjera formuese.

Bazuar në Inventarin Kombëtar të Pyjeve 2012/13, sipërfaqja pyjore në Kosovë është rreth 481 mijë ha (44.7% e sipërfaqes totale) dhe mund të konsiderohen resurse të mira për ekonominë e Kosovës.

Nën sektori i përpunimit të drurit në Kosovë, konsiderohet në të gjitha analizat e konkurrueshmërisë përfshirë Raportin e vlerësimit të sektorit të drurit në Kosovë 2015, të programit EMPOWER të USAID-it, Analizën e zinxhirit të vlerës të nën sektorit të materialit ndërtimor prej druri 2018, implementuar nga International Development Ireland, financuar nga BE për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Studimin e shkathtësive të nevojshme në nën sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë 2017, të zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me SPARK i financuar dhe menaxhuar nga Bashkimi Evropian. Këto analiza si dhe vlerësimet e UNDP-së, për këtë nën sektor, tregojnë se nën sektori i drurit, në Kosovë, është me potencial të madh për zhvillimin ekonomik.

Prodhimi i përgjithshëm i drurit të rumbullakët në BE arriti në rreth 470 milion m³ në 2017; gati 8 milion m³ (1.7%) më shumë sesa prodhimi i regjistruar në 2007. Nga shtetet anëtare të BE-së, Suedia prodhoi 73 milion m³, në 2017, e ndjekur nga Finlanda, Gjermania dhe Franca (secila prodhon midis 51 dhe 64 milion m³). Pothuajse një çerek (23.2%) e prodhimit të drurit, 28 vendet e BE në vitin 2017 u përdorën si lëndë djegëse, ndërsa pjesa tjetër ishte përdorur për industrinë e drurit dhe rimeso, ose për prodhimin e pulpës dhe letrës.⁸

⁸ Ec.europa.eu. (2019). Annual production of roundwood, EU-28, 1999–2017

6.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit

Nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës” sipas tabelës nr.23, ka 1,766 të punësuar në 477 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor prej 46.18 milion euro.

Ky nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rritje të konsiderueshme në punësim për 24%, ndërsa në qarkullim për 3.78% dhe në numër të ndërmarrjeve për 17%.

Nën sektori (16) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 8.46 % të ndërmarrjeve,
- 5.09% të punësuarve dhe
- 3.32% në qarkullim.

Tabela 23. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e drurit

Kodi	Nën sektori (16): Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1610	Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria	120	116	138	333	330	419	8,794,853.21	8,272,590.04	12,631,352.40
1621	Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të paneleve bazuar në dru (furniri)	7	5	6	19	19	16	1,044,726.50	982,935.03	574,390.14
1622	Prodhimi i parketit për dysheme	3	2	5	8	8	14	684,995.90	628,732.46	554,456.06
1623	Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese	239	215	237	787	807	996	21,080,927.57	27,069,582.46	23,570,202.06
1624	Prodhimi i kontejnerëve nga druri	4	5	7	11	16	29	118,240.64	506,990.33	2,011,903.17
1629	Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje	72	65	84	232	249	292	6,197,030.62	7,043,428.15	6,845,541.19
Gjithsej		445	408	477	1,390	1,429	1,766	37,920,774.44	44,504,258.47	46,187,845.02

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 23, në kuadër të këtij nën sektori, nën aktiviteti më me ndikim në punësim, është “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese” me 56.40% të punësuar. Pastaj radhitet nën aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” me 23.73% të punësuarve, ndërsa nën aktiviteti i tretë me radhë është “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje” me 16.53% të punësuar etj.

Bazuar në numrin më të lartë të ndërmarrjeve dhe vlerës së qarkullimit të nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës”, renditja e nën aktiviteteve është e njëjtë si në rastin e punësimit.

Për nga shtrirja regjionale e numrit të ndërmarrjeve, te nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës”, prin regjioni i Prishtinës me 18.24%, regjioni i Prizrenit me 15.51%, regjioni i Gjilanit dhe Gjakovës me nga 14.47%, regjioni i Ferizajt me 13.21% dhe regjioni i Mitrovicës me 9.85%.

Nëse marrim nën aktivitetet me pjesëmarrje më të mëdha të ndërmarrjeve, “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”, prin regjioni i Prizrenit me 17.72%, regjioni i Prishtinës me 16.88%, pastaj radhitet regjioni i Pejës me 15.19%, regjioni i Gjilanit me 14.77%, regjioni i Gjakovës me 14.35% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë është “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria”, në këtë nën aktivitet, prin regjioni i Prizrenit me 15.94%, pastaj radhitet regjioni i Ferizajt me 15.22%, regjioni i Prishtinës dhe i Gjilanit me nga 14.49%, regjioni i Pejës dhe Gjakovës me nga 13.77% dhe regjioni i Mitrovicës me 12.32%.

Nën aktiviteti tjetër i cili ka ndikim të mirë në numër të ndërmarrjeve është “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje”. Në këtë nën aktivitet prin regjioni i Prishtinës me 25%, pastaj radhitet regjioni i Gjilanit me 16.67%, regjioni i Gjakovës me 15.48%, regjioni i Pejës me 14.29%, regjioni i Ferizajt me 11.9% etj.

Në punësim, ky nën sektor prin në regjionin e Mitrovicës me 20.61%, Prishtinës me 19.37%, Pejës me 15.69%, Ferizajt me 12.91%, Prizrenit me 11.21%, Gjakovës me 10.99% dhe Gjilanit me 9.23%.

Nën aktiviteti i cili ndikon më së tepërmi në punësim është “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese”. Në këtë nën aktivitet prin regjioni i Mitrovicës me 28.82%, pastaj radhitet regjioni i Pejës me 15.66%, regjioni i Prishtinës me 14.66% etj.

Punësimi te nën aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria”, dominon në regjionin e Prishtinës me 24.34 %, pastaj në regjionin e Mitrovicës 15.75%, Gjakovës 14.32%, Pejës 13.84%, Prizrenit 12.41%, Gjilanit 10.02% dhe Ferizajt 9.31%.

Regjioni i Prishtinës në punësim dominon me 22.95% edhe te nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje”, më pas radhitet regjioni i Pejës me 20.89%, regjioni i Gjilanit me 16.78%, regjioni i Gjakovës me 16.44%, regjioni i Ferizajt me 15.07% etj.

Nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës” ashtu si në punësim edhe në qarkullim prin në regjionin e Mitrovicës me 37.15% edhe pse për nga numri i ndërmarrjeve ky regjion radhitet i fundit, më pas radhitet regjioni i Prishtinës me 16.21%, regjioni i Prizrenit me 13.62%, regjioni i Pejës me 11.36%, regjioni i Ferizajt me 8.8%, regjioni i Gjakovës me 7.61% dhe regjioni i Gjilanit me 5.25%.

Rreth 51% e qarkullimit të këtij nën sektori, është te nën aktiviteti “Prodhimi i karpentierisë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese” dhe në këtë nën aktivitet me 46.04% prin regjioni i Mitrovicës, pastaj radhitet regjioni i Prizrenit me 12.33%, regjioni i Ferizajt me 11.63%, regjioni i Pejës me 11.14%, regjioni i Prishtinës me 10.18% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë i cili kontribuon në qarkullim te ky nën sektor me 27.35% është “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria”. Po ashtu edhe te ky nën aktivitet prinë regjioni i Mitrovicës me 49.1%, pastaj regjioni i Prizrenit me 19.71%, regjioni i Prishtinës me 14.42% etj.

Nën aktiviteti i tretë me radhë me rreth 15% , i cili kontribuon në qarkullim te ky nën sektor është “Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse”. Ky nën aktivitet prin në regjionin e Pejës me 24.31% pastaj radhitet regjioni i Gjakovës me 22.69%, regjioni i Prishtinës me 16.92%, regjioni i Gjilanit me 14.46%, Prizrenit me 11.24%, regjioni i Ferizajt me 9.13% dhe regjioni i Mitrovicës me pjesëmarrje 1.24%.

6.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit

Eksporti në nën sektorin e “Prodhimit të drurit dhe të produkteve të drurit dhe tapës”, në vitin 2020, ka rritje për 35.6%, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2019 kishte rritje për 41.94%, krahasuar me vitin 2018.

Importi në këtë nën sektor, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 8.83%, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në vitin 2019, kishte rritje për 9.07%, krahasuar me vitin 2018.

Raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 13.12% eksport dhe 86.88% import. Bilanci tregtar, të ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 3.9%, krahasuar me vitin 2019.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 2.61% në totalin e eksporteve dhe 2.25% në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimit të drurit dhe të produkteve të drurit dhe tapës” ka 2.24% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 477 ndërmarrje, 26.42% janë eksportuese.⁹

Tabela 24. Eksporti dhe importi në nën sektorin (16), prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje

Kodi	Nën sektori (16): Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje	Eksporti			Ndryshimi (2019 - 2020)	Ndryshimi në % 2019 - 2020	Importi			Ndryshimi (2019 - 2020)	Ndryshimi në % 2019 - 2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje	5,408,715.00	7,677,012.54	10,409,819.21	2,732,806.67	35.60	69,299,228.65	75,584,593.05	68,913,586.17	(6,671,006.88)	(8.83)
16.1	Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria	551,831.93	736,305.28	548,881.47	(187,423.81)	(25.45)	13,192,537.20	15,972,814.49	15,672,283.36	(300,531.13)	(1.88)
16.2	Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara-thurje	4,856,883.07	6,940,707.26	9,860,937.74	2,920,230.48	42.07	56,106,691.45	59,611,778.56	53,241,302.81	(6,370,475.75)	(10.69)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Vlera totale e eksporteve të ky nën sektor është 10.41 milion euro, eksporti me vendet e BE-së është 45.56%, me Vendet e CEFTA-së 16.76%, EFTA-së 37.18% dhe Vendet tjera 0.5%.

Sipas Tabelës nr. 24, nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje” ka shënuar rritje në vlerën e eksportit për 2.73 milion euro.

Në kuadër të këtij nën sektori, aktiviteti “Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara-thurje”, në vitin 2020, ka shënuar rritje në eksport për 2.92 milion euro, apo 42.07%, derisa në vitin 2019 rritja ishte 2.08 milion euro apo 42.9% krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” në vitin 2020 ka shënuar rënie për 187.42 mijë euro apo 25.45% krahasuar me vitin 2019.

Në kuadër të nën sektorit, aktiviteti “Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara-thurje”, merr pjesë në eksport me 94.73%, derisa aktiviteti, “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria” vetëm me 5.27%.

Në vitin 2020, të dy aktivitetet kanë shënuar rënie në import, aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë”, për vetëm 1.88%, deri sa aktiviteti “Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara-thurje” ka shënuar rënie për 10.69%.

• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Produktet e aktivitetit “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje”, në vitin 2020, nga Kosova janë eksportuar në Zvicër me 36.51%, apo me rritje për 3.8%, në Gjermani me 28.12%, apo me rritje për 8.66%, në Serbi me 9.65% me rënie për 0.86%, në Shqipëri me 6.24% me rënie për 5.78%, krahasuar me vitin 2019, etj.

Eksporti me vendet e BE-së, në vitin 2020, ka shënuar rritje për 52.39%, krahasuar me vitin paraprak, deri sa në vitin 2019, ky nën sektor ka pasur rritje për 100%, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2020, Kosova ka eksportuar produktet e këtij nën sektori në Gjermani 61.68%, në Suedi 12.91%, në Slloveni 11.68% etj.

Eksportet me vendet e CEFTA-së, në vitin 2020, kanë shënuar rënie për 7.18%, deri sa në vitin 2019, ka pasur rritje për 22.72%, krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2019 në eksporte të produkteve të nën sektorit “Prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje” prinë Shqipëria me 49.09%. Në vitin 2020, eksportet e këtij aktiviteti kanë pasur rritje në drejtim të Serbisë me 44.80%, pastaj në Shqipëri me 37.2%, në Maqedoninë e Veriut me 15.18%, etj.

Eksportet me vendet e EFTA-së, në vitin 2020, kanë shënuar rritje për 48.77%, krahasuar me vitin paraprak. Eksporti, në nën sektorin e drurit, në vendet e EFTA-së është realizuar kryesisht në Zvicër me 98.21%, me rritje për 1.66% krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, të dhënat tregojnë se në totalin e eksporteve të këtij nën sektori, Zvicra merr pjesë me 36.51%.

- **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Importet e produkteve të “Prodhimit të drurit dhe produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje”, në vitin 2019, Kosova i ka realizuar nga Mali i Zi 18.82%, nga Gjermania 15.01%, nga Turqia 14.66%, nga Bullgaria 11.8%, etj. Në vitin 2020, importi është realizuar nga Turqia me 17.12%, Gjermania me 15.20%, Mali i Zi me 14.7%, Serbia 6.83% etj.

Vlera totale e importeve të ky nën sektor është 68.91 milion euro, ku importi me vendet e BE-së është 43.82%, me vendet e CEFTA-së 28.04%, EFTA-së 2.28% dhe Vendet tjera 26.12%.

Importi nga vendet e BE-së, në nën sektorin, “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje” realizohet nga Gjermania me 34.67%, nga Austria me 12.68%, Rumania me 10.81%, nga Bullgaria me 10.81% etj.


Importi i produkteve të nën sektorit “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurje” të vendet e CEFTA-së, në vitin 2019 ishte 91.77%, ndërsa në vitin 2020 ishte 52.41%. Produktet e këtij nën sektori janë importuar nga Serbia me 24.35%, Bosnja dhe Hercegovina me 17.52% etj. Nga këto të dhëna, vërehet se importi të ky nën sektor, në kuadër të vendeve të CEFTA-së, dukshëm është rritur nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, deri sa ka pasur rënie për 39.36% nga Mali i Zi.

Importi nga vendet e EFTA-së të ky nën sektor është 100% nga Zvicra.

Kosova, importin nga Vendet tjera të ky nën sektor, në vitin 2020, kryesisht e ka realizuar nga Turqia me 65.57% dhe nga Kina me 22.13% .

Në Figurën nr. 8, është paraqitur raporti dhe trendi në mes të eksportit dhe importit, sipas aktiviteteve, në nivel tre shifrorë, për vitet 2018-2020.

Figura 8. Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e drurit



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Trendi i shkëmbimit tregtar, i aktivitetit, “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë” sipas figurës 8, për periudhën kohore 2018-2020, është në favor të importit. Te aktiviteti, “Prodhimi i produkteve të drurit, tapës, kashtës dhe materialeve të gërshetuara thurje”, në vitin 2020, në kuadër të shkëmbimit tregtar, eksporti ka shënuar rritje për 5.2%, ndërsa te aktiviteti “Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtarisë”, eksporti ka shënuar rënie për 1.03% krahasuar me vitin 2019.

7. PRODHIMI I LETRËS DHE PRODUKTEVE PREJ LETRËS

Nën sektori i letrës është ndër industritë kryesore në botë, konsumi i letrës dhe prodhimi i saj është në rritje të vazhdueshme.

Prodhimi global i letrës dhe kartonit qëndron në rreth 411 milion tonë metrik në vitin 2016. Më shumë se gjysma e prodhimit i atribuohet letrës së paketimit, ndërsa po thuaj se një e treta i atribuohet letrës grafike. Tre vendet më të mëdha prodhuese të letrës në botë janë Kina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia. Këto tre vende përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit të përgjithshëm të letrës në botë.¹⁰

Industria e pulpës dhe e letrës ka marrë shumë kritika nga e gjithë bota, veçanërisht nga grupet mjedisore, prerja e drurit për industrinë e letrës ka qenë e lidhur me rritjen e shpyllëzimit të pyjeve në botë.¹¹

Nën sektori i letrës në këtë raport përfshinë prodhimin e brumit të letrës dhe kartonit dhe prodhimin e artikujve të letrës dhe kartonit ku hynë prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit, prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit, prodhimi i materialit prej letrës për zyre, prodhimi i tapetave të mureve, prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.

Në Kosovë, kryesisht prodhohen: thasë nga letra, qese të letrës, karton i valëzuar për ambalazhim, kutitë sipas kërkesave të tregut, letër kuzhine, tualeti, faculeta, etj.

Industria e letrës në Kosovë, është hulumtuar edhe në raportet tjera, në këtë rast sipas Institutit GAP (Analiza për Industrinë e letrës dhe kartonit, Maj 2016), në Kosovë, prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe kartonit ndahet në dy fusha, në atë të përpunimit të letrës higjienike dhe prodhimit dhe përpunimit të kartonit.

Sa i përket sektorit të letrës, nën aktiviteti i prodhimit të letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit ka një trend pozitiv dhe vërehet një rritje në eksport. Nëse marrim për bazë numrin e ndërmarrjeve dhe punësimin brenda nën sektorit të letrës, atëherë “prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit” prinë si në numër të ndërmarrjes, ashtu edhe në punësim.

¹⁰ www.statista.com, 2019

¹¹ <https://www.statista.com/topics/1701/paper-industry>

7.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës

Shikuar nga numri i ndërmarrjeve dhe punësimit, sektori i letrës nuk ka ndikim aq të lartë në numër të ndërmarrjeve dhe punësim.

Ky nën sektor në vitin 2020, në punësim ka shënuar rritje për 55.61%, në qarkullim për 41.80% dhe në numër të ndërmarrjeve për 15%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (17) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 1.90 % të ndërmarrjeve,
- 2.08% të punësuarve dhe
- 2.87% në qarkullim.

Tabela 25. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e letrës

Kodi	Nën sektori (17): Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1711	Prodhimi i brumit të letrës	-	-	1	-	-	1	-	-	177,745.00
1712	Prodhimi i letrës dhe kartonit	15	14	18	42	39	47	-	7,577,422.92	6,341,262.16
1721	Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit	20	19	23	139	141	148	6,965,685.70	7,955,117.77	6,941,441.23
1722	Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit	31	30	35	173	202	383	7,414,236.88	9,733,949.20	22,617,490.08
1723	Prodhimi i materialit prej letrës për zyre	12	11	13	17	24	67	508,858.10	694,077.32	937,360.34
1724	Prodhimi i tapetave të mureve	2	2	1	4	2	3	8,986.37	21,463.68	21,754.04
1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.	17	17	16	55	56	71	1,691,665.02	2,085,207.77	2,762,216.85
Gjithsej		97	93	107	430	464	720	16,589,432.07	28,067,238.66	39,799,269.7

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 25, në kuadër të këtij nën sektori, pjesëmarrje më e lartë në punësim është te nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me 53.19 %. Ky nën aktivitet në vitin 2020 ka shënuar rritje në punësim për 5.9% krahasuar me vitin paraprak. Nën aktiviteti i dytë me radhë me pjesëmarrje në punësim është “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” me 20.56

%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.” radhitet i treti me pjesëmarrje në punësim për 9.86%.

Në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, të gjithë nën aktivitetet kanë pasur rritje në punësim, ku rritje më të lartë ka shënuar aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me rreth 90%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, në raport me nën aktivitetet tjera, prinë me numër të ndërmarrjeve dhe në qarkullim. Krahasuar me vitin paraprak ky nën aktivitet, në qarkullim, ka shënuar rritje mbi 100%.

Në Tabelën nr.25, nën aktiviteti "prodhimi i brumit të letrës", para vitit 2020 nuk ka qenë prezent. Ky nën aktivitet ka një ndërmarrje të prezantuar me një punëtorë dhe me qarkullim 177 mijë euro.

Në nën sektorin “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” për nga shtrirja regjionale, me numër të ndërmarrjeve, prin regjioni i Prishtinës me 31.78%, regjioni i dytë me radhë është Prizreni me 24.30%, pastaj Ferizaj me 17.76%, Peja me 11.21%, Gjlani me 5.61%, Mitrovica dhe Gjakova me nga 4.67%.

Nën aktiviteti i cili prinë në numër të ndërmarrjeve është “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me 32.71%. Për nga shtrirja regjionale, me numër të ndërmarrjeve, prin regjioni i Prishtinës me 42.86%, regjioni i dytë me radhë është Prizreni me 20%, pastaj Ferizaj dhe Peja me nga 11.43% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë për nga numri i ndërmarrjeve është “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit” me 21.50 %. Në këtë nën aktivitet prinë regjioni i Prizrenit me 39.13, regjioni i Ferizajt me 17.39%, regjioni i Prishtinës, Pejës dhe Gjilanit me nga 13.04% etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës dhe kartonit p.k.t.” për nga numri i ndërmarrjeve radhitet i treti me 16.82%. Në këtë nën aktivitet me numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Prishtinës me 38.89%, pastaj regjioni i Prizrenit me 27.78%, regjioni i Gjakovës me 16.67%, i Pejës me 11.11% etj.

Nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” për nga shtrirja regjionale, në punësim, prinë në regjionin e Prishtinës me 28.75%, Prizrenit me 26.67%, Pejës me 20.28%, Ferizajt me 17.92%, Gjilanit me 4.58%, Gjakovës me 1.53% dhe regjionit të Mitrovicës me 0.28%.

Nën aktiviteti, i cili prinë në punësim është “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”, me 53.9%. Për nga shtrirja regjionale, në punësim në këtë nën aktivitet prinë regjioni i Prishtinës me 41.25%, pastaj regjioni i Pejës me 34.73%, regjioni i Prizrenit me 15.93% etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartonit”, në punësim radhitet i dyti me pjesëmarrje për 20.56%. Sa i përket shtrirjes regjionale në punësim, te ky nën aktivitet , prinë regjioni i Prizrenit me 59.46%, pastaj regjioni i Ferizajt me 20.27%, regjioni i Gjilanit me 11.49% etj.

Nën aktiviteti i cili radhitet i treti për nga punësimi në kuadër të nën sektorit të letrës, është “Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t.” me pjesëmarrje në punësim për 9.86%. Në këtë nën aktivitet në punësim dominon regjioni i Ferizajt me 54.93%, regjioni i Prishtinës me 29.58%, regjioni i Prizrenit me 9.86% etj.

Në qarkullim, nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, prinë në regjionin e Prishtinës me 38.33%, regjioni i Pejës me 26.04%, pastaj regjioni i Prizrenit me 18.03%, regjioni i Ferizajt me 10.55%, regjioni i Gjilanit me 5.78%, i Gjakovës me 1.13% dhe i Mitrovicës me 0.14%.

Në kuadër të këtij nën sektorit, pjesëmarrjen më të lartë në punësim e ka nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit” me 56.83%. Sa i përket shtrirjes regjionale, në qarkullim prinë regjioni i Pejës me 43.95%, me pjesëmarrje po thuaj se të njëjte radhitet edhe regjioni i Prishtinës me 43.66%, etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letrës dhe kartoni”, radhitet i dyti me 17.44% të pjesëmarrjes në qarkullim, në kuadër të këtij nën sektori. Regjioni i cili renditet i pari në këtë nën aktivitet për nga qarkullimi, prinë regjioni i Prizrenit me 47.14%, regjioni i Gjilanit me 24.09%, regjioni i Ferizajt me 22.59%.

Nën aktiviteti i tretë me radhë për nga pjesëmarrja në qarkullim, në kuadër të këtij nën sektori është “Prodhimi i letrës dhe kartonit” me pjesëmarrje prej 15.93%. Sa i përket shtrirjes regjionale, prinë regjioni i Prishtinës me 65.29%, regjioni i Prizrenit me 26.51%, regjioni i Gjakovës me 6.66% etj.

7.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës

Eksporti te nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, ka shënuar rritje në vitin 2020 për 41.9%, deri sa në vitin 2019 kishte rënie për 15.72%, krahasuar me vitin paraprak.

Importi te ky nën sektor, ka shënuar rënie në vitin 2020 për 5.11%, deri sa në vitin 2019 kishte rritje 5.88%, krahasuar me vitin paraprak.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 0.73% në totalin e eksporteve dhe 1.92% në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Raporti mes eksportit dhe importit te ky nën sektor është 4.69% eksport me 95.31% import.

Në vitin 2020 raporti mes eksportit dhe importit ka treguar trend pozitiv në eksport për 1.51%, krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” ka 0.35% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 107 ndërmarrje, 18.69% janë eksportuese.¹²

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Tabela nr.26. Eksporti dhe importi në nën sektorin (17) prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës

Kodi	Nën sektori (17): Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	Eksporti			Ndryshimi (2019 - 2020)	Ndryshi mi në % 2019 - 2020	Importi			Ndryshimi (2019 - 2020)	Ndryshi mi në % 2019 - 2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	2,420,018.61	2,039,439.64	2,893,870.02	854,430.38	41.90	58,497,122.07	61,938,776.04	58,771,929.99	(3,166,846.05)	(5.113)
17.1	Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit	210,940.22	171,671.62	326,704.78	155,033.16	90.31	20,811,670.21	22,965,412.42	20,028,435.88	(2,936,976.54)	(12.789)
17.2	Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit	2,209,078.39	1,867,768.02	2,567,165.24	699,397.22	37.45	37,685,451.86	38,973,363.62	38,743,494.11	(229,869.51)	(0.590)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, është 2.89 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 20.41%, me vendet e CEFTA-së, 75.63%, me vendet e EFTA-së 3.10% dhe vendet tjera 0.87%.

Në kuadër të nën sektorit të letrës, eksportet dominohen me 88.71%, të aktivitetit “Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit” ndërsa aktiviteti “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit” në eksport merr pjesë me 11.23%.

Sipas Tabelës nr. 26, deri sa në vitin 2019 të dy aktivitetet kanë pasur rënie në eksport, në vitin 2020, këto aktivitetet kanë shënuar rritje. Rritjen më të lartë e ka shënuar aktiviteti “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit” me 90.31%, ndërsa aktiviteti “Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit”, ka shënuar rritje për 37.45%, apo 699.39 mijë euro, krahasuar me vitin paraprak.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, eksportohen në Shqipëri me 37.60%, në Maqedoninë e Veriut me 23.43%, Gjermani me 8.84%, Serbi 8.37% etj.

Eksporti me vendet e BE-së, në vitin 2020, ka shënuar rritje mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak, deri sa në vitin 2019, ky nën sektor ka pasur rritje për 62.85%, krahasuar me vitin 2018.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” në vendet e BE-së, kryesisht janë eksportuar në Gjermani me 43.34%, deri sa në vitin 2019 ishte 65.9%, në Austri 20.84%, në Francë 15.66% etj.

Eksporti me vendet e CEFTA-së, në vitin 2020, ka shënuar rritje për 22.27%, krahasuar me vitin paraprak, deri sa në vitin 2019 ky nën sektor ka pasur rënie për 19.66%, krahasuar me vitin 2018.

Me vendet e CEFTA-së, në vitin 2020, produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, kryesisht janë eksportuar në Shqipëri me 49.72%, me rritje për rreth 19% krahasuar me vitin 2019, në Maqedoninë e Veriut me 30.98% me rënie rreth 25%, në Serbi me 11.07%.

Eksporti me vendet e EFTA-së, në vitin 2020, ka shënuar rritje mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak, deri sa në vitin 2019 ky nën sektor ka pasur rënie për 20.58%, krahasuar me vitin 2018.

Eksporti me vendet e EFTA-së, në vitin 2020 ishte 100% në Zvicër me rritje për 25%, në raport me vendet tjera të EFTA-së, krahasuar me vitin 2019.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, në Vendet tjera, në vitin 2020, janë eksportuar, në Turqi 55.36%, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 38.20%, në Indi 6.40% dhe Ekuador 0.05%.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e importeve të nën sektori “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, është 58.77 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 47.21%, nga vendet e CEFTA-së 30.24%, nga vendet e EFTA-së 0.71% dhe vendet tjera 21.83%.

Importet kryesisht dominojnë, me 65.92%, të aktiviteti “Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit” deri sa aktiviteti “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit” në importe merr pjesë me 34.08%.

Sipas Tabelës nr. 26, në vitin 2020, në të dy aktivitetet është shënuar rënie në import, krahasuar me vitin 2019. Rënie më të lartë, si në vlerë monetare ashtu edhe në përqindje ka pasur aktiviteti “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit”, me 2.94 milion euro apo 12.79%.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës”, janë importuar nga Turqia 13.54%, Shqipëria 13.45%, Serbia 8.53%, Maqedonia e Veriut 6.78%, Italia 6.29%, Gjermania 6.02% etj.

Importi me vendet e BE-së, është realizuar nga Italia me 13.29%, Gjermania me 12.73%, Republika Çeke me 12.01%, nga Polonia me 11.80%, nga Greqia me 10.62% etj.


Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” nga vendet e CEFTA-së, janë importuar kryesisht nga Shqipëria me 44.47%, ku në raport me vendet tjera, ka shënuar rënie për 20%. Kosova importon produkte të këtij nën sektori nga Serbia me 28.21%, pastaj nga Maqedonia e Veriut me 22.41% etj.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës” nga vendet e EFTA-së importohen nga Zvicra 92.99% dhe nga Norvegjia me 7.01%.

Produktet e nën sektorit “Prodhimit të letrës dhe produkteve prej letrës” për derisa në eksport, me vendet tjera ishin vetëm 0.87%, importet nga vendet tjera janë 21.83%. Në kuadër të vendeve tjera importi është realizuar kryesisht nga Turqia me 62.28% dhe nga Kina me 18.38%.

Bazuar në të dhënat statistikore, konsiderojmë se duhet përmirësojmë bilancin tregtarë, te aktiviteti “Prodhimi i artikujve të letrës dhe kartonit”, ku raporti mes eksportit dhe importit te aktivitetet është, eksport rreth 6.2% dhe import 93.78%. Orientimi në rritje të kapaciteteve prodhuese, duhet të jetë te nën aktivitetin “Prodhimi i artikujve prej letrës me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit”.

Figura 9. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e letrës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Trendi i shkëmbimit tregtar te të dy aktivitetet në vitin 2020 ka pasur rritje të eksportit krahasuar me vitin 2019.

Sipas Figurës 9. aktivitetit “Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit”, krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020, ka shënuar rritje në eksport për 1.64%, për derisa në vitin 2019 ka pasur rënie për 0.97% krahasuar me vitin 2018. Po ashtu edhe aktiviteti “ Prodhimi i brumit të letrës, letrës dhe kartonit” në vitin 2020 ka shënuar rritje në eksport për 0.87%, deri sa në vitin 2019 kishte rënie për 0.26% krahasuar me vitin paraprak.

8. PRODHIMI I PRODUKTEVE KIMIKE

Industria kimike është një nga degët e rëndësishme të ekonomisë moderne dhe produktet saj përdoren në sektorë tjerë të ekonomisë, siç është bujqësia, prodhimi, ndërtimi dhe shërbimet.

Industria kimike është shumë komplekse, ka më shumë se 200 nën sektorë, numri i produkteve të këtij nën sektori arrin 1 milion produkte. Një grupim i nën sektorëve të industrisë kimike, zakonisht ka tre përbërës e që janë¹³:

- Industria kimike e lidhur me nxjerrjen dhe pasurimin e minierave dhe lëndëve të para kimike - shkëmbin fosfat, kripërat e natriumit dhe kaliumit, squfur, etj.
- Industria kimike kryesore, prodhimi i plehrave minerale, acideve, kripërave, alkaleve, etj.
- Industria e polimerive, bazuar kryesisht në sintezën organike dhe duke përfshirë prodhimin e sintetikes dhe plastikës, fibrave kimike, gomë sintetike, ngjyrave sintetike etj.

Vlen të theksohet se shumica e lëndës së parë dhe faktorëve të ndërmjetëm që përdoren nga bizneset kosovare, në këtë industri, importohen. Importi bëhet kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian (BE-së) si dhe nga shtetet anëtare të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA-së).

Një e pesta e kompanive furnizohen me lëndë të parë nga tregtarët vendorë, ndërkaj pothuajse 13% e tyre furnizohen drejtpërdrejt nga prodhues të huaj. Përveç kësaj, 25% e kompanive kanë deklaruar që përdorin lëndë të parë dhe produkte të ndërmjetme të prodhuara në vend dhe po ashtu të importuara. Në fund, vetëm 10% e kompanive mbështeten në furnizime vendore, nga prodhimi vetjak apo furnizuesit tjerë vendor.¹⁴

8.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve kimike

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike”, sipas tabelës nr. 27, në vitin 2020, ka 762 të punësuar në 114 ndërmarrje, si dhe qarkullim vjetor prej 31.93 milion euro. Në vitin 2020, në të tre treguesit kemi trend pozitiv, në rritje. Në punësim është shënuar rritje për 22.12%, në numër të ndërmarrjeve për 34.12%, po ashtu edhe në qarkullim vjetor për 14.83%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (20) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 2.02% të ndërmarrjeve,
- 2.20% të punësuarve dhe
- 2.30% në qarkullim.

Nga këto të dhëna mund të konstatojmë se ky nën sektor në vitin 2020, ka arritur qëndrueshmëri ekonomike edhe pse dihet që ky vit ka qenë vit i ballafaqimit me pandeminë, Covid-19, por ka treguar rritje në tre treguesit e analizuar krahasuar me vitin paraprak.

¹³ <https://farbitis.ru/sq/geography-of-the-world-economy/world-chemical-industry/>

¹⁴ Profili i Industrisë Kimike, 2016 / MTI

Tabela 27. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në aktivitetet e nën sektorit të industrisë kimike

Kodi	Nën sektori (20): Prodhimi i produkteve Kimike	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
2011	Prodhimi i gazrave industriale	3	2	2	14	10	10	299,679.47	280,891.60	385,914.88
2012	Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve	2	1	2	8	9	11	471,050.06	579,545.04	608,532.41
2013	Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike	3	2	2	47	44	44	1,727,891.63	1,864,096.67	1,763,419.8
2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike	4	3	5	23	9	24	113,274.10	59,187.64	233,457.6
2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit	4	1	3	4	3	7	247,404.65	165,485.65	181,824.8
2016	Prodhimi i plastikës në formë primare	25	20	23	196	167	182	4,933,653.21	4,107,799.45	4,326,729.78
2017	Prodhimi i gomës sintetike në formë primare	0	19	1	0	227	3	0	14,824,990.12	627,873.99
2020	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	1	23	2	8	120	1	247,535.86	4,199,296.74	3,364.83
2030	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës	16	5	20	187	5	291	12,033,722.66	68,709.08	15,765,428.59
2041	Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim	28	3	35	117	14	138	3,206,250.87	1,294,907.27	5,898,064.86
2042	Prodhimin e parfumeve dhe preparateve të tualetit	5	5	7	6	11	10	80,762.87	301,528.38	408,851.72
2051	Prodhimi i eksplozivëve	3	1	3	8	6	15	279,502.69	64,996.20	1,096,341.32
2052	Prodhimi i ngjitësve	6	0	5	11	0	14	254,957.35	0.00	394,876.17
2053	Prodhimi i vajrave esenciale	2	0	1	10	0	2	230,596.65	0.00	90,495.29
2059	Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.	1	0	2	0	0	6	16,949.15	0.00	132,125.98
2060	Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë	1	0	1	3	0	4	2,118.23	0.00	18,208.38
Gjithsej		104	85	114	642	624	762	24,145,349	27,811,433.84	31,935,510.40

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Nga të dhënat e analizuara për nën sektorin “Prodhimi i produkteve kimike”, sipas shtrirjes regjionale në tre treguesit paraqitet si në vijim, në numër të ndërmarrjeve, prinë regjioni i Prishtinës me 29.82%, regjioni i Ferizajt me 17.54%, regjioni i Prizrenit me 16.67%, regjioni i Gjilanit me 11.4%, regjioni i Mitrovicës me 10.53%, regjioni i Gjakovës me 7.89% dhe regjioni i fundit Peja me 6.14%.

Në numër të punësuarve në këtë nën sektor prinë regjioni i Prishtinës me 23.36%, regjioni i Gjilanit me 19.82%, regjioni i Prizrenit me 15.09%, regjioni i Mitrovicës me 13.65%, regjioni i Pejës me 12.34%, regjioni i Ferizajt me 11.42% dhe regjioni i Gjakovës me vetëm 4.33%. Sipas qarkullimit vjetor, prinë regjioni i Prishtinës me 29.23%, regjioni i Pejës me 18.82%, regjioni i Mitrovicës me 17.25%, regjioni i Prizrenit me 12.85%, regjioni i Ferizajt me 8.04%, regjioni i Gjilanit me 7.66 dhe regjioni i Gjakovës me 6.15%.

Bazuar nga të dhënat e Tabelës nr. 27, në vitin 2020, nën aktiviteti “Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” gjeneron punësim më të lartë nga ky nën sektor “Prodhimi i produkteve Kimike” me 38.19% të punësuar në 20 ndërmarrje dhe me qarkullim vjetor prej 49.37%. Sipas shtrirjes regjionale në këtë aktivitet në punësim prinë regjioni i Mitrovicës me 31.96%, pasuar nga regjioni i Pejës me 29.55%, regjioni i Prishtinës me 16.15%, etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Mitrovicës me 25%, pasuar nga regjionet e Ferizajt dhe Pejës me nga 20%, etj. Në qarkullim vjetor prinë regjioni i Mitrovicës me 32.77%, regjioni i Pejës me 31.52%, etj.

Ky trend, pozitiv në punësim, në vitin 2020, pasohet nga nën aktiviteti “Prodhimi i plastikës në formë primare”, me 23.88%, në 23 ndërmarrje dhe me qarkullim vjetor prej 13.55%. Punësimi në këtë aktivitet sipas regjioneve, radhit regjionin e Gjilanit me 65.93%, regjioni i Ferizajt me 16.48%, etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Gjilanit me 30.43%, regjioni i Prishtinës me 26.09%, etj. Në qarkullim vjetor prinë regjioni i Gjilanit me 40.89%, regjioni i Ferizajt me 22.46%, etj.

Nën-aktiviteti “Prodhimi i sapunit, detergjenteve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim”, në vitin 2020, ka 18.11% të punësuar në 35 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor për 18.47%. Në këtë nën aktivitet punësimi sipas regjioneve paraqet regjionin e Prishtinës me 52.9%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 22.46% etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Prishtinës me 40%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 20%, etj. Për nga qarkullimi vjetor dominon regjioni i Prishtinës me 60.75%.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i produkteve Kimike”, nën aktiviteti “Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike”, rezulton me të dhënat më të ultë në punësim, për vetëm 0.13%, në 2 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor prej 0.01%. Punësimi në këtë nën aktivitet prinë në regjionin e Gjilanit me 100%. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjionet, Ferizaj dhe Gjilani me nga 50%. Në qarkullim vjetor prinë regjioni i Ferizajt me 95.1%.

8.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të produkteve kimike

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i produkteve kimike”, në vitin 2020, ka shënuar rritje eksponenciale, për mbi 100%, krahasuar me vitin 2019. Ky sektor rritje, për 39.09%, kishte shënuar edhe një vit më parë, krahasuar me vitin paraprak.

Importi në nën sektorin “Prodhimi i produkteve kimike”, ka shënuar rritje më të lehtë në vitin 2020, për 8.03%, si dhe në vitin 2019 për 5.01%, krahasuar me vitin paraprak.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 4.93% në totalin e eksporteve dhe 8.4% në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Shkëmbimi tregtar (raporti i eksportit me importin) te ky nën sektor është 92.9% import dhe 7.1%, eksport.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” ka 0.6% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 114 ndërmarrje, 29.82% janë eksportuese.¹⁵

¹⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Tabela 28. Eksporti dhe importi në nën sektorin (20) prodhimi i produkteve kimike

Kodi	"Prodhimi i produkteve Kimike"	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % 2020> 2019	2018	2019	2020	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % 2020> 2019
20	Prodhimi i produkteve kimike	5,867,275.26	8,160,771.92	19,634,905	11,474,133.27	140.60	226,642,896.45	237,989,157.53	257,101,389.35	19,112,231.82	8.03
20.1	Prodhimi i kimi kateve themelore, plehrave dhe komponimeve të azotit, plastika dhe goma sintetike në format parësore	566,872.29	1,530,808.56	2,570,529	1,039,720.31	67.92	90,067,083.28	94,065,788.50	107,746,168.32	13,680,379.82	14.54
20.2	Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike	294,871.58	1,026.90	73,568	72,540.85	7,064.06	3,496,322.12	4,417,244.74	4,935,359.60	518,114.86	11.73
20.3	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës	1,723,577.99	2,360,820.24	3,621,814	1,260,994.09	53.41	34,178,607.51	32,347,161.50	34,201,039.49	1,853,877.99	5.73
20.4	Prodhimi i sapunëve dhe pastruesve, përgatitje pastrimi dhe lustrimi, parfumeshe dhe përgatitje tualeti	2,768,627.84	3,620,187.96	12,237,368	8,617,179.54	238.03	69,361,328.31	76,683,237.90	76,788,219.89	104,981.99	0.14
20.5	Prodhimi i produkteve të tjera kimike	402,265.37	504,856.79	1,070,898	566,041.22	112.12	25,917,944.44	27,271,826.60	30,142,180.71	2,870,354.11	10.52
20.6	Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificiale	111,060.19	143,071.47	60,729	(82,342.74)	(57.55)	3,621,610.79	3,203,898.29	3,288,421.34	84,523.05	2.64

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e eksporteve të nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” është 19.63 milion euro. Eksporti në vendet e BE-së është 64.66%, në vendet e CEFTA-së 33.63%, në vendet e EFTA-së 1.49% dhe në Vendet tjera me 0.22%.

Eksportet e nën sektorit “Prodhimi i produkteve kimike”, më së tepërmi janë realizuar në Shqipëri me 15.85%, në Mbretërinë e Bashkuar me 12.41%, në Gjermani me 10.3%, në Itali me 11.89%, etj.

Eksportet në këtë nën sektor me vendet e BE-së, në vitin 2020, kanë shënuar rritje të lartë për mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak.

Eksportet në vendet e CEFTA-së, në vitin 2020, të nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike”, kanë vlerë prej 6.60 milion euro, ndërsa kanë shënuar rritje për 37.69%, krahasuar me vitin paraprak.

Në vitin 2020, eksportet në vendet e EFTA-së kanë shënuar rritje për 78.2% dhe eksportet me Vendet tjera kanë shënuar rënie për 22.87%, krahasuar me vitin paraprak.

Sipas Tabelës nr.28, aktiviteti “Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike”, në vitin 2020 ka shënuar rritje tejte të lartë në eksport me mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij aktiviteti, me vendet e BE-së, janë eksportuar në Kroaci për 100%. Në vendet e CEFTA-së, këto produkte janë eksportuar në Serbi për 100%. Eksporti me vendet e EFTA-së, në këtë aktivitet janë realizuar në Zvicër për 100%.

Aktiviteti “Prodhimi i sapunëve dhe pastruesve, përgatitje pastrimi dhe lustrimi, parfumeshe dhe përgatitje tualeti”, në vitin 2020, ka shënuar rritje të lartë, në eksport, për mbi 100%, krahasuar me vitin 2019.

Produktet e këtij aktiviteti janë eksportuar në vendet e BE-së, në Mbretërinë e Bashkuar me 26.75%, në Itali me 25.39%, në Holandë me 7.86%, etj.

Në vendet e CEFTA-së, produktet e aktivitetit “Prodhimi i sapunëve dhe pastruesve, përgatitje pastrimi dhe lustrimi, parfumeshe dhe përgatitje tualeti”, janë eksportuar në Shqipëri me 38.57%, në Maqedoninë e Veriut me 30.17%, në Bosnje dhe Hercegovinë me 12.42%, etj.

Eksportet në vendet EFTA-së nga ky aktivitet janë realizuar në Zvicër me 100%, ndërsa në kuadër të Vendeve tjera është eksportuar në Turqi me 99.99%.

Aktiviteti “Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës” në vitin 2020, ka shënuar rritje në eksporte për 53.41%, krahasuar me vitin paraprak. Në vendet e BE-së ky aktivitet ka realizuar eksport në Gjermani me 67.89%, në Francë me 13.08%, në Belgjikë me 10.76% etj.

Produktet e këtij aktiviteti në vendet e CEFTA-së, janë eksportuar në Shqipëri me 41.02%, në Mal të Zi me 39.45%, në Maqedoninë e Veriut me 16.06% etj.

Eksporti në vendet e EFTA-së, nga ky aktivitet është realizuar në Zvicër me 100%, ndërsa në kuadër të Vendeve tjera, në Turqi me 100%.

Aktiviteti me rënien më të lartë të eksportit në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i produkteve Kimike”, në vitin 2020, është aktiviteti “Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë”, me 57.56%, krahasuar me vitin 2019.

- **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e importeve të nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” është 257.10 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 55.81%, nga vendet e CEFTA-së 13.18%, nga vendet e EFTA-së 0.35% dhe nga Vendet tjera 30.66%.

Importet në nën sektorin “Prodhimi i produkteve kimike”, në vitin 2020, marrin pjesë me 8.40%, në kuadër të importet e Sektorit-C.

Importet e produkteve kimike janë realizuar nga Gjermania me 12.89%, nga Turqia me 12.76%, nga Serbia me 6.12%, nga Italia 5.95%, nga Polonia me 5.78%, etj.

Në vitin 2020, importet kanë shënuar rënie me vendet e BE-së për 3.11% dhe me vendet tjera për 11.49%, ndërsa rritje të importeve kemi në vendet e CEFTA-së për 47.15% dhe me vendet e EFTA-së për 8.08%, krahasuar me vitin 2019.

Sipas tabelës nr. 28, aktiviteti “Prodhimi i kimikateve themelore, plehrave dhe komponimeve të azotit, plastika dhe goma sintetike në format parësore” në import ka shënuar rritje për 14.54%, krahasuar me vitin 2019.

Importet e produkteve të këtij aktiviteti, me vendet e BE-së, janë realizuar nga Gjermania me 24.16%, nga Austria me 15.07%, nga Polonia me 8.92%, nga Franca me 6.29%, etj.

Importet me vendet e CEFTA-së, janë realizuar nga Serbia me 56.67%, nga Maqedonia e Veriut me 31.28%, nga Shqipëria me 8.45%, etj.

Importet nga vendet e EFTA-së, nga ky aktivitet janë realizuar nga Zvicra me 73.69%, dhe nga Norvegjia me 26.31%, ndërsa nga grup Vendet tjera, importi i këtij aktiviteti është realizuar nga Turqia me 33.13%, nga Kina me 13.95%, nga Arabia Saudite me 10.08%, nga SHBA me 7.11%, etj.


Aktiviteti “Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agrokimike”, në vitin 2020, ka shënuar rritje të importeve për 11.73%, produktet e këtij aktiviteti janë importuar nga vendet e BE-së, kryesisht nga Gjermania me 25.36%, nga Polonia me 13.69%, nga Spanja me 9.95%, nga Italia me 7.66%, etj.

Importi me vendet e CEFTA-së, është realizuar nga Serbia me 52.54%, nga Maqedonia e Veriut me 28.5%, nga Shqipëria me 18.96%, etj. Me vendet e EFTA-së, këto produkte janë importuar nga Zvicra me 100%. Me Vendet tjera janë importuar nga Kina me 38.46%, nga Turqia me 36.18%, nga Izraeli me 7.61%, etj.

Aktiviteti me rënie më të lartë në import në vitin 2020, është “Prodhimi i sapunëve dhe pastruesve, përgatitje pastrimi dhe lustrimi, parfumeshe dhe përgatitje tualeti”, me vetëm 0.14%,

krahasuar me vitin 2019. Këto produkte me vendet e BE-së, janë importuar nga Gjermania me 22.72%, nga Polonia me 16.34%, nga Italia me 13.82%, nga Franca me 7.36%, etj. Me vendet e CEFTA-së, importet janë realizuar nga Serbia me 64.1%, nga Maqedonia e veriut me 29.66%, nga Shqipëria me 3.75%, etj. Importi nga vendet e EFTA-së, nga Zvicra me 95.85%, nga Islanda me 0.15%, etj. Importi nga Vendet tjera në këtë aktivitet është realizuar nga Turqia me 72.24%, nga Kina me 18.64%, etj.

Figura 10. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e industrisë së kimike(20).



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Figura nr. 10, pasqyron shkëmbimin tregtar në mes eksporteve dhe importeve, ku aktiviteti “Prodhimi i sapunëve dhe pastruesve, përgatitje pastrimi dhe lustrimi, parfumes dhe përgatitje tualeti” në vitin 2020, ka shënuar rritje në eksport për 9.24%, në raport me vlerën e njëjtë në import.

Aktiviteti “ Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificialë” në vitin 2020, ka shënuar rënie në eksport për 2.46%, ndërsa rritje për vlerën e njëjtë të importit.

9. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË GOMËS DHE TË PLASTIKËS

Plastika është një substance organike që fitohet fillimisht nga përpunimi i karburantit. Një qese plastike zakonisht mund të përdoret për vetëm 30 minuta, por do të duhen 500 vite për t'u dekompozuar. Plastika është rezistente dhe ka lakueshmëri të dukshme, për këtë arsye plastika ka arritur praktikisht nivele aplikimi në çdo fushë, biodegradimi që i bëhet plastikës i duhet 500 deri 1000 vjet.¹⁶

Pavarësisht nga shqetësimet e publikut për ndotjen plastike, duhet të pranojmë se materialet plastike janë shumë efikase në burime, jo vetëm në fazën e tyre të prodhimit, por edhe gjatë fazës së përdorimit të tyre. Për më tepër, industria e plastikës është me rëndësi kyçe për Evropën. Rreth 60,000 kompani veprojnë në këtë industri duke siguruar mbi 1,5 milion vende pune. Qarkullimi i këtyre kompanive mund të llogaritet me 350 miliardë euro. Industria e përgjithshme evropiane e plastikës ka një bilanc tregtar prej afro 15 miliardë eurosh në 2016.

Rreth 60% e prodhimit të plastikës botërore u shfaqën në Evropë (60 milion ton në vitin 2016), kryesisht thermoplastics, polyurethanes dhe plastike të tjera, si thermosets, ngjitëse, coatings ose sealants. Gjashtë vendet më të mëdha evropiane (Gjermania, Italia, Franca, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Polonia) dhe Beneluksit mbulojnë pothuajse 80% të kërkesës Evropiane në vitin 2016. Por edhe për Republikën e Kosovës, prodhimi i plastikës po luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin industrial.¹⁷

Produktet kryesore që prodhohen nga ndërmarrjet e gomës dhe plastikës në Kosovë janë: prodhimi i qeseve, thasëve për mbeturina, bocave fryrëse, shisheve plastike, kutive plastike farmaceutike dhe për argjendari, dritareve dhe dyerve të plastikës, roletave, gypave të plastikës për ujë dhe kanalizim, kova plastike, ambalazh plastike për jogurt, pastaj mbështjellëse të gomave, plastika të gomës, rripa trapez, shirita transportues, lodra të ndryshme prej gomës dhe plastikës, etj.

Në vazhdim do të paraqesim disa të dhëna të industrisë, plastikë dhe gomë, që kanë të bëjnë me eksportin dhe importin sipas nën sektorëve, numrin e të punësuarve, numrin e ndërmarrjeve, si dhe qarkullimin.

¹⁶ <http://akm.gov.al/assets/riciklimi-i-plastikes.pdf>

¹⁷ Raport, Analiza e Zinxhirit të vlerës për sektorin e plastikës (2019) / MTI-DI

9.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës

Nën sektori “Prodhimi i gomës dhe plastikës”, në vitin 2020 ka 3513 të punësuar në 572 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor prej 140 milion euro.

Ky nën sektor ka shënuar rritje në tre indikatorë: në punësim për 26%, në numër në ndërmarrjeve për 19%, dhe në qarkullim për 7.14%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (22) në totalin e sektorit C merr pjesë:

- 10 % të ndërmarrjeve,
- 10 % të punësuarve dhe
- 10 % në qarkullim.

Tabela 29. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në sektorin e industrisë së gomës dhe plastikës

Kodi	Nën sektori (22): Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
2211	Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; veshja dhe riparimi i gomave	5	4	6	29	36	51	1,098,590.01	1,564,812.02	2,150,368.11
2219	Prodhimi i produkteve të tjera të gomës	3	4	4	3	232	230	89,622	4,956,057.26	6,200,909.94
2221	Prodhimi i pllakave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve	32	31	41	192	213	265	11,625,250.00	13,166,811.33	15,488,385.54
2222	Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim	31	30	32	276	300	353	18,288,152.05	20,143,123.31	19,490,447.71
2223	Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari	352	335	379	1565	1655	2092	67,912,731.03	73,855,737.00	77,051,408.48
2229	Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës	81	77	110	309	356	522	15,516,934.00	17,370,630.98	20,036,692.28
Gjithsej		504	481	572	2374	2793	3513	114,531,279.00	131,057,171.90	140,418,212.26

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 29, në vitin 2020, nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” dominon në të tre indikatorët: në punësim me 60%, në numër të ndërmarrjeve me 66% dhe në qarkullim për 55%. Ky nën aktivitet ka pjesëmarrjen më të lartë në krahasim me nën aktivitetet tjera.

Nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës”, ka 15% të punësuar, 19% ndërmarrje dhe qarkullim 14%, kurse nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” ka 10% të punësuar në 32 ndërmarrje dhe me qarkullim vjetor për 14%.

Vlen të theksohet se nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” edhe pse kishte rritje në punësim dhe në numër të ndërmarrjeve, në qarkullim ka rënie për 3.24%.

Në nivel regional, nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari” prinë në regionin e Prishtinës në punësim me 29% në 100 ndërmarrje dhe në qarkullim me 34%. Regjioni i Prizrenit ka 20% të punësuar në 68 ndërmarrje dhe qarkullim 19%, kurse në regjionin e Ferizajt ka 18% të punësuar në 51 ndërmarrje dhe me qarkullim 5%.

Në këtë nën sektor, nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës”, numër më të madh të ndërmarrjeve ka në regjionin e Prishtinës, 29%, të punësuar 38% dhe qarkullim 46%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim” në regjionin e Ferizajt ka 34% të punësuar, me vetëm 1 ndërmarrje dhe me 50% të vlerës së qarkullimit.

9.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të produkteve të gomës dhe plastikës

Eksportet e nën sektorit, “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, kanë shënuar vlerë prej 58.28 milion euro. Në vitin 2020 ky nën sektor ka shënuar rritje për 14%, krahasuar me vitin 2019.

Importi në nën sektorin e “Prodhimit të gomës dhe plastikës”, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë shënuar rënie për 2.3%, deri sa në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kanë shënuar rritje për 2.72 %.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 16% në totalin e eksporteve dhe 9% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 28% eksport dhe 72% import. Bilanci tregtarë, të ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 3%, krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” ka 3.76% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 572 ndërmarrje, 37% janë eksportuese

Tabela 30. Eksporti dhe importi në nën sektorin Prodhimi i gomës dhe plastikës

Kodi	Nën sektori Prodhimi i Gomës dhe Plastikës	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës	46,454,152.31	51,494,994.46	58,284,613.04	6,789,618.58	13.19	151,108,932.16	155,217,193.08	151,630,341.62	(3,586,851.46)	(2.31)
22.1	Prodhimi i produkteve të gomës	5,467,37.83	4,974,513.89	6,878,540.02	1,904,026.31	38.28	27,518,551.20	30,153,645.31	27,451,320.09	(2,702,325.22)	(8.96)
22.2	Prodhimi i produkteve plastike	40,986,774.48	46,520,480.57	51,406,073.84	4,885,592.27	10.50	123,590,380.96	12,506,3547.77	124,179,021.53	(884,526.24)	(0.71)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të ky nën sektor është 58 milion euro, prej të cilave eksporti me vendet e BE-së është 49%, me vendet e CEFTA-së, 27%, me vendet e EFTA-së 18% dhe me Vendet tjera 6.4%. Në vendet e BE-së, shtetet ku më së shumti janë eksportuar produktet e nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” janë në Gjermani me 37% dhe Holandë me 31%. Eksportet me vendet e CEFTA-së, kryesisht realizohen në Serbi 31%, në Shqipëri me 29.5% dhe në Maqedoninë e Veriut me 24.5%.

Në vendet e EFTA-së nën sektori “Prodhimi i gomës dhe plastikës” eksportin e ka të përqendruar në Zvicër me 99%, ndërsa në kuadër të Vendeve tjera ky nën sektor më së tepërmi ka eksportuar në Turqi, me 87%.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, pjesëmarrjen më të lartë në eksport e realizon aktiviteti “Prodhimi i produkteve të plastikes”, me 88%.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera


Vlera totale e importeve të ky nën sektor është 151.630 milion euro, importi me vendet e BE-së është 49%, me vendet e CEFTA-së, 17.4 %, me vendet e EFTA-së 0.62 % dhe me vendet tjera 33%.

Kosova ka importuar produktet e nën sektorit “Prodhiimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, nga këto vende të BE-së: Gjermania me 44%, nga Bullgaria me 10.37%, nga Italia 9.77% etj. Nga vendet e CEFTA-së, importet e produkteve të këtij nën sektorit janë realizuar me 57% nga Maqedonia e Veriut, pasuar nga Serbia me 34% etj.

Produktet e nën sektorit “Prodhiimi i produkteve të gomës dhe plastikës” janë importuar nga Zvicra me 97%, e cila është pjesë e vendeve të EFTA-së ndërsa sa i përket Vendeve tjera ky nën sektor kryesisht ka importuar nga Turqia me 46% dhe nga Kina me 40%. Ky nën sektori, në vitin 2020, ka shënuar rënie në import për 2.31%. Ky nën sektor rënie në importe ka shënuar te aktiviteti “Prodhiimi i produkteve të gomës”, me 8.96% dhe te aktiviteti “Prodhiimi i produkteve plastike” me 0.71%.

Në kuadër të këtij nën sektori importin me të lartë e ka aktiviteti “Prodhiimi i produkteve plastike” me 82%, ndërsa aktiviteti “Prodhiimi i produkteve të gomës” me 18%.

Figura 11. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e industrisë së Gomës dhe Plastikës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Trendi i shkëmbimit tregtarë sipas Figurës nr. 11, tregon se aktiviteti “Prodhiimi i produkteve plastike” ka shënuar trend pozitiv në eksporte me 2.17%, në raport me importin. Aktiviteti “Prodhiimi i produkteve të gomës” ka shënuar trend pozitiv në eksporte për 5.88%, në raport me importin.

10. PRODHIMI I PRODUKTEVE MINERALE JO METALIKE

Produktet minerale jo metalike përfshijnë prodhimin e çimentos, qeramikës, qelqit dhe gëlqeres. Këta sektorë prodhues karakterizohen nga transformimi i mineraleve të natyrshme si guri gëlqeror, silicë dhe argjila përmes një procesi intensiv të energjisë. Produktet përfundimtare variojnë nga produktet e ndërtimit të tilla si çimento, tulla dhe pllaka, pajisje sanitare dhe xham deri tek produktet e konsumit siç janë enët e tavolinës dhe produktet dekorative.¹⁸

Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, në vitin 2006 prodhimi i produkteve minerale jo metalike ishte me vlerë 88.6 miliardë euro. Kjo vlerë është rreth 5.2% e rezultateve totale të prodhimit në BE.

Ndër faktorët shqetësues të ky nën sektor është konsumi i lartë i energjisë elektrike. Nga të gjithë nën sektorët, në vendet e Bashkimit Evropian, ky nën sektor radhitet i treti për nga konsumi i energjisë elektrike.

Kina është prodhuesi më i madh i mineraleve jo-metalike në botë dhe një nga konsumatorët kryesorë të katër produkteve kryesore minerale jo metalike, përfshirë çimenton, zjarrduruesit, xhamin e pllakave dhe qeramikën. Rritja e shpejtë e industrisë së produkteve minerale jo metalike ka sjellë një kërkesë të madhe për energji.¹⁹

Kosova ka pasuri jo metalike të tilla si magnezi, lapor cimentoja, kaolini për pllaka, argjila, kuarci, betoniti, zhavori etj. Në xeheroren e Goleshit nxirrej ndërsa në Magure bluhej e piquej magneziti në magnezit të pjekur kaustik por përpunimi i magnezitit nuk kishte mundësi të kryhej në Kosovë.

Kaolini i nxjerr në Karaçevë dërgohej në Dardanë ku prodhoheshin pllakat e qeramikës. Në Kaçanik prodhohej gëlqerja e pashuar dhe e shuar, në Han të Elezit prodhoheshin tuba të azbest-çimentos, elemente betoni për muratim, pllaka për mbulimin e pullazeve etj. Në disa fabrika të materialit ndërtimor me lokacionet në Prishtinë, Podujevë, Skenderaj, Pejë, Gjakovë e Landovicë prodhoheshin tulla, blloqe dhe tjegulla.

Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë kryesisht prodhohen: produkte prej betonit për qëllime ndërtimi, beton i përzier i gatshëm për ndërtim, thyerje e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare, prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur, prodhimi i llaqeve, formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët etj.

¹⁸ https://ec.europa.eu/growth/sectors/raw-materials/industries/non-metals_en

¹⁹ <https://www.mdpi.com/2071-1050/6/11/8012>

10.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimit dhe qarkullimit në nën sektorin e prodhimit të produkteve minerale jo-metalike

Nën sektori i produkteve minerale jo-metalike, ka ndikim në punësim me 5,082 të punësuar në 511 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor prej 281.10 milion euro.

Ky nën sektor, në vitin 2020, rritje ka shënuar në punësim për 14.10%, në qarkullim për 0.72%, ndërsa në numër të ndërmarrjeve 15.35%.

Nën sektori (23) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 9.07 % të ndërmarrjeve,
- 14.65% të punësuarve dhe
- 20.24 % në qarkullim.

Tabela 31. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e produkteve minerale jo-metalike

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve jo-metalike (23)	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
2311	Prodhimi i qelqit të rrafshët	4	3	5	14	15	23	367,780	450,591.81	350,452.45
2312	Formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët	15	15	18	130	115	123	3,171,843	3,886,091.35	3,026,218.62
2313	Prodhimi i qelqit bosh (i zbrazët)	1	1	1	2	3	2	16,754	13,408.05	20,355.02
2314	Prodhimi i fibrave të qelqit	1	1	2	6	8	14	507,237	1,051,879.72	1,094,069.43
2319	Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi, duke përfshirë edhe mallrat teknike prej qelqi	16	17	16	83	65	67	985,612	1,367,117.00	1,466,798.35
2320	Prodhimi i produkteve rezistuese ndaj zjarrit	4	3	4	31	37	47	2,528,569	2,794,903.09	2,319,932.40
2331	Prodhimi i tullave dhe tjegullave prej qeramike	1	1	2	3	3	4	23,000	24,700.00	21,989.26
2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur	14	12	16	640	637	652	16,209,514	19,242,954.51	18,295,276.25
2341	Prodhimi i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues	5	4	5	9	10	11	45,100	100,672.93	41,699.34
2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramikës	1	1	1	8	5	2	144,850	43,874.49	3,511.24
2343	Prodhimi i izolatorëve prej qeramikës dhe pajisjeve izoluese	1	1	1	1	1	2	109,379	149,858.47	129,203.75
2344	Prodhimi i produkteve të tjera teknike prej qeramikës	1	1	1	1	0	1	-	50,845.15	35,254.20
2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramikës	1	1	1	1	3	5	7,610	42,085.00	140,621.00
2351	Prodhimi i çimentos	2	2	1	2	3	1	70,150	161,401.27	56,686.49
2352	Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit	6	6	6	23	24	22	981,107	818,743.90	1,081,271.72
2361	Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi	151	138	157	1010	1156	1,310	42,168,246	49,933,363.51	46,128,274.31

2362	Prodhimi i produkteve prej llaçit për qëllime ndërtimi	4	3	4	19	24	31	745,285	1,295,776.05	1,798,422.28
2363	Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim	54	51	55	672	1087	1,225	36,140,720	87,445,505.18	101,319,855.24
2364	Prodhimi i llaçeve	6	7	10	80	99	174	14,004,828	15,875,642.09	16,231,725.42
2365	Prodhimi i fibrave të çimentos	2	1	1	4	3	3	11,441	21,063.84	18,180.00
2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos	29	32	40	105	140	174	2,769,970	3,850,189.49	5,740,352.32
2370	Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare	150	134	153	815	843	998	62,207,555	76,157,789.35	66,635,266.70
2391	Prodhimi i produkteve gërryese	3	2	2	9	6	10	434,748	277,425.60	269,861.51
2399	Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t.	6	6	9	128	166	181	11,354,427	14,043,171.08	14,877,424.78
Gjithsej		478	443	511	3796	4454	5082	195,005,725.73	279,099,052.93	281,102,702.08

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 31, nën aktiviteti më me ndikim në punësim, të ky nën sektor, është “Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi” me 1,310, apo 25.78% të punësuar. Në vendin e dytë, për nga punësimi, radhitet nën aktiviteti, “Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim”, me 1,225 apo 24.10% të punësuar, deri sa në qarkullim ky nën aktivitet prinë me 36.04%. Nën aktiviteti i tretë me radhë është “Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare” me 998 apo 19.64% të pjesëmarrjes në punësim.

Sipas shtrirjes regjionale nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Prizrenit me 23.87%, pastaj regjioni i Prishtinës me 22.31%, regjioni i Ferizajt me 15.85%, regjioni i Pejës me 11.15%, regjioni i Gjilanit me 9.79%, regjioni i Gjakovës me 9.20% dhe regjioni i Mitrovicës me 7.83%.

Në numër të ndërmarrjeve, nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi” prinë regjioni i Prizrenit me 33.12%, regjioni i Prishtinës me 19.11%, regjioni i Ferizajt me 15.92% etj.

Nën aktiviteti i cili ka ndikim në numër të ndërmarrjeve është “Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare”, ku prinë regjioni i Prizrenit me 23.53%, regjioni i Prishtinës me 20.26%, regjioni i Pejës me 19.61%, etj.

Nën aktiviteti i tretë me radhë për nga numri i ndërmarrjeve është “Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim”, ku prinë regjioni i Prishtinës me 36.36%, regjioni i Ferizajt me 20%, regjioni i Gjakovës me 12.73% etj.

Në punësim, ky nën sektor prinë në regjionin e Ferizajt me 23.89%, Prizren me 23.65%, Prishtinë me 19%, Gjilanit 9.31%, Gjakovë 9%, Mitrovicë 8% dhe Pejë 7%.

Nën aktiviteti i cili ka më tepër të punësuar është “Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi”. Sa i përket shtrirjes regjionale prinë Prizreni me 35.95%, regjioni i Ferizajt me 20.61%, regjioni i Prishtinës me 15%, i Mitrovicës me 10% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë i cili ka ndikuar në punësim te ky nën sektor është “Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim”, në këtë nën aktivitet prinë regjioni i Ferizajt me 44.49%, regjioni i Prishtinës me 18%, regjioni i Gjakovës me 10% etj.

Nën aktiviteti i tretë me radhë me pjesëmarrje në punësim është “Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare”, në këtë nën aktivitet, në punësim prinë regjioni i Prishtinës me 25%, regjioni i Prizrenit me 22.95%, regjioni i Gjilanit me 17.43%, regjioni i Pejës me 15%, Ferizaj me 11.62% etj.

Në qarkullimi prin nën aktiviteti “Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim” me 36.04%. Sipas shtrirjes regjionale prinë Ferizaj me 58.26%, regjioni i Mitrovicës me 11.65%, regjioni i Prishtinës me 10.55% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë për nga qarkullimi është “Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare”, në këtë nën aktivitet pjesëmarrja më e lartë në qarkullim është në regjionin e Gjilanit me 57.91%, në regjionin e Prishtinës me 23.52%, etj.

Nën aktiviteti i tretë me radhë është “Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi” merr pjesë me 16.41% në qarkullim. Te ky nën aktivitet pjesëmarrje më të lartë në qarkullim ka regjioni i Prizrenit me 32.04%, regjioni i Ferizajt me 23.69%, regjioni i Prishtinës me 18.39%, etj.

10.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të produkteve minerale jo-metalike

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, në të tre vitet e fundit ka shënuar rritje. Ky nën sektor në vitin 2020 ka shënuar rritje për 17.45%, krahasuar me vitin 2019.

Importi në këtë nën sektor, në vitin 2020 ka shënuar rritje për 2.15% krahasuar me vitin paraprak.

Raporti në mes të eksportit dhe importit, te ky nën sektor, është 5.32% eksport dhe 94.68% import. Bilanci tregtarë, te ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport krahasuar me vitin 2019.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike” ka 1.97% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 511 ndërmarrje, 21.72% janë eksportuese.²⁰

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 2.4% në totalin e eksporteve dhe 5.6% në totalin e importeve, të Sektorit C.

²⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Tabela 32. Eksporti dhe importi në nën sektorin (23), prodhimi i produkteve minerale jo-metalike

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
23	Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike	7,843,754.76	8,185,416.75	9,613,701.30	1,428,284.25	17.45	166,279,334.09	167,647,853.52	171,245,487.79	3,597,634.27	2.15
23.1	Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit	2,014,804.86	2,053,424.25	3,142,013.00	1,088,588.75	53.01	29,194,730.28	30,481,637.17	28,285,435.94	(2,196,201.23)	(7.20)
23.2	Prodhimi i produkteve refraktare	62,420.44	3,120.17	8,920.75	5,800.83	185.91	2,692,193.05	2,926,526.09	4,160,601.26	1,234,075.17	42.17
23.3	Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej balte	1,191,747.78	1,196,343.86	1,444,113.49	247,769.14	20.71	53,289,798.56	50,606,094.64	48,897,342.45	(1,708,752.19)	(3.38)
23.4	Prodhimi i produkteve të tjera prej porcelani dhe qeramike	228,834.41	292,910.47	251,561.68	(41,348.47)	(14.12)	9,360,824.72	8,818,755.63	8,290,976.85	(527,778.78)	(5.98)
23.5	Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe suvasë	216,210.46	3,733.78	4,440.20	706.42	18.92	44,747,445.31	46,857,549.60	53,892,433.78	7,034,884.18	15.01
23.6	Prodhimi i artikujve prej betoni, çimentoje dhe suvaje	2,488,881.70	3,145,092.37	2,255,432.06	(889,660.37)	(28.29)	8,700,035.17	9,376,613.60	11,580,562.74	2,203,949.14	23.50
23.7	Prerja, formësimi dhe përfundimi i gurit	1,218,679.94	1,103,888.96	1,090,174.22	(13,714.96)	(1.24)	8,648,503.62	6,983,705.80	6,358,725.29	(624,980.51)	(8.95)
23.9	Prodhimi i produkteve gërryese dhe produkteve minerale jo metalike	422,175.17	386,902.89	1,417,045.90	1,030,143.11	266.25	9,645,803.38	11,596,970.99	9,779,409.48	(1,817,561.51)	(15.67)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

• **Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e eksporteve të nën sektorit “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike” është 9.61 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 24%, me vendet e CEFTA-së, 51%, me vendet e EFTA-së 22% dhe Vendet tjera 2.74%. Bazuar në Tabelën nr. 32, në vitin 2020 ky nën sektorë, ka shënuar rritje për 17.45 krahasuar me vitin 2019. Nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, ka arritur të eksportoje në vendet e BE-së, në vlerë prej 2.29 milion euro. Produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Gjermani me 54% dhe Rumani me 16%.

Sa i përket eksportit me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, më së tepërmi janë eksportuar në Shqipëri me 33.48%, në Maqedoni e Veriut me 27.68% dhe me 25.28% në Mal të Zi.

Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në vendet e EFTA-së, konkretisht në Zvicër, me vlerë prej 2.12 milion euro, apo për 99%, gjë që e bënë edhe shtetin me të synuar për treg.

Ndërsa eksporti me Vendet tjera ka shënuar vlerën 3 milion euro dhe produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Kore me 36.32%, Kazakistan me 23% dhe SHBA me 23%.

Në kuadër të nën sektorit, aktivitetit “Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit” prinë në eksport me 33%, pasuar nga aktiviteti “Prodhimi i artikujve prej betoni, çimentoje dhe suvaje” me 24%, “Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej balte” me 15% etj.

• **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Importi i përgjithshëm, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike” është 171 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 30%, nga vendet e CEFTA-së 42.33%, nga vendet e EFTA-së 0.51% dhe nga Vendet tjera 27%.


Importet, në nën sektorin “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, janë në vlerë më të madhe në vendet e CEFTA-së, me vlerë prej 72 milion euro. Importi i këtyre produkteve më së tepërmi është realizuar nga Shqipëria me 47% dhe nga Maqedonia e Veriut me 38%.

Sa i përket importeve me vendet e BE-së, produktet e nën sektorit “Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike”, janë importuar nga Spanja me 20.42% nga Italia me 15%, Kroacia 15% etj. Produktet e këtij nën sektori janë importuar nga vendet e EFTA-së, 76% e prej të cilave janë importuar nga Zvicra.

Importi me Vendet tjera ka shënuar vlerën prej 46 milion euro, produktet këtij nën sektori më së tepërmi janë importuar nga Kina me 37% dhe nga Turqia me 30%.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i produkteve minerale jo-metalike”, ndër aktivitetet më me ndikim në rritjen e importeve, në vitin 2020, është “Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe suvasë” me 31.4%, aktiviteti “Prodhimi i materialeve të ndërtimit prej balte” me 28.5%, “Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit” me 16.5%, krahasuar me vitin 2019.

Figura 12. Sektori C – Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e prodhimit të produkteve minerale jo-metalike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat për shkëmbimin tregtar për aktivitetet “Prodhimi i produkteve gërryese dhe produkteve minerale jo metalike”, për vitin 2020, tregon se eksporti ka shënuar rritje për 10%, derisa importi ka shënuar rënie për normën e njëjtë, krahasuar me vitin paraprak. Aktiviteti “Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit” ka shënuar rritje në eksport për 4% në raport me importin.

11. PRODHIMI I METALEVE

Prodhimi i metaleve, përfshin ndarjen e veprimtarive të shkrirjes dhe/ose rafinimit të metaleve me ngjyrë dhe pangjyrë nga xeherorja, metali i shkrirë ose nga mbeturinat, duke përdorur procese dhe teknika elektro-metalurgjike dhe procese të tjera metalurgjike. Po ashtu përfshin prodhimin e përzierjeve të metaleve dhe super-përzierjeve duke futur elemente të tjera kimike në metalet e pastra.

Prodhimi i shkrirjes dhe i rafinimit, zakonisht në formë të kallëpit, përdoret në veprimtari të petëzimit, tërheqjes dhe ngjeshjes, për të bërë produkte, siç janë: pllakat, fletëzat, rripat, kallëpet, shufrat, telat ose tubacionet, gypat dhe profilet e zbrazëta, dhe në formën e shkrirë për t'i bërë derdhjet, si dhe produktet e tjera bazë të metalit.

Nën sektori i përpunimit të metalit karakterizohet nga një grup i vogël i ndërmarrjeve të mëdha (industri tradicionale të zhvilluara në Kosovë para viteve të '90, shumica e të cilave tashmë janë privatizuar), të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit, eksporteve dhe punësimit. Ndërmarrjet e këtij nën sektori, shfrytëzojnë resurset e pasura të Kosovës me xehe të metaleve (p.sh. nikelit), për të prodhuar metale bazë që zakonisht eksportohen, prodhimin e produkteve fundore (tuba të çeliktë, gypa të çeliktë, radiatorë për ngrohje, produkte të galvanizuar të çelikut, etj.).

Në këtë nën sektor, numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara, janë ndërmarrje mikro dhe të vogla, shumica e të cilave merren me prodhimin e konstrukteve dhe produkteve të metalit që përdoren në industrinë e ndërtimit. Po ashtu, numër të madh të ndërmarrjeve ka prodhimi i komponentëve të metalit, përmes veprimtarisë së përpunimit metalurgjia pluhur, trajtimi dhe veshja e metaleve, si dhe prodhimi i produkteve të metaleve të çmuara, fijeve dhe aluminit.

Në kuptim të vlerës së tregut të prodhimeve, veprimtaria më e rëndësishme është ajo e përpunimit të ferro nikelit, vijuar nga hekuri për përdorim fundor dhe produktet e çelikut.

Deri tani nuk ka pasur masa stimuluese qeveritare që drejtpërdrejt të cilat synojnë sektorin e përpunimit të metaleve.²¹

Megjithatë, ekzistojnë disa masa stimuluese, qëllimi i të cilave është mbështetja e prodhuesve vendorë në përgjithësi dhe që janë të rëndësishme edhe për kompanitë e përpunimit të metalit, si lirimi i mallrave nga tatimi doganor. Stimulimi më i rëndësishëm në këtë drejtim është tarifa doganore 0% për importin e makinerive dhe të lëndës së parë që janë të destinuara për përpunim të mëtejshëm nga kompanitë e prodhimit.

²¹ Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të metalit (2014) / MINT

11.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e metaleve

Në vitin 2020, nën sektori "Prodhimi i metaleve", ka 121 ndërmarrje me 1.280 të punësuar dhe me qarkullim vjetor prej 113.79 milion euro.

Në vitin 2020, ky nën sektor ka shënuar rritje, në të tre treguesit e analizuar: në punësim për 15.32%, në numër të ndërmarrjeve për 30.11% dhe në qarkullimin vjetor me 2.75%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (24) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 2.15% të ndërmarrjeve,
- 3.69% të punësuarve dhe
- 6.70% në qarkullim.

Tabela 33. Numri i ndërmarrjeve, punësimit dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të metaleve

Kodi	Nën sektori (24): Prodhimi i Metaleve	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
2410	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro legurave	22	23	33	867	873	950	38,129,953.58	74,628,127.25	65,792,860.37
2420	Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku	4	6	8	18	74	71	283,224.11	6,898,965.32	9,273,662.73
2431	Tërheqja në të ftohtë e shufrave	-	-	4	-	-	53	-	-	8,950,856.18
2433	Formimi ose palosja e ftohtë	1	2	10	13	13	28	1,345,677.12	1,468,194.43	659,375.25
2434	Tërheqja e ftohtë e telit	9	8	1	12	11	0	207,999.28	242,964.92	1,230.00
2441	Prodhimi i metaleve të çmuara	22	20	21	28	22	28	266,901.07	284,072.62	191,052.16
2442	Prodhimi i aluminit	24	21	29	64	69	87	4,849,685.85	5,897,531.06	6,787,159.06
2444	Prodhimi i bakrit	1	1	1	4	5	5	18,467.28	20,703.77	13,015.37
2445	Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike	4	3	1	6	8	2	324,765.49	316,089.68	23,842.44
2451	Derdhja (fonderia) e hekurit	3	1	4	9	7	14	40,341.52	125,770.66	328,768.36
2452	Derdhja (fonderia) e çelikut	8	7	1	30	30	6	702,213.06	651,245.86	203,291.00
2453	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta	1	1	7	-	0	36	2,850.00	19,788.60	813,210.33
2454	Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera jo-ferrike	-	-	1	-	-	-	-	-	2,491.53
	Gjithsej	99	93	121	1051	1110	1280	46,172,078.36	90,553,454.17	93,040,814.78

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Nga të dhënat e analizuara për nën sektorin “Prodhimi i Metalit”, sipas shtrirjes regjionale në numër të ndërmarrjeve, prinë regjioni i Prishtinës me 32.23%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 19.83%, regjioni i Ferizajt me 14.88%, etj. Në numër të të punësuarve në këtë nën sektor prinë regjioni i Prishtinës me 77.58%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 7.34%, regjioni i Gjakovës me 5.23% etj. Qarkullimi prinë në regjionin e Prishtinës me 77.12%, pastaj në regjionin e Gjakovës me 9.08%, regjionin e Prizrenit me 7.37% etj.

Bazuar në Tabelën nr. 33, në vitit 2020, nën aktiviteti që gjeneron punësim më të lartë në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i Metaleve”, është “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro-legurave”, me 74.22% të punësuar në 33 ndërmarrje aktive. Ky nën aktiviteti ka shënuar rritje në numër të ndërmarrjeve për 1.22% dhe rënie në qarkullim për 11.84%, krahasuar me vitin 2019. Sipas shtrirjes regjionale, ky nën aktivitet në punësim prinë në regjionin e Prishtinës me 90.1%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 3.47%, etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Prishtinës me 36.36%, regjioni i Prizrenit dhe ai i Gjakovës me nga 15.15%, etj. Në qarkullim vjetor në këtë nën aktivitet prinë regjioni i Prishtinës me 89.59%, pasuar nga regjioni i Mitrovicës me 1.54%, etj.

Nga të dhënat e analizuara, në vitin 2020, nën-aktiviteti “Prodhimi i aluminit”, në kuadër të nën-sektorit ka 6.8% të punësuar në 29 ndërmarrje dhe me qarkullim vjetor 7.29%. Në këtë aktivitet sipas shtrirjes regjionale, punësimi është koncentruar në regjionin e Prishtinës me 60.92%, pasuar nga regjioni i Ferizajt me 13.79%, etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Prishtinës me 48.27%, pasuar nga regjioni i Mitrovicës me 17.24% etj. Qarkullimi vjetor në këtë nën aktivitet prinë në regjionin e Prishtinës me 48.34%, Ferizaj me 47.38%, etj.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i metaleve”, nën aktivitetit “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku”, në vitin 2020, ka 5.55% të punësuar në 8 ndërmarrje, me 9.97% qarkullim vjetor. Në këtë nën aktivitet sipas shtrirjes regjionale në punësim prinë regjioni i Prishtinës me 67.61%, pasuar nga regjioni i Gjilanit me 21.13%, etj. Në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Gjilanit me 37.5%, regjioni i Prishtinës me 25%. Në qarkullim vjetor prinë regjioni i Prishtinës me 94%, regjioni i Gjilanit me 4.67%, etj.

Nga të dhënat e analizuara në Tabelën nr. 33 vërejmë se nën aktiviteti me më së paku të punësuar në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i metaleve” është nën aktiviteti “Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike”, me vetëm 0.16%, të të punësuarve, në 1 ndërmarrje aktive dhe me rënie në qarkullim vjetor prej 92.46%.

11.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e metaleve

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i metaleve”, ka shënuar rritje në vitin 2020, për 48.17%, e po ashtu rritje kishte edhe në vitin 2019, për 20.17%, krahasuar me vitin paraprak. Ky nën sektorë në vitin 2020 kishte rënie në importe, për 8.81%, deri sa rritje për vetëm 0.24% kishte në vitin 2019, krahasuar me vitin paraprak.

Shkëmbimi tregtar (raporti i eksportit me importin), te ky nën sektor është 68.21% import dhe 31.79% eksport, që krahasuar me vitin 2019, ka tendencë të rritjes së eksporteve në raport me importet.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 28.21% në totalin e eksporteve dhe 7.88% në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i metaleve” ka 0.48% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 121 ndërmarrje, 22.31% janë eksportuese.²²

Tabela 34. Pasqyron të dhënat e eksportit dhe importit në nën-sektorin Prodhimi i metaleve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i metaleve(24).	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2017	2018	2019	Vlera 2018-2019	% 2018-2019	2017	2018	2019	Vlera 2018-2019	% 2018-2019
24	Prodhimi i metaleve	83,307,151.89	63,135,997.19	75,872,939.29	12,736,942.10	20.17	205,753,206.18	263,854,273.63	264,476,551.92	622,278.29	0.24
24.1	Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferro legurave	61,054,910.35	36,945,115.30	53,063,717.63	16,118,602.33	43.63	155,914,705.53	206,344,411.50	200,178,343.60	(6,166,067.90)	(2.99)
24.2	Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku	19,384,493.40	22,663,168.17	19,008,271.59	(3,654,896.58)	(16.13)	6,744,399.30	9,457,833.00	11,419,861.34	1,962,028.34	20.75
24.3	Prodhimi i produkteve të tjera nga përpunimi i parë i çelikut	675,953.59	1,101,923.64	1,331,868.94	229,945.30	20.87	16,249,486.97	16,662,483.48	17,687,320.64	1,024,837.16	6.15
24.4	Prodhimi i metaleve të çmuara dhe metaleve jo-ferrik	2,154,421.88	2,371,727.03	2,393,600.74	21,873.71	0.92	25,767,484.10	30,310,007.21	33,492,560.75	3,182,553.54	10.50
24.5	Derdhja (fonderia) e metaleve	37,372.67	54,063.05	75,480.39	21,417.34	39.62	1,077,130.28	1,079,538.44	1,698,465.59	618,927.15	57.33

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

²² Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera e eksporteve të nën sektori “Prodhimi i metaleve” është 112.42 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 36.8%, me vendet e CEFTA-së, 58.92%, me vendet e EFTA-së, 1.17% dhe me vendet tjera 3.11%.

Eksportet e nën sektorit “Prodhimi i Metaleve”, më së tepërmi janë realizuar në Shqipëri me 41.04%, në Itali me 16.45%, në Maqedoni të Veriut me 8.11%, në Holandë me 4.27%, etj.

Eksportet me vendet e BE-së, në vitin 2020, në këtë nën sektor, janë në vlerë prej 16.02 milion euro dhe kanë shënuar rritje të lartë me 77.47%, krahasuar me vitin paraprak.

Në vitin 2020, eksportet kanë shënuar rritje tejte të lartë, me vendet e CEFTA-së, për mbi 100%, në vendet e EFTA-së kanë shënuar rënie për 7.97%, po ashtu rënie me Vendet tjera për 75.08%, krahasuar me vitin 2019.

Sipas Tabelës nr. 34, Aktiviteti “Prodhimi i metaleve të çmuara dhe metaleve jo-ferrik”, në vitin 2020, ka 3.81 milion euro, me rritje të eksportit për 59.34%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij aktiviteti në vendet e BE-së, janë eksportuar në Austri me 26.06%, në Itali me 23.86%, në Danimarkë me 13.06%, etj. Eksporti me vendet e CEFTA-së, është realizuar në Serbi me 76.99%, në Shqipëri me 20.45%, në Mal të Zi me 1.27%, etj. Eksporti i produkteve nga ky aktivitet është realizuar në vendet e EFTA-së, në Zvicër me 75.53% dhe Norvegji me 24.47%, ndërsa me Vendet tjera në SHBA eksporti është realizuar me 100%.

Aktiviteti “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i fërro legurave”, në vitin 2020, ka shënuar vlerë të lartë në eksporte, për 81.86 milion euro me rritje për 54.27%, krahasuar me vitin 2019. Produktet e këtij aktiviteti, me vendet e BE-së, janë eksportuar më së tepërmi në Itali me 45.75%, në Finlandë me 12.41%, në Suedi me 12.2%, në Mbretërinë e Bashkuar me 11.58%, etj.

Eksportet e këtyre produkteve, në vendet e CEFTA-së, janë realizuar në Shqipëri me 99.36%, në Maqedoninë e Veriut me 0.47%, etj.

Eksportet në vendet e EFTA-së, nga ky aktivitet janë realizuar në Zvicër me 100%, ndërsa në Vendet tjera eksportet e këtij aktiviteti janë realizuar në Kinë me 35.36% dhe në Indi me 14.64%.

Aktiviteti “Derdhja (fonderia) e metaleve” ka shënuar vlerë më të ulët të eksportit për 63 mijë euro, si dhe rënie prej 16.34% në vitin 2020, krahasuar me vitin paraprak. Eksportet e produkteve nga ky aktivitet në vendet e BE-së, janë realizuar në Gjermani me 100%, etj.

Eksportet në vendet e CEFTA-së, janë realizuar në Serbi me 88.9% dhe në Shqipëri me 11.1%. Eksportet në vendet e EFTA-së, nga ky aktivitet është realizuar në Zvicër me 100%.

- **Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera**

Vlera totale e importeve të nën sektorit “Prodhimi i metaleve”, është 241.18 milion euro, nga vendet e BE-së është 19.3%, nga vendet e CEFTA-së 56.66%, EFTA-së 0.34% dhe nga Vendet tjera 23.7%.

Importet, në nën sektorin “Prodhimi i Metaleve”, në vitin 2020, marrin pjesë me 264.47 milion euro apo 7.88%, në importet e përgjithshme të Sektorit-C.

Importet më të larta nga ky nën sektor, janë realizuar nga Shqipëria me 35.45%, nga Maqedonia e Veriut me 10.9% dhe nga Turqia me 9.36%, etj.

Bazuar nga të dhënat e vitit 2020, për nën sektorin “Prodhimi i Metaleve”, importet nga vendet e BE-së kanë shënuar rënie për 21.82% si dhe nga Vendet tjera për 17.65%. Importet nga vendet e EFTA-së, kanë shënuar rritje për 7.25% si dhe nga vendet e CEFTA-së, për 1.4%, krahasuar me vitin 2019.

Sipas Tabelës nr. 34, aktiviteti i vetëm në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i Metaleve”, që ka shënuar rritje të importeve, në vitin 2020, është “Derdhja (fonderia) e metaleve”, me mbi 100%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij aktiviteti nga vendet e BE-së janë importuar nga Austria me 88.49%, nga Italia me 3.02%, etj. Me vendet e CEFTA-së, importet e këtyre produkteve janë nga Maqedonia e Veriut me 92.48%, nga Shqipëria me 1.99%, etj. Me vendet e EFTA-së, importet janë realizuar nga Zvicra me 100%, me Vendet e tjera janë realizuar nga Kina me 75.02%, nga Turqia me 24.32% dhe nga Izraeli me 0.15%.


Aktiviteti “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku”, në vitin 2020, ka shënuar importin më të ulët, në kuadër të nën sektorit “Prodhimi i metaleve”, me 20.42%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e këtij aktiviteti me vendet e BE-së, janë realizuar nga Italia me 26.44%, nga Polonia me 18.81%, nga Gjermania me 18.25%, etj. Me vendet e CEFTA-së, janë realizuar nga Maqedonia e Veriut me 90.24%, nga Serbia me 5.86%, nga Shqipëria me 3.87%, etj. Me Vendet e tjera janë realizuar nga Turqia me 68.2%, nga Kina me 30.06%, etj.

Aktiviteti “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i fërro legurave “ me vlerë prej 176.51 milion euro, ndërsa në vitin 2020, ky aktivitet ka shënuar rënie në import për 11.82%, krahasuar me vitin 2019.

Produktet e këtij aktiviteti, nga vendet e BE-së, janë importuar nga Greqia me 30.97%, nga Italia me 26.2%, nga Polonia me 18.28%, etj.

Importet e produkteve të aktivitetit “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i fërro legurave “ nga vendet e CEFTA-së, janë realizuar nga Shqipëria me 66.27%, nga Maqedonia e Veriut me 16.77%, nga Bosnja dhe Hercegovina me vetëm 13.06%. Produktet nga vendet e EFTA-së, janë importuar nga Zvicra me 100%, ndërsa nga vendet tjera importi është realizuar nga Ukraina me 34.96%, nga Rusia me 29.97%, nga Turqia me 29.04%, etj.

Figura.13. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin e prodhimit të metaleve



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Figurës nr.13, shkëmbimi tregtar i aktivitetit “Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë si dhe i ferro legurave” në vitin 2020, eksporti ka shënuar rritje për 5.17%, derisa importi ka shënuar rënie për 10.73%, krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu trend pozitiv në rritje të eksportit në vitin 2020, kemi edhe te aktiviteti “Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku”, për 10.69%, dhe rënie importi për normën e njëjtë, krahasuar me vitin paraprak.

Aktiviteti “Derdhja (fonderia), e metaleve”, ka shënuar eksport në rënie prej 3.11%, në vitin 2020, dhe rritje importi për normën e njëjtë, krahasuar me vitin paraprak.

12. PRODHIMI I PRODUKTEVE TË FABRIKUARA METALIKE

Ky nën sektor përfshinë, përpunimin e produkteve nga metali duke i shndërruar në produkte finale si: thika, kyçe të derës, cilindra, veglave të ndryshme, kaçavide, tel, dhe disa produkte të tjera.

Ndërmarrjet e përpunimit të metalit janë pothuajse tërësisht në pronësi private dhe janë të shpërndara anekënd Kosovës, numri më i madh i të cilave janë në rajonin e Prishtinës. Këto ndërmarrje punësojnë rreth 2.7% të gjithsej popullatës së punësuar në Kosovë. Ndërmarrjet e këtij nën sektori, kryesisht janë në pronësi të burrave, pasi që vetëm 5% të fuqisë punëtore janë gra dhe 7% të kompanive janë aksionare gra.²³

Sektori i përpunimit të metalit vazhdon të jetë burim i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë, ndonëse jo në përmasat e njëjta si në të shkuarën. Numri më i madh i ndërmarrjeve të përpunimit të metalit merren me trajtimin dhe veshjen e metaleve ose prodhimin e konstruksioneve dhe elementëve metalike për industrinë e ndërtimit. Investimet e ndërmarrjeve të përpunimit të metalit janë më tepër të natyrës kapitale se sa të lidhura me fuqinë punëtore. Megjithatë, sektori i përpunimit të metalit ka potencial për rritje të prodhimit dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë.

Përpunuesit e metalit në Kosovë, mund t'i shtojnë në masë të madhe vlerën metaleve që destinohen për eksport dhe t'i përmbushin njëherësh kërkesat e tregut vendor me cilësi më të mirë dhe çmime më të ulëta.

Përkrahja për këtë nën sektor ngërthen adresimin e mangësive të kapitalit dhe shkathtësive, lehtësimin e kategorizimeve të sektorëve, si dhe inkurajimin dhe marrjen e certifikimeve për cilësi.²⁴

12.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikuara metalike

Në vitin 2020 nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike”, ka 3112 të punësuar në 736 ndërmarrje dhe me qarkullim në vlerë prej 116.63 milion euro.

Në vitin 2020, punësimi te ky nën sektor ka shënuar rritje për 25%, rritje kanë shënuar numri i ndërmarrjeve për 27% dhe qarkullimi për 10.42%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori (25) në totalin e sektorit C merr pjesë:

- 10.5% të ndërmarrjeve,
- 10% të punësuarve dhe
- 7% në qarkullim

²³ Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të metalit (2014) / MINT

²⁴ <http://empowerkosovo.org/al/perpunimi-i-metalit/>

Tabela 35. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nënë sektorin e Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike.

Kodi	Nën sektori (25): Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
2511	Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre	208	210	261	1435	1390	1598	82,246,440.01	67,804,937.42	70,384,678.80
2512	Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit	121	212	144	298	305	370	8,123,751.84	9,832,475.99	9,244,905.85
2521	Prodhimi i radiatorëve dhe kazanëve për ngrohje gendrore	7	7	7	16	18	207	265,978.61	311,183.96	6,305,943.66
2529	Prodhimi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve të tjerë prej metalit	4	4	4	3.00	4	9	18,913.57	105,013.13	146,119.25
2540	Prodhimi i armëve dhe municionit		-	0	-	-	0	-	-	-
2550	Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; pluhuri metalurgjik	59	51	71	181	207	280	7,226,231.29	8,278,369.09	11,053,942.18
2561	Trajtimi dhe veshja e metaleve	41	35	44	81	70	87	2,161,903.66	2,053,676.32	2,826,620.85
2562	Përpunimi mekanik	69	64	89	175	131	152	8,155,592.56	5,069,039.86	6,071,942.15
2571	Prodhimi i thikave	2	2	2	3	2	2	6,395.30	6,190.59	6,862.00
2572	Prodhimi i bravave dhe cilindrave	2	2	0	2	2	0	-	15,454.00	-
2573	Prodhimi i veglave	3	4	5	2	1	2	2,583.00	27,435.50	25,078.00
2591	Prodhimi i kovave të çelikut dhe mbajtësve të tjerë të ngjashëm	1	1	1	3	5	6	48,541.50	52,393.52	57,189.60
2592	Prodhimi i ambalazheve prej metalit të lehtë	2	2	3	5	7	9	84,391.17	79,478.61	95,048.43
2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe suste	16	16	20	71	73	89	3,375,177.55	3,383,093.78	3,135,408.21
2594	Prodhimi i vidave dhe kaçavidave	4	3	4	9	6	5	194,467.22	165,963.86	76,248.42
2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.	61	68	81	187	272	296	5,521,548.93	8,443,378.19	7,207,387.29
Gjithsej		600	581	736	2471	2494	3112	117,431,916.00	105,628,083.82	116,637,374.69

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr.35, në këtë nën sektor, në vitin 2020, nën aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre” në punësim merr pjesë me 51% në 261 ndërmarrje dhe me qarkullim për 60%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit” ka 12% të punësuar në 144 ndërmarrje dhe në qarkullim merr pjesë me 8%, ndërsa nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t” ka 9.5% të punësuar në 81 ndërmarrje dhe me 6% qarkullim.

Nën aktiviteti “Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t”, renditet e treta me punësim dhe me numër të ndërmarrjeve, ndërsa në qarkullim renditet e katërta, për shkak se në vitin 2020 ka shënuar rënie për 15% krahasuar me vitin paraprak.

Nën aktiviteti “Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; pluhuri metalurgjik” edhe pse ka numër më të ulët në punësim dhe me numër të ndërmarrjeve, në

qarkullim zë vendin e dytë, për shkak se në vitin 2020 ka shënuar rritje për 34% krahasuar me vitin paraprak.

Nga 16 nën aktivitete që i ka nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike”, 9 nën aktivitete janë me numër më të ulët të ndërmarrjeve, ndërsa një nën aktivitet “Prodhimi i armëve dhe municionit” nuk ka asnjë ndërmarrje.

Sa i përket shtrirjes regjionale, nën aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre”, prinë me numër të ndërmarrjeve, në regjionin e Prishtinës me 24%, regjioni i Pejës me 20% dhe Ferizajt me 18%. Ky nën aktivitet, numër më të madh të punësuarve e ka në regjionin e Ferizajt me 37%, pasuar nga regjioni i Prizrenit me 19% dhe Prishtina 16%. Sa i përket vlerës së qarkullimit, nën aktiviteti “Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre” në regjionin e Prishtinës merr pjesë me 30% pasuar nga regjioni i Ferizajt me 28% dhe Gjakova me 15% etj.

Nën aktiviteti “Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metalit”, numrin më të madh të ndërmarrjeve e ka në regjionin e Prishtinës me 25%, regjioni i Gjilanit me 19% dhe regjioni i Ferizajt me 14%. Ky nën aktivitet në regjionin e Prishtinës ka 32.4%, të punësuar, në regjionin e Pejës me 16%, në regjionin e Prizrenit 13% etj. Sa i përket qarkullimit, regjioni i Prishtinës prinë me 39%, regjioni i Pejës me 16%, regjioni i Prizrenit me 14%, etj.

Nën aktiviteti “Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; pluhuri metalurgjik”, prinë në regjionin e Prizrenit me 48% të punësuar në 14 ndërmarrje dhe me qarkullim 64%, regjioni i Prishtinës me 16% të punësuar në 15 ndërmarrje dhe me qarkullim vjetor për 4%, ndërsa regjioni i Gjilanit 13% të punësuar në 11 ndërmarrje dhe me qarkullim për 4%.

12.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikuara metalike

Në vitin 2020, nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike”, ka shënuar rritje në eksport për 35% dhe në import për 11%, krahasuar me vitin 2019.

Raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 20.36% eksport dhe 79.64% import. Bilanci tregtarë, të ky nën sektor, ka shënuar përmirësim në eksport për 3.6%, krahasuar me vitin 2019.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 9% në totalin e eksporteve dhe 7.35% në totalin e importeve, të Sektorit C.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve” ka 2.45% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 736 ndërmarrje, 18.75% janë eksportuese.

Tabela 36. Eksporti dhe importi në nënë-sektorin e prodhimit të produkteve të fabrikua metalike

Kodi	Nën sektori Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	Eksporti			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	21,478,381.68	23,451,261.04	31,730,428.78	8,279,167.74	35.30	110,032,985.05	112,031,510.36	124 107 528.74	12,076,018.38	10.78
25.1	Prodhimi i produkteve të konstruksioneve metalike	9,952,232.96	9,859,784.15	14,399,469.47	4,539,685.32	46.04	22,009,763.39	20,870,865.02	28,100,458.00	7,229,592.98	34.64
25.2	Prodhimi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve prej metalit	2,998,453.49	2,720,552.64	2,426,942.29	(293,610.35)	(10.79)	8,936,208.52	10,022,954.98	18,162,515.79	8,139,560.81	81.21
25.3	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç kazanëve për ngrohje qendrore	789.00	7,702.61	3,466.20	(4,236.41)	(55.00)	276,184.65	1,114,416.51	556,939.65	(557,476.86)	(50.02)
25.4	Prodhimi i armëve dhe municionit	0	0	-	0	0	2,601,674.24	2,862,128.02	5,010,700.68	2,148,572.66	75.07
25.7	Prodhimi i takëmeve të kuzhinës, mjeteve dhe pajisjeve të përgjithshme metalike	803,092.37	1,563,640.88	2,707,596.05	1,143,955.17	73.16	27,478,669.54	28,790,940.01	26,195,967.22	(2,594,972.79)	(9.01)
25.9	Prodhimi i produkteve të tjera prej metalit (me aktivitetet: 9.1,9.2,9.3,9.4,9.9)	7,723,813.86	0	12,192,954.77	12,192,954.77	0	48,730,484.71	48,370,205.82	46,080,947.40	(2,289,258.42)	(4.73)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

• Eksportet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Vlera totale e eksporteve të nën sektori “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike” është 31.73 milion euro. Eksporti me vendet e BE-së është 49.4%, me vendet e CEFTA-së, 29%, me vendet e EFTA-së 18% dhe Vendet tjera 3.5 %.

Bazuar në Tabelën nr. 36, eksporti në nën sektorin “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, në vitin 2020 ka shënuar rritje për 35% krahasuar me vitin 2019. Produktet e këtij nën sektori, janë eksportuar në vendet e BE-së, në vlerë prej 15.68 milion euro. Produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Gjermani me 32%, në Zvicër me 19% dhe në Francë me 18%.

Sa i përket eksportit me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, më së tepërmi janë eksportuar në Shqipëri me 43%, në Maqedoninë e Veriut me 28% dhe në Serbi me 19%.

Eksporti me vendet e EFTA-së më së tepërmi është realizuar në Zvicër, me vlerë prej 5.65 milion euro, apo për 99%, gjë që e bënë shtetin me të synuar për treg. Ndërsa eksporti me vendet tjera ka shënuar vlerën 1.79 milion euro dhe produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë eksportuar në Kazakistan me 80%. Në kuadër të nën sektorit “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve”, aktivitetit “Prodhi i konstruksioneve metalike” prinë në eksport me 45%, pasuar nga aktiviteti “Prodhi i produkteve tjera metalike” me 38%.

• Importet me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera

Importi i përgjithshëm, në nën sektorin “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike” është 124 milion euro. Importi nga vendet e BE-së është 41%, nga vendet e CEFTA-së 15%, nga vendet e EFTA-së 0.73% dhe nga vendet tjera 43%.


Importet, në nën sektorin “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, nga vendet e BE-së, me vlerë prej 52.89 milion euro. Importet e këtyre produkteve më së tepërmi janë realizuar nga Gjermania me 27%, Austria me 20% dhe Italia 14%.

Sa i përket importeve me vendet e CEFTA-së, produktet e nën sektorit “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, më së tepërmi janë importuar nga Serbia me 58% dhe nga Shqipëria me 26%. Importi me vendet e EFTA-së më së tepërmi është realizuar nga Zvicra me 91%.

Importi me Vendet tjera ka shënuar vlerën prej 49.19 milion euro, produktet e këtij nën sektori më së tepërmi janë importuar nga Kina me 51% dhe nga Turqia me 42%.

Në kuadër të nën sektorit “Prodhi i produkteve të fabrikuar metalike”, ndër aktivitetet me rritjen më të lartë të importeve, në vitin 2020 janë : “Prodhi i produkteve tjera prej metali” me 37%, aktiviteti “Prodhi i produkteve të konstruksioneve metalike” me 23% dhe “Prodhi i takëmeve të kuzhinës, mjeteve dhe pajisjeve të përgjithshme metalike” me 21%, krahasuar me vitin 2019.

Figura 14. Raporti mes eksportit dhe importit në nën sektorin prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Të dhënat për shkëmbimin tregtar për aktivitetet “Prodhimi i takëmeve të kuzhinës, mjeteve dhe pajisjeve të përgjithshme metalike”, për vitin 2020, tregon se eksporti ka shënuar rritje për 4.22%, derisa importi ka shënuar rënie për normën e njëjtë, krahasuar me vitin paraprak, aktiviteti “Prodhimi i produkteve të konstruksioneve metalike” ka shënuar rritje në eksport për 1.8% në raport me importin.

13. PRODHIMI I MOBILEVE

Industria e mobileve është industri e mbizotëruar nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera të BE-së.

Vendet e BE-së janë lider botëror në segmentin e niveleve të larta të tregut të mobileve. Nga tri produkte të mobileve të shitura në botë, dy nga ato prodhohen në vendet e BE-së. Po ashtu, në vendet e BE-së, punësimi në këtë nën sektor është rreth 1 milion punëtorë në 130 mijë ndërmarrje, që gjen erojnë një qarkullim vjetor prej rreth 96 miliardë Euro.²⁵

Në raportin, (Report “The EU Furniture Market Situation and a Possible Furniture Products Initiative”, 2014), Gjermania, Italia, Polonia dhe Franca, radhiten në mesin e 10 vendeve evropiane më të zhvilluara në industrinë e mobileve, me 60% në kuadër të vendeve të BE-së ndërsa 17% të vendeve tjera në prodhimin global. Në nivel global, 77% të prodhimit të mobileve e përbëjnë top dhjetë vendet si: Kina 40%, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 14%, Gjermania 5%, Italia 4%, India 3%, Japonia 3%, Polonia 2%, Kanadaja 2%, Brazili 2% dhe Franca 2%.

Raporti i importit / konsumit të mobileve, shprehur në përqindje sipas vendeve ishte: Azia dhe Paqësori 8%, Amerika e Veriut 40%, 28 vendet e BE 47%, Norvegjia, Zvicra, Islanda 76%, Evropa tjetër jashtë BE (përfshirë Rusinë) 33%, Amerika e Jugut 10%, Lindja e Mesme dhe Afrika 49%.²⁶

Ndërmarrjet të cilat merren me prodhimin e mobileve janë duke instaluar procesin teknologjik të modernizuar edhe pse kanë vështirësi, në mungesë të financave. Megjithatë produktet në nën sektorin “Prodhimi i mobileve” kanë cilësi të mirë dhe po ashtu kanë trend të rritjes në eksporte.

Nën sektori i prodhimit të mobileve në Kosovë, ka vend të rëndësishëm me pjesëmarrjen e numrit të ndërmarrjeve, punësimit, eksporteve dhe qarkullimit në industrinë prodhuese.

Eksportet e këtij nën sektori, kanë shënuar rritje në vitin 2020 për 119.12%, ndërsa importi ka pasur rënie me 21.54%, krahasuar me vitin paraprak.

²⁵ Furniture industry - Internal Market, Industry, Entrepreneurship and SMEs - European Commission (2019)

²⁶ Report “The EU Furniture Market Situation and a Possible Furniture Products Initiative”. (2014)

13.1 Numri i ndërmarrjeve, punësimit dhe qarkullimit në nën sektorin e mobileve

Nën sektori i mobileve, sikurse edhe nën sektorët tjerë, ka ndikim në punësim me 3,833 të punësuar në 514 ndërmarrje dhe qarkullim vjetor prej 94.97 milion euro.

Ky nën sektor, në vitin 2020, rritje ka shënuar në punësim për 46.96%, në qarkullim për 34.36% dhe në numër të ndërmarrjeve për 30.79%.

Nën sektori (31) në totalin e Sektorit-C merr pjesë:

- 9.12 % të ndërmarrjeve,
- 11.05 % të punësuarve dhe
- 6.84 % në qarkullim.

Tabela 37. Numri i ndërmarrjeve, punësimi dhe qarkullimi në nën sektorin e mobileve

Kodi	Nën sektori Prodhimi i mobileve (31)	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
3101	Prodhimi i mobileve të zyrave dhe dyqaneve	72	69	100	305	425	588	4,915,731.80	6,280,777.07	8,006,093.27
3102	Prodhimi i mobileve të kuzhinës	166	154	206	582	532	910	7,954,702.10	8,353,849.31	11,868,877.52
3103	Prodhimi i dyshekëve	15	13	14	418	541	996	29,059,984.09	32,207,161.00	52,563,787.19
3109	Prodhimi i mobileve të tjera	153	157	194	1,009	1,110	1,339	21,182,838.09	23,846,112.57	22,538,759.25
Gjithsej		406	393	514	2,314	2,608	3,833	63,113,256.08	70,687,899.95	94,977,517.23

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas Tabelës nr. 37, nën aktiviteti më me ndikim në punësim, te ky nën sektor, është “Prodhimi i mobileve të tjera” me 1,339, apo 34.93% të punësuar. Në vendin e dytë, për nga punësimi, radhitet nën aktiviteti, “Prodhimi i dyshekëve”, me 996 apo 25.98% të punësuar, deri sa në qarkullim ky nën aktivitetet prinë me 55.34%, nën aktiviteti i tretë me radhë është “Prodhimi i Mobileve të Kuzhinës” me 23.74% të pjesëmarrjes në punësim.

Në vitin 2020, krahasuar me vitin paraprak, në punësim rritje kanë shënuar të gjitha aktivitetet, ndër aktivitetet i cili ka shënuar rritje më të lartë është “Prodhimi i dyshekëve”, i cili ka pasur rritje për 84.10%, pastaj rendite aktiviteti “Prodhimi i mobileve të kuzhinës” me 71.05%, aktiviteti “Prodhimi i mobileve të zyrave dhe dyqaneve” me 38.35% etj.

Të gjitha nën aktivitetet, kanë shënuar rritje në qarkullim, me përjashtim të aktivitetit “Prodhimi i mobileve të tjera” i cili në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka shënuar rënie.

Ndër aktivitetet i cili dominon me rritje në qarkullim, si në vlerë monetare po ashtu në përqindje është aktiviteti “prodhimi i dyshekëve”, i cili aktivitet në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak, ka shënuar rritje mbi 20 milion euro me 63.21%. Deri sa rënie për 5.48% në qarkullim ka shënuar aktiviteti “prodhimi i mobileve të tjera”.

Sipas shtrirjes regjionale nën sektori “Prodhimi i mobileve”, në numër të ndërmarrjeve prinë regjioni i Ferizajt me 40.08%, regjioni i Prishtinës me 18.87%, regjioni i Prizrenit me 11.48%,

regjioni i Pejës dhe Gjilanit me nga 9.14%, regjioni i Mitrovicës me 7.20% dhe regjioni i Gjakovës me 4.09%.

Në numër të ndërmarrjeve, nën aktiviteti “Prodhimi i mobilieve të kuzhinës” prinë në regjionin e Ferizajt me 42.72%, regjionin e Prishtinës me 20.39%, regjionin e Gjilanit me 10.69% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë për nga numri i ndërmarrjeve është “Prodhimi i mobilieve të tjera”, ku prinë regjioni i Ferizajt me 39.18%, pastaj radhitet regjioni i Prishtinës me 18.87%, regjioni i Prizrenit me 15.98% etj.

Nën aktiviteti tjetër i cili ka ndikim në numër të ndërmarrjeve është “Prodhimi i mobilieve të zyrave dhe dyqaneve”, ku prinë regjioni i Ferizajt me 37%, regjioni i Prishtinës me 19%, regjioni i Pejës me 15%, etj.

Në punësim, ky nën sektor prinë në regjionin e Ferizajt me 23.66%, Gjakovës me 20.69%, Prishtinës 14.04%, Pejës 13.67%, Gjilanit 10.62%, Mitrovicës 9.89% dhe Prizrenit me 7.44%.

Nën aktiviteti “Prodhimi i mobilieve të tjera” në kuadër të këtij nën sektori, në punësim merr pjesë me 34.93%. Sa i përket shtrirjes regjionale prinë Ferizaj me 26.44%, regjioni i Gjilanit me 20.39%, regjioni i Prishtinës me 19.72%, Prizrenit me 14.12%, Pejës me 13.37% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë i cili ka ndikuar në punësim te nën sektori i mobileve është “Prodhimi i dyshekëve”, edhe pse në numër të ndërmarrjeve regjioni i Gjakovës radhitet i treti me vetëm 3 ndërmarrje, ky regjion në punësim te ky nën aktivitet është dominues me 76.71%, regjioni i Pejës me 18.37%, Ferizajt me 3.11%, Gjilani me 1.10% dhe Prizreni me 0.70%.

Nën aktiviteti i tretë me radhë me pjesëmarrje në punësim është “Prodhimi i mobilieve të kuzhinës”, në këtë nën aktivitet, në punësim prinë regjioni i Ferizajt me 36.70%, regjioni i Mitrovicës me 19.34%, regjioni i Prishtinës me 15.93% etj.

Nën sektori “Prodhimi i mobileve” me pjesëmarrje në qarkullim prinë, regjioni i Gjakovës me 39.08%, pastaj renditet regjioni i Pejës me 21.42%, regjioni i Ferizajt me 10.61%, regjioni i Gjilanit me 8.63%, regjioni i Prishtinës me 8.07%, regjioni i Mitrovicës me 6.30% dhe regjioni i Prizrenit me 5.88%.

Qarkullimi dominon te nën aktiviteti “prodhimi i dyshekëve” me 55.34%, ku prinë regjioni i Gjakovës me 70.14%, regjioni i Pejës me 26.79% etj.

Nën aktiviteti i dytë me radhë për nga qarkullimi është “Prodhimi i mobileve të tjera”, në këtë nën aktivitet pjesëmarrja më e lartë në qarkullim është në regjionin e Gjilanit me 27.38%, regjioni i Pejës me 18.10%, regjioni i Ferizajt me 17.83%, regjioni i Prishtinës me 17.17%, regjioni i Prizrenit me 16.63% etj.

Nën aktiviteti i tretë me radhë me pjesëmarrje për 15% në qarkullim, është nën aktiviteti “Prodhimi i mobileve të kuzhinës”. Te ky nën aktivitet pjesëmarrjen më të lartë në qarkullim e ka regjioni i Ferizajt me 25.39%, regjioni i Mitrovicës me 23.86%, regjioni i Prishtinës me 16.40%, regjioni i Gjilanit me 14.07%, regjioni i Prizrenit me 13.85% etj.

13.2 Eksportet dhe importet në nën sektorin e mobileve

Eksporti në nën sektorin “Prodhimi i mobileve”, ka shënuar rritje në vitin 2020 për 119.12% dhe në vitin 2019 për 45.22%, krahasuar me vitin paraprak.

Importi në nën sektorin “Prodhimi i mobileve”, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 21.54%, deri sa në vitin 2019 kishte rritje për 0.11%, krahasuar me vitin paraprak.

Në vitin 2020, raporti mes eksportit dhe importit të ky nën sektor është 46.26% eksport dhe 53.74% import, eksporti në raport me importin ka treguar trend pozitiv me rritje për 22.7%, krahasuar me vitin 2019.

Eksportet e këtij nën sektori marrin pjesë me 8.42 % në totalin e eksporteve dhe 1.27 % në totalin e importeve, të Sektorit-C.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i mobileve” ka 2.24% ndërmarrje eksportuese, ndërsa në kuadër të këtij nën sektori, nga 514 ndërmarrje, 24.51% janë eksportuese.²⁷

Tabela 38. Eksporti dhe importi në nën sektorin (31), prodhimi i mobileve

Kodi	Nën sektori (31): Prodhimi i mobileve	Eksporti			Ndryshimi (2018 -2019)	Ndryshimi në % 2018-2019	Importi			Ndryshimi (2019-2020)	Ndryshimi në % 2019-2020
		2018	2019	2020			2018	2019	2020		
31	Prodhimi i mobileve	10,541,831.77	15,316,687.30	33,561,425.11	18,244,737.81	119.12	49,638,936.13	49,691,848.08	38,988,969.43	(10,702,878.65)	(21.54)
31.0	Prodhimi i mobileve	10,541,831.77	15,316,687.30	33,561,425.11	18,244,737.81	119.12	49,638,936.13	49,691,848.08	38,988,969.43	(10,702,878.65)	(21.54)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

²⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendeve tjera**

Vlera totale e eksporteve të nën sektorit “Prodhimi i mobileve” është 33.56 milion euro. Eksportet me vendet e BE-së janë 20.45%, me vendet e CEFTA-së 13.07%, me vendet e EFTA-së 25.62% dhe me Vendet tjera 40.86%.

Produktet e nën sektorit “Prodhimi i mobileve”, sipas vendeve në përgjithësi, janë eksportuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 35.74%, Zvicër me 25.54%, Gjermani me 12.18%, Shqipëri 6.74% etj. Ky ndryshim në renditje, i paraqitur në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, është rezultat i rritjes së eksportit të dyshekëve i realizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me që ky nën aktivitet hynë në nën sektorin e mobileve etj.

Eksporti në vendet e BE-së, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ka shënuar rritje për 24.37%, ky eksport është i përqendruar në Gjermani me 59.50% dhe në Belgjikë me 11.52%.

Nën sektorin “Prodhimi i mobileve” në vitin 2020, ka shënuar trend të rritjes së eksporteve me vendet e CEFTA-së për 33.65%, krahasuar me vitin 2019.

Në vendet e CEFTA-së, Kosova ka realizuar eksport më të lartë në Shqipëri me 51.52% me rritje për 16.2%, pastaj në Maqedoninë e Veriut me 38.08%, me rritje për 3.31%.

Eksporti me vendet e EFTA-së, të ky nën sektor, ka shënuar rritje në vitin 2020 për 35.64%, ndërsa në vitin 2019, për 12.28%, krahasuar me vitin paraprak.

Në vendet e EFTA-së, vendi kryesor ku eksportohen produktet e “Prodhimit të mobileve” është Zvicra me 99.71%.

Ndryshimi thelbësor i eksportit është me Vendet tjera, ku në vitin 2019 pjesëmarrja e eksporteve të ky nën sektor ka qenë vetëm 1.16%, ndërsa në vitin 2020 pjesëmarrja në eksporte është 40.86%. Në kuadër të vendeve tjera, eksportet e produkteve të nën sektorit “Prodhimi i mobileve” janë realizuar kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me 87.38% apo 11.9 milion euro.

- **Importi me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendeve tjera**

Vlera totale e importeve të nën sektorit i “Prodhimi i mobileve” është 38.99 milion euro. Importi me vendet e BE-së është 19.12%, me vendet e CEFTA-së 18.85%, EFTA-së 2.15% dhe Vendet tjera 59.88%.

Nga vendet e BE-së, produktet e nën sektorit “Prodhimi i Mobileve”, në vitin 2020, kanë shënuar rënie në import për 35.74%, derisa në vitin 2019 kishte rënie për 0.01%, krahasuar me vitin paraprak.

Në kuadër të vendeve të BE-së, Kosova ka importuar produktet e “Prodhimit të mobileve”, më së tepërmi nga Italia me 30.84%, Polonia me 26.71%, nga Gjermania me 13.95%, etj.

Në vitin 2020, vendet e CEFTA-së, të ky nën sektor në import kanë shënuar rritje për 9.44%, ndërsa në vitin 2019, ka pasur rënie për 44.83%, krahasuar me vitin paraprak.

Importin më të lartë, nga vendet e CEFTA-së, Kosova ka realizuar nga Shqipëria me 44.82%, pastaj renditet Serbia me 27.11%, Maqedonia e Veriut me 38% etj. Gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019.


Nën sektori “Prodhimi i Mobileve” sa i përket importit me vendet e EFTA-së, në vitin 2020, ka shënuar rënie për 19.05%, për derisa në vitin 2019, ka shënuar rritje për 3.88%, krahasuar me vitin paraprak.

Importet e produkteve të “Prodhimit të mobileve” nga vendet e EFTA-së, realizohen kryesisht nga Zvicra me 98.47%.

Importi në vendet tjera, ka shënuar rënie në vitin 2020 për 23.05%, deri sa në vitin 2019, ka pasur rritje për 22.01%, krahasuar me vitin paraprak.

Importi i produkteve të nën sektorit “Prodhimi i Mobileve”, nga vendet tjera, kryesisht realizohet nga Turqia me 54.02% dhe nga Kina me 41.14%.

Figura 15. Raporti mes eksportit dhe importit në sektorin e mobileve



Burimi: ASK, përpunuar nga DPI/DI

Shkëmbimi tregtar, ndër vite i aktivitetit “Prodhimi i mobileve”, sipas Figurës nr. 15, është në favor të importit, megjithatë nga viti 2018-2020 importi ka shënuar trend në rënie.

Në vitin 2020, krahasuar me vitin paraprak, eksporti ka shënuar rritje për 22.7%, në raport me importin.

Përmbledhje - Sektori-C (Industria përpunuese)

Sektori C, në vitin 2020, ka shënuar rritje në eksport për 36.60% deri sa importi ka shënuar rënie për 5.90%, krahasuar me vitin paraprak. Nga 23 nën sektorët që e përbëjnë nomenklaturën e Sektorit-C, krahasuar me vitin 2019 në vitin 2020, 16 nën sektor kanë shënuar rritje deri sa 5 nën sektor kanë pasur rënie të eksporteve dhe 2 nën sektorë nuk kanë pasur eksport. Në import rritje kanë shënuar 9 nën sektor, deri sa 14 nën sektorët tjerë kanë shënuar rënie. Këto të dhëna tregojnë se Sektori-C, ka ndikim të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, potencial për të gjeneruar punësim, ndikim në përmirësimin e bilancit tregtar, përmbushje të kërkesave të tregut me produkte cilësore, zëvendësim të kërkesave për produkte të importuara, rritjen e të hyrave për buxhetin e shtetit etj.

- Sektori-C (Industria përpunuese) merr pjesë me 13.35% në BPV të Kosovës;
- Në vitin 2020, pjesëmarrja e Sektorit-C në BPV është rritur për 1.2%, krahasuar me vitin 2019;
- Pjesëmarrja e industrisë përpunuese, në vitin 2020, në eksportin e përgjithshëm ishte rreth 84%, kurse në importin e përgjithshëm rreth 93%;
- Pjesëmarrja në eksport, në vitin 2020 ishte 398.46, ndërsa në vitin 2019 ishte 291.7 milion euro, që tregon se eksporti ka shënuar rritje për 36.60%.
- Importi në vitin 2020, në Sektorin-C, ishte 3.06 miliard euro, ndërsa në vitin 2019, 3.25 miliard euro, që do të thotë se ka shënuar rënie për 5.90%, për derisa në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kishte rritje për 4.2%;
- Sektori-C, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë me 11.8%;
- Në kuadër të Sektorit-C, 17.9% janë ndërmarrje eksportuese;
- Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë përpunuese është 6 %.

Nën sektori i Përpunimit të Produkteve Ushqimore

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Ushqimore” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 23% dhe në numër të ndërmarrjeve me 20%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 7%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 9.34%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 14%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 27.63%;
- Në vitin 2020, ndryshimi të nën sektori i ushqimit, në numrin e ndërmarrjeve është 18%, në punësim 20%, në qarkullim 17%, në eksport 4% dhe në import 1.61%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Pijeve

- Nën sektori i “Prodhimit të Pijeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 6.16% dhe në numër të ndërmarrjeve me 1.15%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 6.24%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 8.30%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 2.35%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 4.59%;
- Në vitin 2020, ndryshimi të nën sektori i tekstit, në numrin e ndërmarrjeve është 9%, në punësim 17%, në qarkullim 10%, në eksport 3.49% dhe në import (6.06)%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Tekstilit

- Nën sektori i “Prodhimit të tekstilit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.3% dhe në numër të ndërmarrjeve me 3.1%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 4%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 5%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 2%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 4%;
- Në vitin 2020, ndryshimi të nën sektori i tekstilit, në numrin e ndërmarrjeve është 56%, në punësim 28%, në qarkullim 4.43%, në eksport 128% dhe në import 17.37%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Veshjeve

- Nën sektori i “Prodhimit të veshjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 3.31% dhe në numër të ndërmarrjeve me 5.8%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 1%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 1.44% ;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 3%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 5.85%;
- Në vitin 2020, ndryshimi të nën sektori i veshjeve, në numrin e ndërmarrjeve është 55%, në punësim 34.4%, në qarkullim 17%, në eksport 56.59% dhe në import (16.33)%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës

- Nën sektori i “Prodhimit të Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 1.21% dhe në numër të ndërmarrjeve me 0.76%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 0.49%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 0.59% ;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 1.16%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 1.24%;
- Në vitin 2020, ndryshimi të nën sektori i lëkurës, në numrin e ndërmarrjeve është 48.28%, në punësim rritje 10.82%, ndërsa në qarkullim ka shënuar rënie për (23.03%), në eksport (24.18) dhe në import (22.62%) krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Drurit dhe i Produkteve të Drurit dhe të Tapës, përveç Mobilieve; Prodhimi i Artikujve nga Kashta dhe Materialeve të Gërshetuara- Thurje

- Nën sektori i “Prodhimit të Drurit” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 5.09% dhe në numër të ndërmarrjeve me 8.46%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 2.19%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 2.61% ;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 2.09%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 2.25%;

- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i drurit, në numrin e ndërmarrjeve është 16.91%, në punësim 23.63%, në qarkullim 3.78%, në eksport 35.60% dhe në import (-8.83%), krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës

- Nën sektori i “Prodhimit të Letrës dhe Produkteve prej Letrës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.08% dhe në numër të ndërmarrjeve me 1.90%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 0.61%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 0.73%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 1.78%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 1.92%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i letrës, në numrin e ndërmarrjeve është 15.05, në punësim 55.61%, në qarkullim 41.80%, në eksport 41.90% dhe në import (-5.11%), krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Produkteve Kimike

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve Kimike” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 2.20% dhe në numër të ndërmarrjeve me 2.02%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 4.13%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 4.93%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 7.80%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 8.40%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i industrisë kimike, në numrin e ndërmarrjeve është 34.12%, në punësim 22.12%, në qarkullim 14.83%, në eksport 140% dhe në import 8.03%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Gomës dhe Plastikës” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 10% dhe në numër të ndërmarrjeve me 10%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 12.27%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 16% ;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 4.60%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 9%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i gomës dhe plastikës, në numrin e ndërmarrjeve është 19%, në punësim 26%, në qarkullim 7.14%, në eksport 13.19% dhe në import (2.31)%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të produkteve minerale jo-metalike

- Nën sektori i “Prodhimit të produkteve **minerale jo-metalike**” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 14.65% dhe në numër të ndërmarrjeve me 9.07%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 2%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 2.4%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 5.19%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 5.6%;

Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i produkteve minerale jo-metalike, në numrin e ndërmarrjeve është 15.35%, në punësim 14.10%, në qarkullim 0.72%, në eksport 17.45% dhe në import 2.15%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Metaleve

- Nën sektori i “Prodhimit të Metaleve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 3.69% dhe në numër të ndërmarrjeve me 2.15%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 23.67%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 28.21%;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 7.32%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 7.88%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i metaleve, në numrin e ndërmarrjeve është 30.11, në punësim 15.32%, në qarkullim 2.75%, në eksport 48.17% dhe rënie në import për (8.81)%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve

- Nën sektori i “Prodhimit të Produkteve të Fabrikua Metalike, përveç Makinerisë dhe Pajisjeve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 10% dhe në numër të ndërmarrjeve me 10.5%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 6.68%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 9% ;
- Në importin e përgjithshëm m, merr pjesë me 3.76%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 7.35%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i produkteve të fabrikua metalike, në numrin e ndërmarrjeve është 27%, në punësim 25%, në qarkullim 10.42%, në eksport 35.30% dhe në import 10.78%, krahasuar me vitin 2019.

Nën sektori i Prodhimit të Mobileve

- Nën sektori i “Prodhimit të Mobileve” në Sektorin-C, në punësim merr pjesë me 11.05% dhe në numër të ndërmarrjeve me 9.12%;
- Në eksportin e përgjithshëm, merr pjesë me 7.07%;
- Në eksportin e Sektorit-C, merr pjesë me 8.42% ;
- Në importin e përgjithshëm, merr pjesë me 1.18%;
- Në importin e Sektorit-C, merr pjesë me 1.27%;
- Në vitin 2020, ndryshimi te nën sektori i mobileve, në numrin e ndërmarrjeve është 30.79%, në punësim 46.96%, në qarkullim 34.36%, në eksport 119.12% dhe në import (-21.54), krahasuar me vitin 2019.

Rekomandime

- Për të përmirësuar standardin e jetesës, për të ekuilibruar bilancin e madh negativ tregtar si dhe për rritje të eksporteve Kosova duhet të investojë në nën sektorët e industrisë përpunuese, konkretisht në prodhim;
- Të krijohen lidhjet ndër sektoriale, rrjetëzime, në mes të prodhueseve, furnitorëve dhe transportuesve në bashkëpunim me institucionet relevante për të identifikuar sfidat dhe për të ndërmarr hapat konkret për intervenim dhe zgjidhje të pengesave;
- Investimet në teknologji të avancuara, që mundësojnë rritjen e vlerës së produktit, duke zbatuar edhe në standardet e kërkuara, konform kërkesave të tregut të BE-së;
- Institucionet përgjegjëse të Arsimit dhe akterët tjerë, duhet të bashkëpunojnë me biznesin në hartimin e programeve arsimore profesionale, në mënyrë që t'i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të tregut të punës në nën sektorët e Sektorit-C;
- Zhvillimi i programeve për hulumtimin e tregjeve për eksport si dhe programeve të trajnimeve profesionale për plotësimin e nevojave të tregut;
- Të tejkalohen pengesat e bizneseve që ua shkakton mungesa e energjisë elektrike, gjatë procesit të prodhimit, duke mundësuar plotësimin e tyre me alternativa të tjera;
- Investime nga ana e Qeverisë dhe Bizneseve në Hulumtim dhe Zhvillim (R&D) për produkte inovative dhe me vlerë të shtuar;
- Investime në digjitalizimin e vijave të prodhimit, si dhe në ekonominë e gjelbër.

Referencat

- Agjencia e Statistikave të Kosovës; <https://ask.rks-gov.net/media/6295/bpv-2008-2020.pdfv>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës; <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/bruto-produkti-vendor-bpv-2008-2018>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës; <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/5599/bruto-produkti-vendor-bpv-me-qasjen-e-shpenzimeve-dhe-të-prodhimit-2019.pdf>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor-2019 dhe Banka Qendrore e Kosovës
- Ec.europa.eu. (2019). Annual production of roundwood, EU-28, 1999–2017, www.statista.com, 2019
- www.statista.com/topics/1701/paper-industry
- Industria e mobileve - Tregu i Brendshëm, Industria, Ndërmarrsia dhe NVM - Komisioni Evropian (2019)
- Report “The EU Furniture Market Situation and a Possible Furniture Products Initiative”. (2014)
- Exports by enterprise size class - OECD iLibrary / https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf
- <http://kosovowood.org/LinkClick.aspx?fileticket=y0NkNbVG-LI%3D&tabid=184&portalid=1&mid=761&language=sq-AL>
- Ec.europa.eu. (2019). Annual production of roundwood, EU-28, 1999–2017
- <https://farbitis.ru/sq/geography-of-the-world-economy/world-chemical-industry/>
- Profili i Industrisë Kimike, 2016 / MINT
- <http://akm.gov.al/assets/riciklimi-i-plastikes.pdf>
- Raport, Analiza e Zinxhirit të vlerës për sektorin e plastikës (2019) / MINT-DI
- Profili i sektorit të industrisë së përpunimit të metalit (2014) / MINT
- <http://empowerkosovo.org/al/perpunimi-i-metalit>
- https://ec.europa.eu/growth/sectors/raw-materials/industries/non-metals_en

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Industrisë/**Divizioni për Politika Industriale**

Falënderojmë **Agjencinë e Statistikave të Kosovës** për bashkëpunimin e treguar për ofrimin e të dhënave statistikore.

Kontakti:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Departamenti i Industrisë, Divizioni për Politika Industriale

Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +383 38 200 36 547

<http://www.mint-rks.org>